GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXVI - Nr. 7896 E martë 28 Maj 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

PR PRESTIGE Resort

KORÇA BEER ... edhe sot më e mira

Opinioni i Ditës

Nga RAJAN HETH

Kush janë 12 njerëzit, që i shkatërruan zgjedhjet e Parlamentit Europian

Sa zgjedhje të çuditshme! Kandidatët për postet më të larta drejtuese të BE-së, nuk ishin në fletën e votimit, dhe në disa raste nuk u shfaqën në debatet...

Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

Zgjedhjet që na afruan Europën e Bashkuar

Të dielën që shkoi, 471 milionë qytetarë të Evropës së Bashkuar zgjodhën 751 anëtarë të Parlamentit Evropian. Ky parlament nuk miraton ligje për të qeverisur secilin ...

Vijon në faqen 21

Shpëton shënjestra, digjet mjeti i atentatit

Atentati në Vlorë, vritet 22-vjeçari, dyshimi i të plagosurit: Porosi nga Greqia

Vritet Sotiraq Mëhilli, mbijeton Eno Mata, ish-i dyshuar për grabitjen ku u vra avokati grek

VLORË-Një tjetër atentat me armë zjarri ka tronditur Vlorën. Në këtë atentat ka mbetur i vrarë një i ri, ndërsa një tjetër është plagosur rëndë dhe ndodhet në spital në gjendje kritike për jetën. Mësohet se viktimë e atentatit ka mbetur 22-vjeçari Sotiraq Mëhilli, të cilin e ka kapur vetëm një plumb, por që ka rezultuar fatal për të, pasi e ka prekur në aortën ....

Në faqen 9

SHTYHET PROTESTA E OPOZITES, KRYEMINISTRI SHKRUAN LETREN E GJASHTE

RAMA: DIALOG PA KUSHTE. BASHA: S'BEJME HAPA PAS

Shterojnë listat PD-LSI, Kuvendi "mbyllet" me 122 deputetë. Rama: Qeveria do të vazhdojë të paktën edhe 2 vjet. Vasili: Ti kriminalizove Vlorën

(Në foto) Kryeministri Edi Rama. Kryetari i opozitës, Lulzim Basha

Në faqet 2-3

SHPENZIMET

Investigimi i BIRN: Qeveria, miliona euro shpenzime me kontrata sekrete

Në faqen 5

800 MEDIKAMENTE

Zbardhet lista e plotë e barnave që do të merren pa recetë nga mjeku

Në faqet 10-11

PARALAJMERIMI

Çela i OSHEE-së: Do të ndryshojnë 650 mijë matës të energjisë elektrike

Në faqen 6

VOTIMI NE SUEDI

Arba Kokalari, kush është shqiptarja që u zgjodh në Parlamentin Europian

Në faqen 16

NGA DASHNOR KALOÇI

Revolta e Qafë-Barit, kryetari i Degës dha urdhër për përdorimin e armëve

Në faqet 14-15

Më 5 qershor skadon afati për dosjet, vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore

Mësues për Shqipërinë, dokumentet e konkurrimit

Ministria e Arsimit: Nëse fitoni, mund të aplikoni për punë në portal

NGA VOLTIZA DURO

Deri në datën 5 qershor të këtij viti, çdo kandidat i interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit, duhet të dorëzojë një listë dokumentesh për të konkurruar për në një vend të lirë pune në portalin "Mësues

për Shqipërinë". "Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) nënvizon se dosja e plotë e dokumentacionit duhet të dërgohet me anë të shërbimit postar deri me datë 5 Qershor pranë Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar ...

Në faqen 12

KRIZA
DIALOGU

Kryeministri i ka nisur dje letrën e gjashtë kreut të Partisë Demokratike

Rama insiston për dialog me Bashën: Të ulemi në tryezë pa kushte

"Qeveria do të vazhdojë të paktën dy vjet të tjera"

Kryeministri Edi Rama e ka ftuar sërish dje kreun e opozitës Lulzim Basha që të ulet në tryezën e dialogut për të diskutuar zgjidhje për të dalë nga situata aktuale politike dhe për të mundësuar futjen e partive opozitare në zgjedhje. Ai dje i ka dërguar letrën e gjatë radhazi kryetarit të PD-së, duke i bërë të ditur se koha për dialog po mbaron. "Zoti kryetar, letrave të mia po i vjen fundi. E fundit për të tentuar Dialogun është edhe kjo javë, e cila mbyllet me çeljen zyrtarisht të fushatës së 30 qershorit. S'ka mbetur nga ana ime ndonjë gjë e rëndësishme pa shkruar në këto letra", - shkruan Rama në letrën e vet ndërsa i bën të ditur në të njëjtën kohë se bashkë me kohën po shterojnë dhe fjalët që ai ka për të shkruar. Ai i kujton Bashës së dy vjet më parë opozita bëri sipas tij fiks të njëjtën gjë si sot dhe fiks për të njëjtat arsye: Paniku nga zgjedhjet dhe frika nga drejtësia. "Sivjet Ju i jeni rikthyer po atij avazi, por nga një nivel i ri papërgjegjshmërie, me mandate të djegura, bojkot zgjedhjesh dhe kërcënime për të ndaluar forcërisht popullin të zgjedhë në 30 qershor. Përsëri frika nga zgjedhjet dhe paniku nga drejtësia, Ju kanë qorruar e shurdhuar dhe shtyrë në rrugën e një lufte imagjinare çlirimtare nga tirania!", - bënte të ditur më tej Rama në letrën e tij. Por kryeministri shprehet se Shqipëria s'është në duart e asnjë tiranie, po në duart e një shumice të zgjedhur demokratikisht, për të qeverisur deri në vitin 2021. Më tej ai thekson se mbështetja e protestave po vijon të bjerë, ndërsa bën të ditur se opozita po gënjen veten për masivitetin e tyre. "Kjo gënjeshtër mund t'Ju mbajë me gajret edhe për ca kohë, Juve e lidershipin politik të grupimit Tuaj. Por besomëni që zgjimi nga ëndrra me sy hapur e largimit të qeverisë pa zgjedhje apo e moslejimit të zgjedhjeve, do të jetë shumë i dhimbshëm për atë grupim e për Ju si udhëheqësi i saj, nëse do të vijoni shurdhërisht në rrugën pa dalje, ku po marshoni verbërisht", - shprehet Rama. Ndaj kreu i qeverisë nënvizon se opozita duhet të heqë dorë nga çdo shpresë për të larguar qeverinë dhe atë vetë me protesta, ndërsa i jep si mundësi që të futet në zgjedhje pikërisht uljen në tryezën e dialogut. "Unë Ju ftoj përsëri që sa pa u djegur çdo afat kohor, të nisim Dialogun pa kushte dhe të fillojmë të shkruajmë bashkërisht, një faqe të re bashkëpunimi politik duke mos humbur më tej kohë, energji, mundësi zgjidhjeje, me këtë avaz të padobishëm për vendin, për njerëzit e për opozitën po se po!", - thekson Rama në letrën e vet të gjashtë. Ai shprehet i sigurt se data e zgjedhjeve nuk do të shtyhet dhe se qeveria do të zbatojë deri në fund kontratën me qytetarët. "Jini i sigurt, zoti Lulzim, se zgjedhjet do të mbahen në 30 qershor. Kjo shumicë qeverisëse do të vazhdojë të ushtrojë përgjegjësinë e saj edhe për të paktën dy vjet të tjera, kur i mbaron mandati i saj legjitim", - deklaronte Rama në letrën e vet ndërsa i bënte të ditur Bashës se me këtë sjellje po pengon hapjen e negociatave. Në fund Rama paralajmëron edhe një ndërhyrje në ligjet e reformës në drejtësi, por duke vënë si kusht nëse për ti do të jetë dakord faktori ndërkombëtar dhe nëse palët japin konsensusin. "Vetingu dhe Reforma në Drejtësi do të vijojnë pa asnjë lëkundje, asnjë ndalesë dhe asnjë rishikim, për sa kohë koha nuk do të sjellë nevojën për ndërhyrje të mundshme në korpusin ligjor të drejtësisë dhe vetëm me konsensusin e partnerëve tanë ndërkombëtarë", - shkruante Rama.

Kryeministri Edi Rama

VETINGU
"Vetingu dhe Reforma në Drejtësi do të vijojnë pa asnjë lëkundje, asnjë ndalesë dhe asnjë rishikim, për sa kohë koha nuk do të sjellë nevojën për ndërhyrje të mundshme në korpusin ligjor të drejtësisë dhe vetëm me konsensusin e partnerëve tanë ndërkombëtarë", - shkruante Rama.

Shterojnë listat e PD dhe LSI, Kuvendi me 18 deputetë mangët

Kanë shteruar listat e kandidatëve për deputetë të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, ndërsa Kuvendi mbetet me 18 deputetë më pak. Ramazan Gjuzi është emri i fundit nga radhët e LSI-së që ka pranuar të marrë mandatin e deputetit në Kuvend. I renduriti i 22-ti në listën e LSI-së për qarkun e Tiranës, Gjuzi mori mandatin e 17-të të deputetit, duke bërë që kjo parti politike të plotësojë të gjithë vendet vakante në Parlamentin e Shqipërisë. Ndërsa në kampin e Partisë Demokratike ka një situatë ndryshe pasi jo të gjithë kandidatët e listës shumemrore kanë pranuar që të marrin mandatin e deputetit. Mësohet se në 11 qarqe të vendit është shteruar lista e shumemërore e kandidatëve për deputet për t'u zëvendësuar nga Parti Demokratike, ndërsa mbetet për t'u shpallur pazgjidhshmëria në qarkun e Elbasanit për dy deputetë. Deri më tani për këtë qark ku PD-ja ka rezultuar me tre mandate, vetëm një ka pranuar që të marrë mandatin dhe ai është Arben Elezi. Në total nga listat e PD-së e kanë pranuar mandatin 23 kandidatë, ndërsa 18 janë pa u plotësuar. Qarqet Korçë, Berat dhe Gjirokastër i kanë plotësuar të gjitha mandatet nga radhët e PD-së, ndërsa në qarqet e tjera ka ende vende bosh.

Balla: Rekomandim pozitiv për negociatat, zgjedhjet në 30 qershor

Kryetari i Grupit Parlamentar në PS Taulant Balla është i bindur se brenda dy ditëve Shqipëria do të marrë rekomandim pozitiv për hapje të negociatave me Bashkimin Europian. I ftuar në News24, numri dy i PS-së shprehet rekomandimi për negociatat do jetë një vlerësim mbi punën e bërë nga qeveria dhe ecurinë e reformave, asaj në drejtësi në veçanti. "Pas 48 orësh Shqipëria do të marrë rekomandim pozitiv për hapje të negociatave. Kjo sepse qeveria e drejtuar nga Edi Rama ka bërë punë të madhe për shtet të së drejtës dhe për integrim të vendit për në BE, me reformat që janë sjellë në tavolinë. Nuk po them se me rekomandimin pozitiv Shqipërisë i mbaruan hallet, por është bërë e rëndësishme për integrim më tej për në BE. Ndërsa meraku i Bashës dhe opozitës është reforma në drejtësi", - tha Balla. Më tej ai bëri të ditur se PS do të konfirmohet në pushtet për një mandat të tretë.

Raporti për hapjen e negociatave, 'Financial Times': Tirana jo gati

Të mërkurën pritet që të publikohet raporti i Komisionerit europian për Negociatat e Zgjerimit të Fqinjësisë, Johannes Hahn, për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Prestigjiozja "Financial Times", i ka kushtuar këtij raporti një artikull të veçantë ku ndër të tjera thekson se "Tirana shihet gjerësisht nga diplomatët si më pak e gatshme për bisedimet e pranimit për shkak të shqetësimeve rreth sundimit të ligjit, korrupsionit dhe krimit të organizuar". Ndërkohë që sipas gazetës, edhe Shkupi po përballet me një komplikacion të mëtejshëm si shkak i debatit brenda BE-së, lidhur me atë që duhet të jetë Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Retheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:**0688087823-*email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës
së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

RIDEKRETIMI
Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, i kërkoi dje Presidentit Ilir Meta ridekretimin e një tjetër date zgjedhore. "Se të themi të vërtetën, dekreti përcakton datën e zgjedhjeve dhe jo datën e votimit. Që këtu dekreti ka rënë. Të mos hyjmë pastaj te veprimtaria gjysmake e KQZ-së dhe te mosregjistrimi i opozitës në zgjedhje", - tha Manjani.

Vasili, Ramës: Shkruaje letrën e 7 si e kriminalizove Vlorën

Ish-kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, i kërkoi dje kryeministrit Rama që pas letrës së gjashtë, të bëjë gati letrën e shtatë, ku të shpjegojë se si e kriminalizoi Vlorën. Përmes një postimi në "Facebook", Vasili shkruan se kryeministri është i papunë tashmë dhe ka filluar të luajë me letra, pasi ai e ka braktisur prej vitesh detyrën. "Kryeministër shkruaje letrën e shtatë se si e kriminalizove Vlorën! Kryeministri i papunë që tund derën tani po luan letrash. Kryesuesi i listës së deputetëve të Vlorës, kryeministri pra, e arriti më në fund një 'sukses' të shënuar dhe e bëri që Vlora të jetë e para në republikë për kriminalitetin më të lartë. Kryeministri e ka braktisur prej vitesh detyrën. Tani i ka mbetur të shkruajë letrën e shtatë se si ia doli ta vinte Vlorën në krye të krimit. Siç shkatërrove Vlorën kryeministër, ashtu e bëre edhe Shqipërinë. Për ty kryeministër letra është shkruar, është vetëm një dhe është atje ku duhet…", - shprehet z.Vasili.

NJOFTIM ANKANDI

Shoqëria e Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të III (TRETË), për shitjen e pasurisë së paluajtshme : **Garazh, me sip. 260 m²**, Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 496/386+2-G1, Vol. 52, Faqe 204, ndodhur në **Linzë Dajt, Tiranë**, në pronësi të Shoqërisë "AGLI" shpk identifikuar me NIPT J71702004M. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **3,302,208 (tre milion e treqind e dy mijë e dyqind tetë) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **31.05.2019**, ora **16:00**, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k , në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: elvinth@hotmail.com.

Nata e Kadrit shtyn protestën e opozitës, manifestimi antiqeveritar do të bëhet në 2 qershor

Basha: Forca e qytetarëve në demokraci është vota. Asnjë hap pas

"Beteja e shqiptarëve për votën e lirë është jetike"

Valentina Madani

Opozita e bashkuar ndryshon datën e protestës kombëtare, duke e spostuar me dy ditë. Protesta nuk do të zhvillohet në 31 maj sikurse ishte njoftuar për shkak se është Nata e Kadrit, natë e bekuar për besimtarët myslimanë, por në 2 qershor, në orën 19:00 para Kryeministrisë. Edhe në protestat e mëparshme, kreu i opozitës, Lulzim Basha në momentin që përkonte me thyerjen e agjërimit, në respekt të besimtarëve myslimanë ka ndërprerë fjalimin politik, duke i ftuar protestuesit të luteshin për një minutë në respekt të vullnetit hyjnor. "Nisur nga fakti që data 31 maj është Natë Kadri, në respekt të besimtarëve myslimanë dhe nisur nga fakti që data 1 qershor është dita e fëmijëve, protesta kombëtare do të mbahet në datë 2 qershor 2019, ora 19.00, përpara Kryeministrisë", - njoftoi PD-ja. Dy ditë më parë edhe kryeministri Rama vendosi ta shtyjë për në 1 qershor hapjen e fushatës elektorale, për të shmangur përplasjen me protestën e radhës së opozitës, që ishte parashikuar të mbahej në 31 maj. Ndërkohë, mazhoranca pritet të çelë zyrtarisht fushatën për zgjedhjet lokale të 30 qershorit një ditë para protestës, në 1 qershor. "Meqë lajmëruat grumbullimin e radhës në 31 maj, shtabi ynë elektoral vendosi ta spostojë në 1 qershor mitingun e çeljes zyrtare të fushatës - kollaj, nuk ishte një datë si ajo zgjedhjeve që s'e kemi ne në dorë", është shprehur z.Rama.

MËSAZHI

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, nuk i kthye dje përgjigje letrës së gjashtë të kryeministrit Edi Rama për dialog, por ftoi sërish shqiptarët në protestën e radhës së opozitës, e cila mbahet në 2 qershor, në orën 19:00. Slogan është thirrja "Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa. "Shqipëria, si Europa, 2 qershor", shkruan Basha sipër spotit për protestën e opozitës. Po dje kreu i PD-së, Lulzim Basha, reagoi pas fitores së PPE në zgjedhjet për Parlamentin Europian, ku duke uruar presidentin Joseph Daul dhe PPE, z.Basha përmend se forca e qytetarëve në demokraci është vota, ndërsa thekson se, "beteja e shqiptarëve për votën e lirë është betejë jetike për vlerat europiane, për demokracinë perëndimore dhe për Shqipërinë si e gjithë Europa". "Qytetarët europianë, me pjesëmarrjen më masive të 20 viteve të fundit në zgjedhjet për Parlamentin Europian konfirmuan vendosmërinë për të mbrojtur dhe çuar përpara vlerat europiane. Jam i lumtur që familja jonë politike EPP - European People's Party është konfirmuar forca e parë në parlamentin dhe qeverisjen europiane. Urimet më të përzemërta për presidentin Joseph Daul dhe PPE dhe në veçanti për fushatën e jashtëzakonshme të kandidatit tonë për president të Komisionit Europian, Manfred Weber. Forca e qytetarëve në demokraci është vota, prandaj beteja e shqiptarëve për votën e lirë është betejë jetike për vlerat europiane, për demokracinë perëndimore dhe për Shqipërinë si gjithë Europa", shprehet lideri i opozitës, Lulzim Basha.

kreu i opozitës, Lulzim Basha

ZGJEDHJET
Sipas kreut të opozitës, Lulzim Bashës, "forca e qytetarëve në demokraci është vota, prandaj beteja e shqiptarëve për votën e lirë është betejë jetike për vlerat evropiane, për demokracinë perëndimore dhe për Shqipërinë si e gjithë Evropa".

"Kryeministri nxit dhunë dhe provokon qytetarët"

Letra e Ramës për Bashën, Bardhi: Luftënxitëse, hipokrite dhe hilacake

PD përmes sekretarit të përgjithshëm, Gamend Bardhi, i konsideroi dje letrat e Edi Ramës për Lulzim Bashën si luftënxitëse dhe ftesën për dialog, hipokrizi. Bardhi i kujton Ramës se është i pafuqishëm të ndalë triumfin e shqiptarëve të bashkuar. Sipas tij, kryeministri provokon qytetarët me këto letra, teksa thekson se zgjedhjet e lira është kauza për të cilën do të vazhdojnë të luftojnë. "Në vend që të shkruajë letra luftënxitëse, që me hipokrizi i quan 'ftesa për dialog', Edi Rama bën mirë të kuptojë se ai është i pafuqishëm të ndalë triumfin e shqiptarëve të bashkuar. Kauza jonë për zgjedhje të lira e të ndershme, për të ndërtuar Shqipërinë si gjithë Europa, është kauza më e drejtë për të cilën shqiptarët kanë luftuar këto 29 vite, që pas rrëzimit të diktaturës. Vetëm një qeveri e dalë nga zgjedhjet e lira e të ndershme është garanci për mirëqenie, punësim dhe zhvillim për qytetarët shqiptarë", shprehet z.Bardhi. Zyrtari i lartë i PD-së tregon edhe një episod, që sipas tij, i kishte ndodhur me një qytetarë gjatë protestës së opozitës. "Këto ditë kam lexuar me qindra komente për letrat hipokrite dhe hilacake të Edi Ramës, por efektin e vërtetë të tyre e kuptova gjatë protestës se fundit. Në momentin kur përpiqesha të ndaloja qytetarë të zemëruar te parlamenti, njëri prej tyre, rreth 50 vjeç, i revoltuar nga ndërhyrja ime, më tha: "Pse ma heq të drejtën të marr hak? Edi Rama me ka lënë fëmijët pa bukë. Tani tallet me mua me ato letrat në 'Facebook'. Episodi i babait që lufton për mbijetesë në regjimin e panjerëzishëm të Edi Ramës, mu kujtua tani, kur lexova letrën e gjashtë (shpresoj të fundit), në të cilën ai vazhdonte të tallej, të fyente dhe të provokonte me mijëra e mijëra protestues", - shprehet z.Bardhi.

REAGIMI
"Edi Rama nuk bën asgjë tjetër me letrat e tij, veçse nxit dhunë dhe provokon qytetarët që u ka shkuar thika e pushtetit të tij në palcë", shprehet z.Bardhi.

KUVENDI
RAPORTI

Akuzat e PD, zbulohen 12 emrat që shkojnë për gjykim për dosjen 339

Ndërsa kryeprokurorja raportonte dje në Komisionin e Ligjeve mbi raportin vjetor të veprimtarisë së institucionit që ajo drejton, mediat kanë publikuar emrat që do të shkojnë për gjykim për dosjen 339. Të pandehur për këtë dosje do të jenë Ramadan Dushaj, Ramazan Çaçani, Fatbardh Gostini, Neritan Saraçi, si dhe Gentjan Marku e Ardit Haxhagiqi. Gjithashtu, të pandehur për këtë dosje janë edhe Oltion Noka, Fation Marku dhe Elis Guri, Samuel Ndoka, Luan Boça dhe Vilson Noka. Gjatë përgjimeve të këtij grupi prokuroria hasi edhe komunikime që zbulonin pjesëmarrjen e këtyre personave dhe zyrtarëve të lartë, përfshi edhe kryetarin e Bashkisë së Durrësit Vangjush Dako, në blerjen

e votave në zgjedhjet e vitit 2017. Në rrëfimin e tij prej 5 orësh ditën e enjte, Vangjush Dako ka treguar si është njohur me vëllezërit Astrit dhe Altin Avdylaj, me të cilët ka folur gjatë dhe pas fushatës elektorale. Qytetari i parë i Durrësit mësohet se ka mohuar të ketë dijeni mbi blerjen e votave. Burimet thanë se ai ka sqaruar se persona të ndryshëm mund t'u kenë ofruar para votuesve, por ai nuk qenë në dijeni apo për më tepër ta ketë aprovuar këtë gjë. Në përgjimet e bëra publike deri tani Vangjush Dako është regjistruar vetëm një herë duke folur me Altin Avdylin, i njohur ndryshe si "Niçja" ndërsa në një përgjim të dytë del "Niçja" dhe një tjetër person. Të njëjtat burime nga prokuroria konfirmojnë se pyetja e këtyre personave është bërë në këtë moment për shkak të përfundimit të zbardhjes së disa dhjetëra CD-ve të reja me përgjime nga ajo që njihet si Dosja 339. Burimet janë tepër të rezervuara për të bërë publike përmbajtjen e tyre, por sqarohet se janë të dhëna të vlefshme, të cilat mund t'i japin një tjetër rrjedhë hetimit. Ndërsa hetimi për blerjen e votave në Durrës u veçua në një tjetër dosje, 339/1/.

Komisioni i Ligjeve

Kryeprokurorja ka bërë të ditur se dosjet 339 dhe 184 s'kanë lidhje me zgjedhjet

Blerja e votave, Marku: Dosja voluminoze, së shpejti do ketë vendim

"Për çështjen 339 janë 700 cd të patranskriptuara"

Kryeprokurorja e Përgjithshme Arta Marku prezantoi dje në Komisionin e Ligjeve raportin e punës së prokurorisë për vitin 2018, ku jashtë vëmendjes së deputetëve nuk mbetën edhe çështjet më të nxehta që kanë të bëjnë me blerjen e votave, përkatësisht dosja 339/1 dhe dosja 184, ku pretendohet se janë përfshirë edhe zyrtar të lartë. Pavarësisht interesimit të lartë të deputetëve lidhur me këto dy dosje, kryeprokurorja nuk ka dhënë shumë detaje, por ka theksuar se bëhet fjalë për dosje voluminoze dhe për të cilat kërkohet një punë e madhe që, sipas saj, po kryhet nga 2 prokurorë dhe një numër i madh policësh gjyqësorë. Kryeprokurorja Arta Marku tha se iu ka kërkuar prokurorëve të hetojnë sa më shpejt dosjet 339 dhe 184, të cilat tronditën skenën politike, ndërsa shtoi se shumë shpejt priten rezultate konkrete në pjesën e vendimmarrjes mbi përmbajtjen e tyre. Sipas saj, vetëm dosja 339 ka gjithsej 700 CD përgjime që presin të zbardhen. "Për dosjet e përgjimeve, janë në hetim. Nëse do kishte vendimmarrje do ishte marrë vesh. Ka problematikë dhe janë mbajtur zvarrë. Çështja 339 po hetohen nga dy prokurorë. Shumë shpejt do ketë vendimmarrje e do bëhet publike. Po ashtu edhe dosja 184 është e njëjta situatë dhe do ketë një vendimmarrje. U kam kërkuar prokurorëve të hetojnë shpejt. Për çështjen 339 janë 700 cd të patranskriptuara. U kam kërkuar prokurorëve të hetojnë dhe të kenë një vendim për çështjet që kanë tronditur politikën", - tha Marku. Kjo përgjigje solli reagimin e nënkryetarit të Kuvendit, Myslim Murrizi, i cili nisur nga volumi i madh i materialeve të përgjuara theksoi jo pa ironi se prokuroria ia ka kaluar edhe ish-Kinostudios që prodhonte filma në kohën e regjimit të mëparshëm. "Me këto përgjime ia paskeni kaluar edhe kinostudios", - tha Murrizi. Lidhur me këtë shqetësim Marku bëri të ditur se personat që janë pjesë e dosjes janë mbajtur në përgjim për një kohë të gjatë në mënyrë që të faktohej veprimtaria e tyre kriminale, por që sipas tij s'ka lidhje me zgjedhjet. "Për 700 cd e pazbardhura, janë shumë është e vërtetë. Sapo kam marrë dijeni të problematikës kam ndërhyrë sipas ligjit. Është mbajtur nën hetim në disa kohë. Kjo çështje ka shume volum dhe prandaj është volumi i madh pune. Janë regjistruar emrat e parë për hetim e që nuk kanë lidhje me zgjedhjet, por për trafikim kriminal. E njëjta gjë edhe për dosjen tjetër 184. Janë dy prokurorë dhe 11 oficerë të policisë gjyqësore që ndjekin dosjen 339. Po ecet me ritme te shpejta. Për një pjesë të të pandehurve është ndarë çështja, s'ka lidhje me zgjedhjet por me trafikimin e narkotikeve", - shtoi Marku. Ajo është pyetur edhe në lidhje me protestat e opozitës dhe arrestimet e protestuesve nëse ato ishin politike apo ligjore. Por Marku ka hezituar të futet në këtë debat politikë, duke theksuar se arrestimet i ka bërë policia. "Jam në dijeni për disa arrestime. Çështjet janë në hetim, ndalimet janë bërë nga policia. Nuk mund te them nëse ndalimet janë politike", - tha Marku. Ndërkohë që deputeti Lefter Maliqi e ka pyetur kryeprokuroren Marku, për çështje konkrete, si ajo e vrasjes së bankierit Artan Santo, se çfarë është bërë konkretisht me këtë dosje. Pas Maliqit, ka ndërhyrë deputeti i PS-së, Spartak Braho, i cili ka sugjeruar se për çështje konkrete është në të drejtën e kryeprokurores të mos japë detaje për hetimet. "Për vrasjen e Santos, kjo është një çështje jashtë periudhës për të cilën po raportojmë dhe është një çështje konkrete, për të cilën unë nuk jap të dhëna konkrete" - u përgjigj shkurt Marku.

Kryeprokurorja Arta Marku

TRANSKRIPTIMI

"Për 700 cd e pazbardhura, janë shumë është e vërtetë. Sapo kam marrë ndjeni të problematikes kam ndërhyrë sipas ligjit. Është mbajtur nën hetim në disa kohë. Kjo çështje ka shumë volum dhe prandaj është volumi i madh pune. Janë regjistruar emrat e parë për hetim e që nuk kanë lidhje me zgjedhjet, por për trafikim kriminal. E njëjta gjë edhe për dosjen tjetër 184", - tha Marku.

Raporti, kriminalitetin më ulët Dibra dhe më të lartin Vlora

Kryeprokurorja Arta Marku raportoi dje mbi gjendjen dhe luftën kundër kriminalitetit në vend. Sipas raportit të dorëzuar në Kuvend rezulton se gjatë vitit 2018 në çdo 5 persona të përgjuar 1 prej tyre është procedu-uar për një vepër penale të caktuar. Gjatë vitit 2018 janë janë ekzekutuar gjithsej 3063 vendime për përgjim të autorizuara nga gjykata në hetimet paraprake, aplikuar në lidhje me 715 procedime penale. Për sa më sipër është mundësuar interceptimi për 4168 persona të dyshuar si të përfshirë në vepra penale. Si rrjedhojë në sajë të kësaj teknike hetimore është arritur në arrestimin ose ndalimin e 619 personave të dyshuar për krime kundër personit, vepra penale në fushën e narkotikëve, korrupsion e shpërdorim detyre, trafiqe e kalim i paligjshëm i kufirit apo vepra të tjera të rënda, duke parandaluar kështu pasoja për shtetin e shtetasit. Koeficienti i kriminalitetit për procedimet penale të regjistruara, për 100.000 banorë në vitin 2018 është 1094 po aq sa edhe në vitin 2017. Në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme thuhet se përqindjen më të ulët të kriminalitetit e ka qarku Dibër ndërsa përqindjen më të lartë qarku Vlorë. Sa i përket tendencës, vërehet se rritjen më të lartë për vitin 2018 e kanë qarku Durrës e qarku Fier, ndërsa ulje e kriminalitetit vërehet në qarkun Kukës, qarkun Gjirokastër e qarkun Berat.



PASOJAT
Nga viti 2014 deri në vitin 2018, qindra kontrata publike duke filluar nga teknologjia informacionit, mirëmbajtja e ndërtesave publike e deri te shërbimet qeveritare janë klasifikuar si sekret. Sipas KLSH-së dhe ekspertëve nga shoqëria civile, kontratat e klasifikuara sekret sjellin pasoja negative për buxhetin e shtetit.

TË DHËNAT
Të dhëna të marra nga BIRN përmes kërkesave për të drejtë informimi tregojnë se përgjatë dhjetë viteve të fundit, autoritetet publike në Shqipëri, ku përfshihen institucionet e qeverisë qendrore dhe ato të pavarura, kanë vendosur të mbajnë sekret 236 kontrata prokurimesh publike.

Investigimi, rritet numri i prokurimeve publike të klasifikuara "sekret shtetëror"

Qeveria kontraktoi miliona euro shpenzime me kontrata sekrete

Abuzimi, kosto shtesë për buxhetin e shtetit

Gjergj Erebara

Qeveria shqiptare ka shtuar ndjeshëm numrin e prokurimeve publike të klasifikuara "sekret shtetëror", duke ngritur pikëpyetje nëse ligji për informacionin e klasifikuar po abuzohet për të shmangur transparencën dhe llogaridhënien, duke sjellë kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Sipas BIRN, në dhjetor 2018, një pagesë me vlerë 187 milionë lekë u shfaq në bazën e të dhënave të thesarit të shtetit të Ministrisë së Financave. Pagesa u krye nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për kompaninë "Albsig", një kompani e grupit "Kastrati", e cila ka aktivitet në fushën e sigurimeve, por që nuk dihet të ketë ndonjë aktivitet në fushën e teknologjisë së informacionit.

SHPENZIMET

Transaksioni me përshkrim "AKSHI, pagesë për sigurimin e ndërtesës" ishte i pazakontë për nga lloji i shpenzimit si dhe shumës relativisht të konsideru-eshme. Kontratat e sigurimit janë të tilla që sigurojnë palën paguese, në rastin konkret AKSHI, se do të marrin një shpërblim për një dëm të pësuar gjatë periudhës së sigurimit. Kostoja e sigurimit, e njohur në gjuhën teknike si 'prim', varet nga shkalla e rrezikut apo probabiliteti i ngjarjes së pritshme negative. Por në përgjithësi, kostoja e primit luhatet mes një të mijtës dhe 1 apo 2 për qind të vlerës së objektit të siguruar apo dëmit potencial të pritshëm për t'u paguar. Me një kontratë sigurimi prej afro 1.5 milionë eurosh, AKSHI mund të ketë pritur të pësojë një ngjarje siguruese, të tillë si aksident, zjarr, tërmet apo përmbytje, me vlerë minimale prej 100 milionë eurosh dhe maksimale prej 1 miliard eurosh, në varësi të raportit të primit me shumën e dëmit të siguruar.

RREZIKU

Është e paqartë se me çfarë rreziku apo kataklizmi përballet ndërtesa e AKSHI-t për të justifikuar një shpenzim kaq të lartë për sigurimin vetëm për një vit kalendarik. Kontrata midis agjencisë dhe kompanisë "Albsig" është e shpallur si sekret shtetëror dhe nuk është tenderi i vetëm i klasifikuar gjatë vitit 2018. Të dhënat e siguruara nga BIRN nëpërmjet ligjit për të drejtë informimi tregojnë se klasifikimi i prokurimeve publike si sekret shtetëror ka njohur një rritje eksponenciale që nga ardhja në pushtet e kryeministrit socialist, Edi Rama. Nga viti 2014 deri në vitin 2018, qindra kontrata publike, duke filluar nga teknologjia informacionit, mirëmbajtja e ndërtesave publike e deri te shërbimet qeveritare janë klasifikuar si sekret. Sipas KLSH-së dhe ekspertëve nga shoqëria civile, kontratat e klasifikuara sekret sjellin pasoja negative për buxhetin e shtetit, duke kufizuar konkurrencën midis operatorëve ekonomikë dhe duke sjellë kosto shtesë. I pyetur nga BIRN nëpërmjet një zëdhënësi, kryeministri Edi Rama nuk iu përgjigj një kërkese për koment në lidhje me arsyet që e kanë shtyrë qeverinë në rritjen e përdorimit të klasifikimit sekret shtetëror në fushën e prokurimeve publike. Çfarë e bën situatën me klasifikimin e dokumenteve të prokurimeve publike edhe më shqetësuese është fakti që disa institucione publike si Autoriteti Rrugor Shqiptar i cilësojnë edhe kontratat e thjeshta për punë publike si ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve si 'konfidenciale', duke kufizuar në mënyrë të paligjshme qasjen e medias dhe të qytetarëve në përmbajtjen e tyre.

KONTRATAT

Sipas ligjit për informacionin e klasifikuar, sekret shtetëror konsiderohet ai lloj informacioni, ekspozimi i paautorizuar i të cilit do të vinte në rrezik sigurinë kombëtare. Dokumentet e konsideruara sekret shtetëror, në bazë të përmbajtjes, vlerave dhe informacionit që përmbajnë mund të klasifikohen në "tepër sekret", "sekret", "konfidencial" ose i "kufizuar". Të dhëna të marra nga BIRN përmes kërkesave për të drejtë informimi tregojnë se përgjatë dhjetë viteve të fundit, autoritetet publike në Shqipëri, ku përfshihen institucionet e qeverisë qendrore dhe ato të pavarura kanë vendosur të mbajnë sekret 236 kontrata prokurimesh publike. Të dhënat statistikore u dhanë nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, DSIK, institucioni përgjegjës për ruajtjen e sekreteve shtetërore, ku mbahet edhe indeksi i dokumenteve sekrete. Në këtë shifër përfshihen kontratat e klasifikuara me nivelin "i kufizuar", "konfidencial" dhe "sekret", ndërsa DSIK bën të ditur se shteti shqiptar nuk ka sot për sot asnjë kontratë të nivelit "tepër sekret". Kryeministria është vetëm një nga institucionet që kanë filluar të bëjnë kontrata sekrete. Një institucion tjetër nën varësinë e kryeministrit, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, e cila merret me shërbimet për qeverinë apo zyrtarë të tjerë të lartë, të tilla si shtëpi pushimi apo komoditete të tjera si pritje dhe përcjellje, ka bërë 26 kontrata sekrete gjatë periudhës 2015-2019, nga zero kontrata të tilla më parë. Nga këto, 12 kontrata janë realizuar vetëm gjatë vitit 2018. */BIRN*

Mbledhje qeverie

Kostoja e sigurimit, e njohur në gjuhën teknike si 'prim', varet nga shkalla e rrezikut apo probabiliteti i ngjarjes së pritshme negative. Por në përgjithësi, kostoja e primit luhatet mes një të mijtës dhe 1 apo 2 për qind të vlerës së objektit të siguruar apo dëmit potencial të pritshëm për t'u paguar.

RRITJA

Të dhënat e siguruara nga BIRN nëpërmjet ligjit për të drejtë informimi tregojnë se klasifikimi i prokurimeve publike si sekret shtetëror ka njohur një rritje eksponenciale që nga ardhja në pushtet e kryeministrit socialist, Edi Rama. Nga viti 2014 deri në vitin 2018, qindra kontrata publike, duke filluar nga teknologjia informacionit, mirëmbajtja e ndërtesave publike e deri te shërbimet qeveritare janë klasifikuar si sekret. Sipas KLSH-së dhe ekspertëve nga shoqëria civile, kontratat e klasifikuara sekret sjellin pasoja negative për buxhetin e shtetit, duke kufizuar konkurrencën midis operatorëve ekonomikë dhe duke sjellë kosto shtesë.

VIZITA

Nga Tropoja në Kosovë, Meta në kishën "Shën Nënë Tereza"

Pas vizitës në Tropojë, Presidenti Ilir Meta ndaloi edhe në Kosovë, ku ka vizituar kishën "Shën Nënë Tereza" në Prishtinë. Gjatë vizitës, Meta ndau urimet më të përzemërta për vendimin madhor të Papa Françeskut për të ngritur në nivel ipeshkvie, Administraturën Apostolike të Kosovës. "Përgëzimet më të ngrohta Ipeshkvit të Ipeshkvisë të Kosovës (Prizren-Prishtinë), Imzot Dodë Gjergji dhe mbarë popullit të Kosovës. Falënderime Papa Françeskut dhe Selisë së Shenjtë për përkujdesjen dhe vëmendjen e vazhdueshme e të veçantë ndaj kombit shqiptar", - shkruan Meta.

Ndërhyrja tek Unaza e Re, ARRSH hap procedurat për mbikëqyrjen e Lotit 2

Autoriteti Rrugor Shqiptar hapi të premten e javës së shkuar një procedurë prokurimi lidhur me projektin e rehabilitimit të Unazës së Re në segmentin nga Pallati me Shigjeta te rrethrrotullimi i Doganës. Procedura e prokurimit ka të bëjë me mbikëqyrjen e punimeve dhe pas shpalljes së fituesit që do të mbikëqyrë punimet në Lotin e parë është vijuar me hapjen e garës për të gjetur kompaninë që do të bëjë mbikëqyrjen në lotin 2. Ofertat duhet të paraqiten deri në datë 6 qershor ndërkohë që fondi limit është llogaritur në 10.7 milionë lekë pa TVSH. Por si ndahen lotet në një segment që është vetëm 2.4 kilometra dhe që në total ndërhyrja llogaritet rreth 40 milionë euro. Referuar dokumenteve Loti i parë shtrihet nga progresivi 0+200 deri në progresivin 0+760. Ka të planifikuar ndërtimin e të gjithë nyjës te Shqiponja dhe mbikalimin e mjeteve nga njëra anë në tjetrën të rrugëve sekondare. Loti i dytë shtrihet nga progresivi 0+760 deri 1+600 dhe ka të planifikuar rrugën kryesore rrugët sekondare dhe veprat e artit që përfshihen brenda këtyre piketave si urën mbi Lanë dhe nënkalimin e rrugëve sekondare. Loti i tretë shtrihet nga progresivi 1+600 deri në progresivin 2+390 dhe përfshin përveç segmentit rrugor dhe mbikalimin për mjete që lidh rrugët sekondare dhe nyjat hyrëse në unazë ka të parashikuar ndërtimin e rrugës kryesore dhe rrugëve sekondare në mes këtyre piketave si dhe veprat e artit që përfshihen brenda këtij segmenti. Tenderi për ndërhyrjen në Unazën e Madhe u shoqërua pak muaj më parë me hije skandali për shkak të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara nga kompania e shpallur fituese DH Albania. Në javën e parë të dhjetorit të vitit të shkuar në media u bë publik fakti që një nga kompanitë që fitoi tenderin për ndërtimin e lotit të parë në Unazës së Re kishte paraqitur dokumente të falsifikuara. Nga ana e ARRSH u bë prishje e kontratës ndërkohë që Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë bëri me dije se kishte bërë një komunikim shkresor me ambasadën amerikane. Kompania DH Albania, e cila fitoi procedurën e prokurimit si bashkim operatorësh rezultonte e regjistruar në Delaware të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pas prishjes së kontratës u tha se asaj do t'i sekuestrohej 10 për qind e vlerës së procedurës së prokurimit e lënë si garanci.

Faturim i ri për energjinë, projekti pilot nis në shtator-tetor të këtij viti

Energjia, Çela: Lexim çdo 3 muaj, do të ndryshojë 650 mijë matës

Niveli i faturës do të merret në bazë të mesatares disavjeçare

Në periudhën shtator-tetor të këtij viti Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike planifikon nisjen e pilotimit të sistemit të ri të leximit 3-mujor të matësve, me synimin që më pas ai të shtrihet në të gjithë vendin. Gjatë raportimit të Komisionin parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, administratori, Adrian Çela tha se niveli i faturës në 2 muaj do të jetë në bazë të mesatares disavjeçare, ndërsa fatura e tretë do të jetë sistemuese. Leximi 3-mujor i matësve pritet të ulë kostot për kompaninë e shpërndarjes, por nga ana tjetër do të kërkojë reduktim të personelit. Aktualisht OSHEE nuk e ka përcaktuar rajonin se ku do të pilotohet skema e re, po Çela thotë se synimi është që ajo të jetë gjithëpërfshirëse me gjithë llojet e problematikave. Aplikimi i sistemit të ri të leximit do të kërkojë edhe ndryshimin e rreth 650 mijë matësve induktivë, të cilët klasifikohen nga OSHEE si lehtësisht të manipulueshëm. Lajmi për projektin e ri të OSHEE-së u bë i ditur nga kreu i këtij institucioni Ardian Çela në Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, gjatë seancës dëgjimore me përfaqësues të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, ERE, KESH, OST, OSHEE, AKBN, për problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të raportit vjetor të ERRE 2018. Të ftuar ishin Ilir Bejtja, zëvendësministër i MEI, Enea Karakaçi drejtor juridik në MEI, Adrian Cela, Administrator i OSHEE, Petraq Lika drejtor, Benet Beci Administrator i KESH, Besjan Kadiu drejtor i Departamentit Juridik në KESH, Sokol Dishnica shef kabineti në OST, Ylli Demiri këshilltar, Ilir Belba, drejtor në AKBN, Petrit Ahmeti kryetar ERE etj.

KOMISIONI

Kryetari i komisionit Niko Peleshi në fillim të mbledhjes përmendi disa nga problematikat kryesore, të cilat u bënë për këtë seancë dëgjimore. "Një nga çështjet që u shtrua për diskutim EDHE ka lidhje me bashkëpunimin me OSHEE dhe institucionet përgjegjëse, për marrjen e masave për zgjidhjen e problemit të porosisë së kabinave elektrike, pasi siç rezultonte dhe në raport 51.3% e tyre nuk janë në pronësi të OSHEE-së",-theksoi ndër të tjera Peleshi. Relatori, Arben Pëllumbi gjatë fjalës së tij u shpreh se gjatë shqyrtimit të raportit të ERE u vu në dukje puna e madhe dhe arritjet që janë bërë në sektorin e energjisë nga të gjithë faktorët dhe operatorët e këtij sistemi, në lidhje me uljen drastike të humbjeve. "Gjatë shqyrtimit të këtij raporti, dhe meqenëse jemi në përgatitjen e rezolutës për t'ia paraqitur seancës plenare, na dolën disa problematika që menduam t'i diskutojmë bashkëbisht për të parë mundësinë që ne si anëtarë komisioni të japim kontributin tonë në përshpejtimin dhe zgjidhjen sa më të shpejtë të këtyre problematikave",- vazhdoi më tej, Pëllumbi.

Komisionin parlamentar i Veprimtarisë Prodhuese

Sipërmarrjet e fasoneve

Denaj: Prioritet në rimbursimin e TVSH-së

Angazhimi i qeverisë për të shtuar ndjeshëm rimbursimin e TVSh-së pritet të arrijë ritmet normale brenda këtij tremujori dhe nisur nga muaji korrik normalizohen pagesat e rimbursimeve disa kategori biznesi, duke i bërë ato në mënyrë periodike. Kështu u shpreh ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, gjatë një vizite në një sipërmarrje fasonësh që zhvillon aktivitetin ekonomik në qytetin e Beratit, Center Shqiptar dhe INTEXT. Gjatë kësaj vizite, Ministrja Denaj është njohur nga afër me zhvillimin e këtij biznesi dhe me sfidat që kjo sipërmarrje has në aktivitetin e saj. Së fundmi, kompania ka përfituar nga rimbursimi i TVSH-së, duke lehtësuar në këtë mënyrë veprimtarinë e saj ekonomike. Ministrja Anila Denaj shprehu angazhimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të paguar të gjithë rimbursimet e prapambetura në një kohë sa më të shpejtë dhe informoi se, vetëm në në muajt e parë të vitit 2019 janë paguar afro 12 milionë dollarë, apo 28 % më shumë rimbursime se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. "Në këto 5 muaj ne kemi paguar 12 milionë dollarë më shumë se sa 5 muajt e vitit 2018 dhe besoj se deri në fund të qershorit do të kemi mbyllur të gjithë vonesat për fasonët, për grumbulluesit dhe eksportuesit, në një prioritet që i dhamë me pagesat e TVSH-së për secilën nga këto industri dhe për të gjithë bizneset të monitoruar dhe nga niveli qendror ministrisë",- u shpreh Denaj, ndërsa theksoi se duke nisur nga muaji korrik synohet normalizimi i pagesave të rimbursimeve të TVSh për këto kategori biznesi duke i bërë ato në mënyrë periodike.

SHKURTE

Tremujori 2019, humbjet në rrjet zbritën në 26,2%

Të dhënat e 3-mujorit të parë të vitit, publikuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike tregojnë se niveli i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes ka zbritur në 26,2%. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rezulton të jenë regjistruar 1,46% më pak humbje. Totali i Arkëtimeve ka pësuar një rritje të konsiderueshme në masën 4.6% krahasuar me një vit më parë ndërsa numri i abonentëve të rinj është shtuar me 2,3%. Në 3-mujorin e parë, të ardhurat nga arkëtimet janë 18.3 miliardë lekë me një përmirësim prej 816 milionë Lekë krahasuar me vitin e kaluar. Në periudhën janar-mars 2019 është regjistruar edhe një rënie e numrit të ankesave për faturim në masën 19,8% krahasuar me një vit më parë çka dëshmon për rritjen e cilësisë në shërbim dhe faturim. Mesatarja e ankesave mujore në raport me numrin total të faturave të lëshuara është në nivelin e më pak se 0,6%.

Punimet në bypassin e Vlorës, Qato: Do lehtësojë tregtinë e zhvillojë turizmin

Drejtoresha e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Sonila Qato së bashku me ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku kanë marrë pjesë në inspektimin e punimeve në bypass-in e Vlorës. Qato tha se Bypassi i Vlorës është një vepër e rëndësishme infrastrukturore, e cila do të ndihmojë integrimin rajonal të Shqipërisë, lehtësinë e tregtisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në pjesën jugore të Shqipërisë. Gjithashtu, sipas njoftimit do të zgjidhë njëherë e mirë ngarkesën e trafikut në qytetin e Vlorës dhe në rrjetin rrugor të bregdetit jugor të Shqipërisë. Qato tha se deri më tani realizimi i projektit po vijon sipas afateve të përcaktuara dhe kontraktori garanton përmbylljen punimeve sipas parashikimeve të kontratës. Njoftimi bëri me dije se punimet vijojnë paralelisht në të gjithë seksionet e tij duke garantuar standardet më të mira në ndërtimin e këtij aksi.

Kreu i AMF-së raporton në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave

Aksidentet, Koçi: 1 miliard lekë u paguan nga fondi i kompensimit

U zgjidh problematika e mbartur që nga viti 2002

Në një vit janë shlyer 1 miliard lekë detyr ime të prapambetura të dëmeve në aksidente. Shifra është bërë e ditur nga drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Ervin Koçi, i cili prezantoi sot në Komisionin parlamentar për Ekonominë dhe Financat, raportin mbi aktivitetin e Autoritetit gjatë vitit 2018. Ai u ndal në zhvillimet dhe arritjet kryesore të vitit të kaluar, si edhe përmendi disa nga sfidat me të cilat përballet Autoriteti dhe tregjet nën mbikëqyrje. Në fjalën e tij, drejtori i përgjithshëm ekzekutiv përmendi si një nga arritjet më të rëndësishme zgjidhjen e problematikës së mbartur që nga viti 2002 me pagesat e Fondit të Kompensimit. Vitin e kaluar, shoqëritë kanë paguar mbi 1 miliard lekë për Fondin e Kompensimit, vlerë e cila për herë të parë tregon për pagesa të konsiderueshme të detyrimeve. Koçi u shpreh se Autoriteti ka vijuar të ketë në qendër të vëmendjes mbrojtjen e konsumatorit dhe kjo është reflektuar përmes një sërë vendimesh. Një nga vendimet që ka sjellë më shumë ndikim te qytetarët është ndryshimi i rregullores nr. 53 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit". Sipas ndryshimeve të miratuara, nga 1 korriku 2018, qytetarët shqiptarë përfitojnë një rritje të konsiderueshme të dëmshpërblimit në rastet e aksidenteve. Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv theksoi se Autoriteti rriti më tej transparencën përmes publikimeve të reja me karakter financiar dhe edukues, si edhe njoftimeve paralajmëruese për investitorët e konsumatorët. Në lidhje me ecurinë e tregjeve nën mbikëqyrje, referuar tregut të sigurimeve, ai përmendi përmirësimin e dy treguesve të rëndësishëm: raporti dëme/prime, i cili për herë të parë arriti shifrën 42%, si edhe rritja me 26% e pagesës së dëmeve në krahasim me 2017 dhe me 47% më shumë në krahasim me vitin 2016. Koçi u shpreh se AMF ka punuar për të përmbushur objektivat e përcaktuara në strategjinë 5-vjeçare dhe njëkohësisht ka plotësuar të gjitha rekomandimet e lëna nga Kuvendi. "Ne synojmë që implementimi i kësaj strategjie, që ka nisur vitin e kaluar, të nxisë zhvillimin e një tregu konkurrent dhe efiçent, duke krijuar njëkohësisht stabilitet afatgjatë, duke i dhënë mundësi krijimit të produkteve inovative, duke rritur besimin dhe mbrojtur konsumatorin, me qëllim që nga tregu më i brishtë në rajonin e Ballkanit Perëndimor të shkojmë drejt një tregu më të konsoliduar", theksoi Koçi.

Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Ervin Koçi

PROJEKTLIGJET

Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv përmendi gjithashtu projektligjet e hartuara nga Autoriteti që janë dërguar në Ministrinë e Financave, si projektligji "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" dhe dy projektligjet "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe "Për tregjet e kapitalit". Gjatë mbledhjes në Komisioninn parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, deputetët vlerësuan në përgjithësi punën e bërë nga Autoriteti, si në plotësim e të gjitha rekomandimeve të Kuvendit, ashtu edhe në drejtim të rritjes së mbikëqyrjes, mbrojtjes konsumatore dhe zhvillimit të tregjeve. Në fund të fjalës së tij, drejtori i përgjithshëm ekzekutiv u ndal te bashkëpunimi shumë i mirë i Autoritetit me rregullatorët e vendeve homologe dhe institucionet financiare ndërkombëtare, gjë e cila është reflektuar edhe në vlerësimet e tyre për punën e AMF. Në këtë kuadër, Shqipëria është përzgjedhur për herë të parë nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), si vendi organizator i një konference në nivel botëror, e cila do të zhvillohet në Tiranë në 6-8 nëntor të këtij viti.

Zbulimi i ri i naftës

Balluku: Potencial për zhvillimin e ekonomisë

Prodhimi aktual i naftës së papërpunuar për Shqipëri, në shkallë vendi është përafërsisht 18 mijë fuçi në ditë, ndërkohë që nga ky pus, potenciali parashikon të prodhojë disa mijëra fuçi në ditë, çka vërteton rëndësinë e madhe të këtij zbulimi të ri.

Pas disa vitesh aktivi tetit kërkues dhe vlerësues në Shqipëri, kompania "Shell" ka konfirmuar potencialin e zbulimit të naftës në Bllokun 2 dhe 3, në zonën e Shpiragut. Ndërkohë që nxjerra e fuçive të para pritet të nisë brenda 18 muajsh. Në një dalje për mediat, ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku tha se ky zbulim ka një rëndësi të veçantë, pasi mund të jetë zbulimi i parë i naftës në 30 vitet e fundit në Shqipëri. Rëndësi ka që është zbulur naftë e lehtë që Shqipëria është prodhuese, ekspertët më konfirmojnë se nafta e rëndë nuk është shumë e preferuar dhe e kërkuar në tregje dhe zbulimi i kësaj nafte të lehtë na bën që të fillojmë dhe të kemi një rëndësi të madhe në tregun e hidrokarbureve botëror për sa i përket tregtimit të tij dhe sigurisht, siç dhe unë thash në fjalën time, furnizimi i rafinerive vendëse, por edhe i të huajave me naftë të lehtë është shumë më i kërkuar dhe më i duhuri. Sipas Ballukut, ky zbulim do të ketë implikime të rëndësishme ekonomike si për kompaninë, ashtu edhe shtetin shqiptar. Sikurse përcaktohet në marrëveshjen e hidrokarbureve me "Shell", shteti shqiptar përfiton rentë minerare, pjesën e tij të prodhimit, si dhe tatim mbi fitimin që nga fuçia e parë e prodhuar. Çfarë është edhe më e rëndësishme, prodhimi nga ky pus do të stimulojë punësimin, do të rrisë furnizimin me naftë të rafinerive vendëse, do të inkurajojë krijimin e ekonomive të shkallës në sektorin e 'downstream' dhe do të krijojë standarde më të larta të prodhimit në atë të sektorit 'upstream'.

USAID FROM THE AMERICAN PEOPLE

USAID Justice for All Project in Albania
Scope of Work - Media Component Team Leader

The Justice for All Project in Albania (the Project), implemented by the East-West Management Institute, Inc. (EWMI) and funded by the United States Agency for International Development (USAID), is seeking an experienced Team Leader to head the Project's Component 3 work in the area of fact-checking, media development and investigative journalism.

Position Description: The overall purpose of Component 3 is to build citizen demand for reduction of corruption, fraud, and other criminal activities by exposing these activities through well balanced journalism with an emphasis on court and crime reporting, fact-checking and investigative reporting. The Component 3 Team Leader is responsible for designing, developing and implementing all Component 3 activities, including but not limited to:

- Designing and overseeing all Component 3 activities in order to strengthen investigative journalism skills and fact-checking capacity in Albania;
- Guide the Project's work to build the capacity of the Project's media counterparts;
- Supervise and monitor grants development and implementation in support of achieving Component 3 goals;
- Develop and draft scopes of work for short-term technical assistance (STTA) needed for the successful implementation of Component 3;
- Provide support and guidance to international, regional and national short term technical advisors;
- Draft Component 3 sections of project reports including the quarterly, annual, and other reports and the Component 3 annual work plan;
- Contribute to all other tasks as required by the project Chief of Party.

Minimum Requirements / Knowledge, Skills and Abilities:

1. Five or more years in media/journalism and development, including support to those working in media for training and capacity development;
2. Proven ability to develop and maintain positive working relationships across a broad spectrum of media and journalistic landscapes;
3. Knowledge of Fact Checking as a core tool for media and journalists;
4. Prior experience working on an international development project;
5. Prior experience developing and supervising grants;
6. Fluency in Albanian and English and proven ability to communicate both orally and in writing in both languages;
7. Albanian citizenship required.

Reporting and Supervision
The Component 3 Team Leader will report to the project's Chief of Party.

Timing, Duration, and Place of Performance
This is a full time, long-term position and is expected to continue through the project end date of early March 2021.

How to Apply:
Interested applicants should submit a cover letter that explains how the candidate meets the qualifications, a resume that is no longer than four pages and that includes the names and contact information for three professional references to: jfainfo@ewmi.org.

Please include in the caption of the email the title of the position being applied for. The attachments (cover letter and CV) should likewise be named to include the position applied for and the applicant's last name.

Closing date: **June 2, 2019**

Only those selected for interviews will be contacted.

Applicants should send all communications to the above noted email address and should not contact staff of the Justice for All Project, USAID or EWMI. EWMI does not discriminate on the basis of ethnicity, race, age, gender, or sexual orientation.

Mbyllen hetimet për 613 kg kokainë, Arbër Çekaj i pandehur në mungesë

TIRANË - Prokuroria për Krime të Rënda ka mbyllur hetimet për dosjen e 613 kilogramëve kokainë, që u sekuestruan në shkurt të vitit të kaluar, në kontejnerët e bananeve në portin e Durrësit. Mësohet se pronari i firmës "Arbri Garden", Arbër Çekaj është marrë i pandehur, por në mungesë. Po kështu, të pandehur janë edhe shtetasit Armando Pezaku dhe Donald Lushaj. 42-vjeçarit Çekaj i është komunikuar akuza e trafikut ndërkombëtar të drogës në Gjermani, aty ku ai ka kërkuar azil politik. Autoritet gjermane janë duke kryer një hetim tjetër për Çekajn, pas dyshime se ai mund të jetë i përfshirë në raste të tjerë të trafikut të drogës. Sipas hetimeve, sasia rekord e drogës kapur në Shqipëri kishte si destinacion përfundimtar pikërisht tregun gjerman. Tashmë do të jetë gjykata që do të vendosë. Armando Pezaku ishte shoferi i trailerit që transportonte ngarkesën me banane në të cilën u kap sasia rekord e drogës. Ndërsa, Donald Lushaj ishte menaxheri i firmës "Arbri Garden" në pronësi të Arbër Çekajt, që kishte porositur ngarkesën nga Kolumbia. Çekaj ndodhet në Gjermani, ku edhe atje ka një hetim nga autoritetet, pasi dyshohet se ai është i përfshirë në aktivitet kriminal edhe në territorin e tyre. Më 27 shkurt 2018 u kapën rreth 613 kg kokainë në Maminas në kontejnerët e bananeve të "Arbri Garden", në pronësi të Arbër Çekajt. Aktualisht Çekaj ndodhet në gjykatën gjermane të emigracionit.

Vëllezërit Shyti: Gjyqtari Lara ka qenë i ndikuar politikisht kur dha vendimin

Rikthehet "Hakmarrja për Drejtësi", gjyqtari i dosjes, Dhimitër Lara para vetingut

Orik Shyti dhe Laert Shyti janë ankuar pranë KPK ndaj gjykatësit që i shpalli fajtorë në 2008-ën

TIRANË

Orik Shyti dhe Laert Shyti, të cilët u për folën si anëtarë të "Hakmarrjes për Drejtësi" janë ankuar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ndaj gjykatësit që i shpalli fajtorë në 2008-tën. Vendimi ndaj tyre u prish nga Gjykata e Lartë, e cila e rikthe çështjen për rigjykim në Apelin e Gjykatës së Krimeve të Rëndë, e cila i shpalli të pafajshëm. Sipas "Top Chanel", Orik Shyti dhe Laert Shyti, në ankesën e tyre pranë KPK-së pretendojnë se gjyqtari Dhimitër Lara ka qenë i ndikuar politikisht për t'i dënuar. Sipas tyre, ai është shprehur se nëse do e trajtonte sërish çështjen e tyre, do të jepte të njëjtin vendim. Pas vendimit të Gjykatës së Apelit, që çliroi nga akuzat grupin "Hakmarrja për Drejtësi". Tonet e dy vëllezërve Orik dhe Laert Shyti kanë qenë të ashpra ndaj ish-kryeministrit Sali Berisha. "Ndoshta kanë ndryshuar kohët dhe nuk besojmë se Sali Berisha do t'i shpallë edhe gjyqtarët që dhanë vendimin e sotëm anëtarë të 'Hakmarrjes'. Natyrisht që nuk do ta pengojë vendimi i Gjykatës së Lartë, që shprehet se 'Hakmarrja për Drejtësi' nuk ka ekzistuar kurrë, por është krijuar bashkë me platformën dhe apartamentin e mbushur me armë nga shërbëtorët e tij, nëpunës të shtetit. Kjo dhe vetingu janë dy arsye që mund ta pengojnë t'i shpallë gjyqtarët anëtarë të 'Hakmarrjes', apo të kërcënuar e frikësuar nga 'terroristët' e saj", thuhet në reagimin e vëllezërve Shyti.

Vëllezërit Orik dhe Laert Shyti

GJYKATA SHPALLI TË PAFAJSHËM:

1.Orik Shyti	6.Leart shyti
2.Altin Arapi	7.Kreshnik Spahiu
3.Gentian Caka	8.Pasho Novruzaj
4.Nikolin Novruzaj	9.Gëzim Gjoni
5.Roland Shyti	10.Dritan Hate

PJESË NGA DOSJA "HAKMARRJE PËR DREJTËSI"

Historia e organizatës së ashtuquajtur "Hakmarrja për drejtësi" është unike jo vetëm për ecejaket 20-vjeçare në dyert e gjykatave, por edhe për faktin që gjatë gjithë këtyre viteve ka qenë një çështje, ku asnjëherë nuk u kuptua sa ndikonin provat për krimet që i atribuoheshin dhe sa ndikonte politika. "Hakmarrja për drejtësi" do të artikulohej për herë të parë si organizatë me prirje terroriste dhe me qëllim për të rrëzuar demokracinë pakvjeçare shqiptare më 12 tetor të vitit 1996, kur policia publikoi një foto të një arsenali armësh, të gjetura në një apartament, që i përkisnin kësaj organizate. Më pas, bomba e vendosur tek ishmarketi i VEFA-s pranë pallateve 9-katëshe në Tiranë dhe vrasja e ish-drejtorit të Burgjeve të asaj kohe, Bujar Kaloshi, do të ishin krimet e radhës, për të cilat do të akuzohej "Hakmarrja për drejtësi". Gjatë viti 1996, policia e atëhershme identifikoi Orik Shytin, djali i Aredin Shytit, ish-zv.ministër dhe ministër i Brendshëm për periudhën janar-korrik 1991, i dënuar për vrasjet e 2 prillit 1991. Më pas u arrestuan Laert Shyti dhe Enkeled Agaj. Sipas hetimeve të asaj kohe, kjo organizatë kishte kryer një sërë krimesh në vitet 1992-1996, madje kishte në plan edhe eliminimin fizik të presidentit të atëhershëm të vendit, Sali Berisha. Por, në mars të 1997-ës, të arrestuarit u arratisën nga burgjet dhe dozat e forta politike të procesit ndaj tyre i ndihmuan të fiton azilin politik jashtë vendit. Hetimi ndaj "Hakmarrjes për drejtësi" do të rifillonte në vitin 1998, për të përfunduar 10 vite më vonë në vitin 2008, kur Prokuroria e Krimeve të Rënda arriti të kërkonte dënime për 10 anëtarët e kësaj organizate, të akuzuar për dhjetëra vrasje, grabitje, rrëmbime dhe akte terroriste, kryesisht në vitet 1992-1996.

SHPALLJA TË PAFAJSHËM

Shpallja të pafajshëm

Gjykata e Apelit në Tiranë dhe ajo e Lartë do të linin në fuqi këto masa dënimi, duke firmosur në këtë mënyrë fatin e kësaj organizate. Por, i akuzuari si kreu i organizatës, Orik Shyti, edhe pse në arrati, iu drejtua Gjykatës Kushtetuese, e cila në vitin 2011 do të konstatonte shkelje në gjykimin e kësaj organizate, duke urdhëruar rigjykimin e çështjes. Në 2016-ën, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i konsideroi të pavlefshme provat e mbledhura ndaj 10 personave të akuzuar si pjesë e "Hakmarrjes për Drejtësi". Sipas këtij konstatimi, Gjykata e Lartë e rikthe dosjen për rigjykim në Apelin e Krimeve të Rënda, që e ndodhur në kushtet kur provat janë nul, nuk mundej të shprehej ndryshe. Përgjatë 21 viteve gjykim, 10 të dyshuarit, mes tyre Orik e Laert Shyti dhe Altin Arapi kërkuan pafajësinë në një odise me kthime dhe rikthime nga njëra gjykatë në tjetrën. Provat që Gjykata e Lartë i pohoi si të manipuluara përfshijnë jo vetëm një dokument të sekuestruar, në të cilin sipas ekspertëve grafikë, shkrimi që përshkruan platformën e "Hakmarrjes për Drejtësi" është i falsifikuar, por edhe këqyrje banesash, marrje dëshmish dhe sekuestro të ndryshme.

Si u arratisën dy shqiptarët Gega dhe Markja nga burgu në Itali

ITALI - Dy të rinj me origjinë shqiptare rreth 20 vjeç janë shpallur në kërkim nga policia italiane, pasi kanë mundur të arratisen nga burgu në Caserta. Të arratisurit janë identifikuar si Adriatik Gega dhe Ervis Markja. Lajmi ishte dhënë nga sekretari rajonal i policisë, Ciro Auricchio dhe sekretari kombëtar Giuseppe Moretti. Të dy të burgosurit që tani janë në arrati kanë arritur të shmangin sistemin e mbikëqyrjes dhe të largohen nga objekti i burgut. Arratisja ka ndodhur rreth orës 03:00 të mëngjesit, shkruajnë mediat italiane. Të dy janë larguar pasi kanë sharruar hekurat e qelisë së burgut. E gjithë ngjarja ka ndodhur në kohën që po binte shi i madh. Arratisja e tyre ka bërë bujë dhe për rastin e tyre, tanimë janë vënë në dijeni autoritetet e mbarë vendit. Adriatik Gega është arrestuar dhe burgosur në vitin 2012, nën dyshimin se i përkiste një grupi që grabiste banesat në zonë. Kurse, Ervis Markja u arrestua në janar 2016 me akuza për konkurrencë në marrjen e mallrave të vjedhura dhe rezistencë ndaj një zyrtari publik. Së paku 60 agjentë janë vënë menjëherë në lëvizje për të gjetur dy të arratisurit.

40-vjeçari shqiptar gjendet i vdekur në Belgjikë, trupi në kanal

BELGJIKË - Një 40-vjeçar shqiptar është gjetur i pajetë në një kanal në Vinderhoute, Lievegem të Belgjikës. Lajmin e raportuan këtë të hënë mediat lokale, duke iu referuar burimeve zyrtare të Prokurorisë lokale. Sipas medias belge "Het Laatste Nieuws", trupi i shqiptarit u zbulua nga një kalimtar rreth orës 8.30 të mëngjesit, të hënën e 20 majit. Ishte ai që dha alarmin dhe lajmëroi autoritet. Departamenti i zjarrfikësve nxori kufomën nga uji dhe lajmëroi policinë e prokurorinë. Hetimet treguan se kemi të bëjmë me vrasje. "Ka shenja se ndaj viktimës është ushtruar dhunë", citohet zyra e prokurorisë nga media blege. Ndërsa hetimet vazhdojnë, ende nuk është bërë i ditur identiteti i viktimës dhe detaje të tjera nga hetimi.

I mbijetuari, i akuzuar për vrasjen e avokatit grek. Banorët: Viktima, i pafajshëm

Atentati në Vlorë, ekzekutohet 22-vjeçari Sotiraq Mëhilli, shpëton shënjestra Eno Mata

Dy të rinjtë ishin shokë. Ata po ktheheshin me motor për në banesat e tyre kur u qëlluan nga autorët

VLORË

Një tjetër atentat me armë zjarri ka tron ditur Vlorën. Në këtë atentat ka mbetur i vrarë një i ri, ndërsa një tjetër është plagosur rëndë dhe ndodhet në spital në gjendje kritike për jetën. Mësohet se viktimë e atentatit ka mbetur 22-vjeçari Sotiraq Mëhilli, të cilin e ka kapur vetëm një plumb, por që ka rezultuar fatal për të, pasi e ka prekur në aortën kryesore.

Ngjarja e rëndë ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në fshatin Poro të njësisë administrative Novoselë. Dy të rinjtë janë qëlluar me armë zjarri në kohën kur po ktheheshin me një motor drejt shtëpive të tyre. Ndërkohë, mësohet se një makinë tip "Mercedes Benz" ka qenë duke i pritur në rrugë dhe më pas persona që ndodheshin në këtë automjet kanë qëlluar në drejtim të dy të rinjve, duke i marrë jetën kështu 22-vjeçarit Mëhilli dhe duke plagosur rëndë 32-vjeçarin e Eno Mata, apo siç njihet ndryshe si Aleksandër Mata. Pak kohë pas atentatit, në fshatin Bishan është gjetur një automjet i djegur, i cili dyshohet të jetë përdorur nga atentatorët. "Më datë 27.05.2019, rreth orës 01:10, në fshatin Poro (rrugë) në rrethana ende të paqarta është qëlluar me armë në drejtim të shtetasve E.M. dhe S.M., të cilët po udhëtonin me motor. Si pasojë, të dy shtetasit janë plagosur, ku rrugës për në spital ka ndërruar jetë 22-vjeçari S.M., ndërsa shtetasi E.M., 32 vjeç, ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore. Forca të shumta të Policisë Vlorë dhe FNSH-së po krehin zonën, ku në fshatin Bishan është konstatuar duke u djegur një automjet tip 'Mercedes Benz', i cili dyshohet të jetë përdorur nga autori/rët. Është ngritur një grup i posaçëm hetimor, i cili vijon punën për zbardhjen e ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Në vendin e ngjarjes mësohet se janë gjetur dy kallashnikovë dhe një makinë e djegur me targa false. Në lidhje me atentatin, policia ka shoqëruar 7 persona që mendohet të kenë informacion mbi ngjarjen, e cila tronditi fshatin Poro të Vlorës. Ndërsa, hetimet janë shtrirë në disa pista, përfshirë që nga vrasja e avokatit grek e deri te konfliktet e mundshme në zonën ku dy të rinjtë jetonin. Nga hetimet pritet të sqarohet motivi i krimit, ndërsa dyshohet se shënjestra e atentatit ka qenë Eno Mata, i cili është qëlluar nga autorët me 4 plumba. Sipas banorëve të zonës, dy të rinjtë ishin shokë mes tyre dhe se nuk njiheshin si persona problematikë. Një i afërm i viktimës, i cili njihte edhe të plagosurin, pohoi se atentati mund të jetë pasojë e të shkuarës kriminale të Eno Matës në Greqi. Sipas tij, i gjithë fshati e dinte që 32-vjeçari ndiqej nga policia greke. "Të dy djemtë që u bënë objektiv i atentatit ishin të qetë në fshat dhe nuk shkaktonin probleme", pohuan banorët e fshatit Poro.

Viktima Sotiraq Mëhilli

I mbijetuari i atentatit, Eno Mata

Vendi ku ndodhi vrasja

TË AFËRMIT DHE BANORËT

Sipas banorëve të zonës, dy të rinjtë që ranë në pritën e atentatorëve ishin shokë mes tyre dhe se nuk njiheshin si persona problematikë. Një i afërm i viktimës, i cili njihte edhe të plagosurin, pohoi se atentati mund të jetë pasojë e të shkuarës kriminale të Eno Matës në Greqi. Sipas tij, i gjithë fshati e dinte që 32-vjeçari ndiqej nga policia greke. "Të dy djemtë që u bënë objektiv i atentatit ishin të qetë në fshat dhe nuk shkaktonin probleme", pohuan banorët e fshatit Poro.

VRASJA E AVOKATIT GREK

Autori i vrasjes së avokatit të njohur grek, Mihalis Zafeiropoulos në zyrën e tij, më 12 tetor 2017 është "vetëzbuluar" nga një letër që i ka lënë policisë. Ai quhet Eno Aleksandro Mata dhe policia greke dyshon se është autori i dytë i vrasjes së Zafiropulos. Në qershor të vitit 2018, ai ka marrë pjesë në grabitjen e një argjendarie bashkë me pesë shqiptarë të tjerë dhe siç raportojnë mediat greke, i ka lënë një pusullë policisë ku shkruante: - "Në vrasjen e avokatit Zafiropulos jemi të dy viktima. Jam hajdut, jo ekzekutues".

Flet Eno Mata: Dyshoj se vjen nga Greqia, kam grabitur, s'kam vrarë

VLORË - "Dyshoj se gjithçka vjen nga Greqia". Është kjo deklarata e parë gjatë rrugës për në spital e shënjestrës së atentatit në Poro të Vlorës, Eno Mata. Në prani të policisë, i plagosuri Mata tha se nuk ka kryer asnjë vrasje në Greqi dhe ndoshta e ngatërrojnë me ndonjë pjesëtar të ndonjë grupi kriminal. "Dyshoj se gjithçka vjen nga Greqia. Nuk kam kryer vrasje në Greqi, kam grabitur, ndoshta më ngatërrojnë me ndonjë pjesëtar të ndonjë grupi kriminal". Pas atentatit në Poro të Vlorës, gazetari i "ABC News" ka marrë në pyetje disa banorë të zonës, që njihnin viktimën dhe të plagosurin.

Banor: E njoh si fytyrë, familje shumë e mirë, nuk e ka babain.

Gazetari: Po Eno Matën e njihni?

Banor: Po e njoh, ka jetuar në Greqi.

Gazetari: Me çfarë merreshin këta çunat?

Banor: Me bujqësi, siç bëjmë ne. Eno Mata familjen e ka në Greqi.

Gazetari: Ka pasur probleme në Greqi?

Banor: Nuk di, djalë i sjellshëm. /"ABC News"

Nipi mbeti i vrarë në atentat, xhaxhai: S'ishte problematik, punonte në fshat me traktor

VLORË - Pas ngjarjes së rëndë ku humbi jetën i riu 22-vjeçar, Sotiraq Mëhilli, xhaxhai i tij ka folur për "News 24" dhe për " Gazeta Shqiptare", ku tha se nipi i tij ishte i qetë, ndërsa shton se ai me të plagosurin Eno Mata ishin shokë mes tyre. Ai shtoi se të gjithë e dinin se Eno Mata ishte në kërkim nga policia e Greqisë, por shton se në fshat i plagosuri nuk kishte konflikt me asnjë person. "Nipi ishte i qetë, nuk ishte tip problematik. Eno Matën ai e kishte shok. Nipi punonte me traktor në fshat. Sotiraqi nuk kishte shkuar jashtë shtetit. Nuk

e dimë si qëndron e vërteta. Familjarët e Eno Matës jetojnë në Greqi. Eno Mata ishte në ndjekje nga policia në Greqi. Në fshat e dinim që ai ka kryer krime në Greqi. Prej 2 vitesh Mata është kthyer në Shqipëri. Ai në fshat nuk kishte konflikte", - u shpreh xhaxhai i Mëhillit. Dy të rinjtë ranë në pritën e breshërive të kallashnikovit në orët e para të mëngjesit të djeshëm teksa po ktheheshin me motor në shtëpitë e tyre, ndërsa autorët u arratisën pa lënë gjurmë. Policia dhe FNSH-ja në orët e para të mëngjesit konstatuan një makinë të djegur, e cila dyshohet të jetë përdorur nga autorët. Në lidhje me atentatin, policia ka shoqëruar 7 persona që mendohet të kenë informacion mbi ngjarjen, e cila tronditi fshati Poro të Vlorës.

KUSH ËSHTË I PLAGOSURI ENO MATA

32-vjeçari, i cili ndodhet në spital në gjendje kritike për jetën apo siç njihet ndryshe, Aleksandër Mata, rezulton të jetë person me precedentë penalë në Greqi, ndërsa dyshohet si njëri prej autorëve të vrasjes së avokatit të njohur grek, Mihalesi Zafeiropoulos. Mata bashkë me disa shqiptarë të tjerë kanë grabitur një argjendari në rrugën "Zografou" në Athinë në qershorin e vitit të kaluar, ndërsa pas kësaj ngjarjeje ishte shpallur në kërkim nga autoritetet greke. Pas grabitjes, Aleksandër Mata shkroi në gjuhën greke një pusullë me mbishkrimin ku theksonte se ai është grabitës, por nuk është vrasës. "Sa i përket çështjes së z.Zafeiropoulos, jemi të dy viktima. Unë di të mbaj përgjegjësinë time. Nëse do ta dija si do të shkonin punët, nuk do të bëhej kështu siç u bë. Po, unë vjedh, por nuk jam vrasës", - shkroi ai në letër, ndërsa në fund kishte shënimi "Maradona-këmbëshpejti". Nga ana tjetër, Eno Mata nuk ishte në kërkim nga Policia e Shtetit, ndërsa viktima nuk njihej si person problematik.

Urdhri: Kujdes, mos tregtoni ilaçe jashtë listës OTC, penalizim sipas ligjit

Zbardhet lista e barnave që do të merren pa recetë nga mjeku

Cilat janë 813 medikamentet që jepen me udhëzim nga farmacisti

Voltiza Duro

Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë ka pub likuar listën e barnave që tregtohen pa recetë mjekësore, në përgjigje të gjithë atyre që nuk kanë arritur ta gjejnë. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot listën e plotë me emërtimet e 813 barnave, të cilat merren pa recetë nga mjeku. "Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 1, të nenit 52, të ligjit nr. 105, datë 31.7.2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, si dhe në shkresën nr. 3200/1 prot., datë 2.7.2018, të Komisionit të Përhershëm të Barnave, "Mbi propozimin për përditësimin e listës së barnave pa recetë mjekësore në Republikën e Shqipërisë" urdhëroj: Miratimin e listës së barnave OTC, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri",-theksohet në urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë. Ndërkohë në farmaci dhe agjencitë farmaceutike lejohet tregtimi pa recetë mjekësore vetëm i barnave që përfshihen në listën OTC. Farmacistët duhet të bëjnë kujdes pasi tregtimi në farmaci pa recetë mjekësore i barnave jashtë kësaj liste përbën shkelje administrative dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi. Kjo listë përfshin ato barna që janë të sigurta dhe që përdoren në kurimin e problemeve joserioze, në mënyrë që pacienti t'i përdorë pa pasur nevojë të shkojë te mjeku e për t'u pajisur me recetë. Por, meqenëse tregtohen në farmaci, t'i marrin duke u këshilluar me farmacistin lidhur me zgjedhjen e saktë dhe përdorimin korrekt.

LISTAT E BARNAVE QE DO TE MERREN PA RECETE

Nr.	EMRI TREGTAR	FORMË-DOZA
1	ABROBION	Shurup 30 mg/5ml
2	ABROLEN	Shurup 30 mg/5ml
3	ABUFENE	Tableta 400 mg
4	ACC 200	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja 200 mg/qeskë
5	ACC AKUT 600 MG	Tableta efervesheshte 600 mg
6	ACC KINDERSAFT	Tretësirë për përdorim nga goja 20 mg/ml
7	ACECYS	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja 200 mg/qeskë
8	ACECYS ACUTE	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja 600 mg/qeskë
9	ACERBINE	Pomadë (0,7g + 0,05g + 0.0133g)/100g
10	ACERBINE	Tretësirë kutane (2.1525g + 0.041g + 0.154g)/100g
11	ACESTAD	Tableta efervesheshte 200 mg
12	ACESTAD	Tableta efervesheshte 600 mg
13	ACETYSAL CARDIO	Tableta gastrorezistente 100 mg
14	ACICLINLABIALE	Stik kutan 5%
15	ACICLOSTAD GEGEN LIPPENHERPES	Krem 50 mg/g
16	ACICLOVIR ABC	Krem 5%
17	ACIDE FOLIQUE CCD 0.4 MG	Tableta 0.4 mg
18	ACIDO SALICILICO NOVA ARGENTIA	Pomadë 5%
19	ACQUA PER PREPARAZIONI INIETTABILI MONICO	Ujë për injeksion
20	ACTICARBINE	Tableta të veshura (70 mg + 14 mg)
21	ACTIFED	Shurup 30 mg/5ml + 1,25 mg/5ml
22	ACTISOUFRE	Tretësirë për spraj në gojë dhe hundë
23	ACTONORM Xhel	Pezulli për përdorim nga goja (220 mg + 200 mg + 25 mg)/5ml
24	ADOLORIN	Tableta (50 mg + 250 mg + 300 mg)
25	ADVIT	Tretësirë për përdorim nga goja, pika (10000IU + 10000IU)/1ml
26	AEROGAL	Shurup 0.5 mg/ml
27	A-FERIN HOT	Granula (500 mg + 60 mg)/ qeskë
28	A-FERIN PLUS	Shurup (3.2g + 0.3g + 0.02g)/100ml
29	AFLEN	Kapsula të forta 300 mg
30	AGELMIN	Tableta të veshura me film 10 mg
31	AGIOLAX	Granula ê2.6g + 0.11g + (0.34-0.66g))/5g
32	ALBADOL	Tabletë e veshur me film 400 mg
33	ALBADOL PLUS	Tabletë (400 mg + 325 mg)
34	ALCET	Tableta të veshura me film 10 mg
35	ALERINIT	Tableta të veshura me film 5 mg
36	ALERIX	Tabletë e veshur me film 120 mg
37	ALGINE	Tableta (20 mg + 150 mg + 50 mg + 300 mg)
38	ALGOFREN	Shurup 100 mg/5ml
39	ALKOOL BORIK	Tretësirë 25 mg/ml
40	ALOPEXY	Tretësirë për përdorim në lëkurë 2%
41	ALORA	Shurup 694 mg/5ml
42	ALORA	Tableta të veshura 100 mg
43	ALOXIDIL	Tretësirë për përdorim në lëkurë 2g/100g
44	ALRINAST	Shurup 2.5 mg/5ml
45	ALRINAST	Tableta të veshura me film 5 mg
46	ALRINAST	Shurup 2,5 mg/5ml
47	ALRINAST	Tabletë e veshur me film 5 mg
48	ALTERGEN	Krem (0,2% + 1%)
49	ALUKOL	Tableta 500 mg
50	ALVOFEN EXPRESS	Kapsula të buta 200 mg
51	ALVOFEN EXPRESS	Kapsula të buta 400 mg
52	AMBREKS	Shurup 15 mg/5ml
53	AMBREKS	Shurup 30 mg/5ml
54	AMBROTUS	Shurup 30 mg/10ml
55	AMOBRONC	Shurup 15 mg/5ml
56	ANALGIN	Tableta 500 mg
57	ANALGINA-RAD	Tableta 500 mg
58	ANALGINE	Tableta 500 mg
59	ANAPRAN EC	Tableta të veshura enterike 250 mg
60	ANCOPIR	Tabletë e veshur (0.3 mg + 100 mg + 200 mg)
61	ANGAL	Tableta-karamele (5 mg+1 mg)
62	ANGAL LEMON	Tabletë për t'u mbajtur në gojë (5 mg +1 mg)
63	ANGAL S	Spraj për fyt, tretësirë (2.1 mg + 0.5 mg)/ml
64	ANTARENE	Xhel 5%
65	ANTARENE	Tableta 400 mg
66	ANTARENE	Pezulli për përdorim nga goja 20 mg/ml
67	ANTIFUNGOL	Krem 10 mg / g
68	ANTIHEMORROIDALE	Suposta (0.03g + 0.08g + 0.10g + 0.10g + 0.10g + 0.04g)
69	ANTROLIN	Krem për përdorim rektal (0.3 mg + 1.5 mg)/100g
70	ANZIBEL LOZENGE WITH HONEY AND LEMON FLAVOR	Tableta-karamele (5 mg + 4 mg + 3 mg)
71	ANZIBEL LOZENGE WITH	Tableta-karamele (5 mg + 4 mg + 3 mg)
72	APIREKS	Pezulli për përdorim nga goja 100 mg/5ml
73	APOTEL	Tableta efervesheshte 500 mg
74	APOTEL	Suposta 125 mg
75	APOTEL	Suposta 250 mg
76	APOTEL	Suposta 500 mg
77	APRANAX PLUS	Xhel (100 mg+50 mg)/g
78	APRINOL	Shurup 30 mg/5ml
79	APRINOL	Shurup 15 mg/15ml
80	AQUA AD INIECTABILIA ALKALOID	Ujë për injeksion
81	ARFEN	Suposta 125 mg
82	ARFEN	Suposta 250 mg
83	ARFEN	Tableta 500 mg
84	ARGEDIN	Krem 10 mg/g
85	ARGENTO PROTEINATO NOVA ARGENTIA	Pika për hundë, tretësirë 0.5% (w/w)
86	ARGENTO PROTEINATO NOVA ARGENTIA	Pika për hundë, tretësirë 1% (w/w)
87	ARGENTO PROTEINATO NOVA ARGENTIA	Pika për hundë, tretësirë 2% (w/w)
88	ARIA-DES	Tabletë e veshur me film 5 mg
89	ARTROSILENE	Shkumë për përdorim në lëkurë 15%
90	ARTROSILENE	Xhel 5%
91	ARTHRODONT	Pastë për mishrat e dhëmbëve 1%
92	ARTHROLOC	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja 1500 mg/qeskë
93	ASIST	Kapsula 200 mg
94	ASIST 4%	Granula për shurup 4 g / 100ml
95	ASIST 4%	Granula për shurup 6 g/150ml
96	ASIST PLUS	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja 600 mg/ qeskë
97	ASP	Tabletë 100 mg
98	ASPIRIN	Tableta 500 mg
99	ASPIRIN PLUS C	Tableta efervesheshte 400 mg + 240 mg
100	ASPIRIN PROTECT	Tableta gastrorezistente 100 mg
101	ASPIRINE	Tableta 500 mg
102	ATASOL FORTE tablets 500 mg	Tabletë 500 mg
103	AULIN 3%	Xhel 3g/100g
104	BABY LUUF BALSAM	Balsam (15 mg + 40 mg + 10 mg)/g
105	BASIFLUX	Shurup 0.8 mg/ml
106	B-COMPLEX	Tableta të veshura (4 mg + 5 mg + 2 mg + 1µg + 5 mg + 25 mg + 20 mg)
107	BEKUNIS	Tabletë 5 mg
108	BEKUNIS	Çaj bimor 60g/100g
109	BENEKID PLUS	Pezulli për përdorim nga goja 160 mg/5ml
110	BENLEK	Tabletë (500 mg + 38.75 mg + 50 mg)
111	BEN-U-RON	Suposta 125 mg
112	BEN-U-RON	Suposta 250 mg
113	BEN-U-RON	Shurup 200 mg/5ml
114	BEN-U-RON	Tableta 500 mg
115	BEPANTHEN	Krem 50 mg/g
116	BEPANTHEN	Pomadë 50 mg/g
117	BEPANTHEN plus	Krem (50 mg + 5 mg)/g
118	BÉRES DROPS PLUS	Tretësirë për përdorim nga goja, pika (2 mg + 1,14 mg + 0,40 mg + 0,31 mg + 0.25 mg + 0.19 mg + 0.12 mg + 0.11 mg +0.10 mg + 0.090 mg + 0.025 mg) ml
119	BETADINE	Pomadë 100 mg/1g
120	BETADINE	Ovulë 200 mg
121	BETADINE	Tretësirë për përdorim në lëkurë 10g/100ml
122	BETRIMINE	Shurup (10 mg + 10 mg + 0.1 mg)/5ml
123	BILOBIL	Kapsula të forta 40 mg
124	BILOBIL FORTE	Kapsula të forta 120 mg
125	BILOBIL FORTE	Kapsula të forta 80 mg
126	BIOFLOR	Pluhur për pezulli për përdorim nga goja 282.5 mg/qeskë
127	BIOFLOR	Kapsula 282.5 mg
128	BISACODYL-GRINDEKS	Tabletë gastrorezistente 5 mg
129	BISALAX	Tableta gastrorezistente 5 mg
130	BISOLVON	Tretësirë për përdorim nga goja 0.2g/100ml
131	BISOLVON	Tableta 8 mg
132	BLOKMAX	Tabletë e veshur me film 200 mg
133	BLOKMAX FOR KIDS	Pezulli për përdorim nga goja 100 mg/5ml
134	BLOKMAX FORTE	Tabletë e veshur me film 400 mg
135	BLUMETILEN 1%	Tretësirë për përdorim të jashtëm 1%
136	BOROMENTOL	Tableta të veshura (10 mg + 5 mg + 2 mg + 2 mg)
137	BROMEX	Shurup 5 mg/5ml
138	BROMHEKSINE	Pika për përdorim nga goja, tretësirë x 2 mg/ml
139	BROMHEKSINE	Tableta 8 mg
140	BROMHEXINE SOPHARMA	Shurup 4 mg/5ml
141	BRONAX	Shurup 4 mg/5ml
142	BRONCHOBOS	Shurup 2.5%
143	BRONCHOBOS	Shurup 5%
144	BRONCHOSTOP SINE	Tretësirë për përdorim nga goja (0.77g + 7.69g)/100g
145	BRONCHOSTOP Thymian Eibisch Hustensaft	Tretësirë për përdorim nga goja (13.5g + 11.53g)/100g
146	BRONCHOSTOP Thymian Eibisch sine Hustensaft	Tretësirë për përdorim nga goja (0.7g + 4.96g)/100g
147	BRONCHOSTOP Thymian Salbe Hals-und Rachenspraj	Spraj oromukozal (32g + 32g) / 100g
148	BRONCHOTUSSINE	Shurup 4 mg/5ml
149	BRONCOSIL	Shurup 6 mg/ml
150	BRON-HAL	Shurup 4 mg/5ml
151	BRONLES	Kapsula të forta 375 mg
152	BRONLES	Tretësirë për përdorim nga goja 250 mg/5ml
153	BRONLES	Tretësirë për përdorim nga goja, for children 125 mg/5ml
154	BRUFEN	Tableta 400 mg
155	BRUFEN	Granula efervesheshte 200 mg/qeskë
156	BRUFEN EFFECT	Granula efervesheshte 400 mg/qeskë
157	BRUFEN SYRUP	Shurup 100 mg/5 ml
158	BRULEX	Pomadë (5g + 0.5g + 0.03g + 0.0036g + 1g)/100g
159	BUSCOPAN	Tableta të veshura 10 mg
160	BUSCOPAN 10 MG	Suposta 10 mg
161	CADTRE	Granula efervesheshte (1000 mg + 880 IU)/qeskë
162	CAFFETIN	Tableta (250 mg + 210 mg + 50 mg + 10 mg)
163	CAFFETIN COLD	Tableta të veshura me film (500 mg + 30 mg + 15 mg + 60 mg)
164	CAFFETIN COLDMAX	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja (1000 mg + 12.2 mg)/qeskë
165	CAFFETIN MENSTRUAL	Tableta të veshura me film 200 mg
166	CAFFETIN SC	Tableta (250 mg + 210 mg + 50 mg)
167	CALCIGEN D	Tableta për t'u përtypur (600 mg + 400 I.U.)
168	CALCIRAD	Tableta 500 mg
169	CALCIUM 500 MG HEXAL	Tableta efervesheshte 500 mg
170	CALCIUMVITAC	Tableta efervesheshte (260 mg + 500 mg)
171	CALIXAM	Krem 10 mg/g
172	CALMABEN	Tableta të veshura 50 mg
173	CANESTEN	Krem 1% (10 mg/g)
174	CANESTEN	Tretësirë 1g/100ml
175	CANESTEN 3	Krem vaginal 20 mg/g
176	CANESTEN 3	Tableta vaginale 200 mg
177	CARBOSYLANE	Kapsula (140 mg + 45 mg)
178	CARDIOPIRIN	Tableta gastrorezistente 100 mg
179	CARE HAEMORRHOID RELIEF Pomadë	Pomadë (0.5% w/w + 0.5% w/w)
180	CATHEJELL	Xhel (2g + 0.05g)/100g
181	CETERIS	Tableta të veshura me film 10 mg
182	CETIRIZINA ABC	Tableta 10 mg
183	CETIRIZINA BLUEPHARMA	Tableta të veshura me film 10 mg
184	CETIRIZINA GP	Tableta të veshura me film 10 mg
185	CETIRIZINE	Tableta të veshura me film 10 mg
186	CICLOVIRAL	Krem 50 mg/g
187	CISTIDIL	Tableta 500 mg
188	CIVRAL	Krem 5%
189	CLARUS	Tretësirë për përdorim nga goja 0.5 mg/ml
190	CLODERM CREME 1%	Krem 10 mg/1g
191	CLOTRI-DENK 1% Krem	Krem 1%
192	CLOTRIMAZOL BASI	Krem 10 mg/g
193	CLOTRIMAZOL BASI	Tretësirë për përdorim në lëkurë 10 mg/g
194	CLOTRIMAZOLE ATB	Krem 10 mg/g
195	COCO-SCALP	Pomadë (2% + 4% + 12%) w/e
196	COLDAWAY COLD & FLU	Tableta të veshura me film (200 mg + 30 mg)
197	COLDREX	Tableta (500 mg + 30 mg + 25 mg + 20 mg + 5 mg)
198	COLDREX HONEY & LEMON	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja (750 mg + 60 mg + 10 mg)/qeskë
199	COLLUNOVAR 0.11%	Tretësirë për spraj 0.11%
200	CONNETTIVINA PLUS	Krem (0.2% + 1%)
201	CONNETTIVINA PLUS	Garze e imprenjuar (2 mg + 40 mg)/10cm 10cm
202	CONNETTIVINA PLUS	Garze e imprenjuar(4 mg + 80 mg)/10cm 20cm
203	CONNETTIVINA PLUS	Garze e imprenjuar (12 mg + 240 mg)/20cm 30cm
204	CONTRAHIST	Tableta të veshura me film 5 mg
205	CONTRAHIST	Tretësirë për përdorim nga goja 0.5 mg/ml
206	COQUELUSEDAL PARACETAMOL	Suposta 250 mg
207	COQUELUSEDAL PARACETAMOL	Suposta 100 mg
208	CUTISAN	Pluhur për përdorim lokal 1g/100 g
209	CYCLO 3 FORT	Kapsula të forta (150 mg + 150 mg + 100 mg)
210	CYNACUR	Tableta të veshura 300 mg
211	CYNARIX	Tableta të veshura 55 mg
212	CYTEAL	Tretësirë për përdorim të jashtëm (0.1g + 0.5ml + 0.3g)/100ml
213	DAGESIL	Xhel 10 mg/g
214	DAKTANOL	Xhel për përdorim në gojë 0,02
215	DALERON	Pezulli për përdorim nga goja 120 mg/5ml
216	DALERON	Tableta 500 mg
217	DALERON C	Granula për tretësirë për përdorim nga goja (500 mg + 20 mg)/qeskë
218	DALERON C JUNIOR	Granula për tretësirë për përdorim nga goja (120 mg + 10 mg)/qeskë

219	DALERON COLD3	Tableta të veshura me film (325 mg + 30 mg + 15 mg)
220	DASSELTA	Tableta të veshura me film 5 mg
221	DEEP HEAT RUB	Krem (1.97% + 1.47% + 5.910% + 12.8%)
222	DEEP RELIEF	Xhel (5% + 3%)
223	DEFLAMOL	Pomadë (350 IU + 400 IU)/g
224	DEKSALGIN	Tableta të veshura 25 mg
225	DEKSALGIN	Xhel 12.5 mg/g
226	DERMASPOR	Xhel 0.5%
227	DERMODRIN	Pomadë 2g/100g
228	DESLODIN	Shurup 2.5 mg/5ml
229	DESLORATADINA NORMON 0.5 MG/ML SOLUCION ORAL	Tretësirë për përdorim nga goja 0.5 mg/ml
230	DESLORATADINA NORMON 5 MG COMPRIMIDOS RECUBIERTOS CON PELICULA	Tabletë e veshur me film 5 mg
231	DESLORATADINE ALVOGEN	Tableta të veshura me film 5 mg
232	DESLORATADINE ALVOGEN	Tretësirë për përdorim nga goja 0.5 mg/ml
233	DEXERYL	Krem (15g + 8g + 2g)/100g
234	DEXIREN	Tableta të veshura 25 mg
235	DEXKETOPROFENO NORMON	Tabletë e veshur me film 12.5 mg
236	DEXKETOPROFENO NORMON	Tabletë e veshur me film 25 mg
237	DEXKETOPROFENO NORMON	Granula për tretësirë për përdorim nga goja 25 mg/qeskë
238	DIACOL	Shurup 1.8 mg/ml
239	DICLAC SCHMERZ Xhel	Xhel 1%
240	DICLODENT	Tretësirë, për përdorim oromukozal 0.74 mg/ml
241	DIFRAREL	Tableta të veshura (100 mg + 5 mg)
242	DIFRAREL E	Tableta të veshura (50 mg + 50 mg)
243	DIKLORON	Xhel 1% (w/w)
244	DIMEGAN	Kapsula 12 mg
245	DIMIDON	Tabletë e veshur me film 400 mg
246	DIMIDON	Pezulli për përdorim nga goja 20 mg/ml
247	DIOVOL PLUS	Tabletë (300 mg+100 mg+25 mg)
248	DIVIDOL	Tableta të veshura 10 mg
249	DOLOFIX	Tabletë 500 mg
250	DOLOFIX EXTRA	Tabletë (500 mg + 65 mg)
251	DOLOFIX FORTE	Tabletë 750 mg
252	DOLOFLEX	Spraj 4%
253	DOLOHOT	Pluhur për pezulli për përdorim nga goja (500 mg + 2 mg + 5 mg)/qeskë
254	DOLOKIDS	Shurup 120 mg/5ml
255	DOLOKIDS GRIP	Shurup (100 mg + 20 mg + 1 mg)/5ml
256	DONA	Tableta të veshura me film 750 mg
257	DONA	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja 1500 mg/qeskë
258	DOROXAN	Shkumë për përdorim në lëkurë 1%
259	DOXAFIN	Tabletë e veshur me film 5 mg
260	DRENOXOL	Shurup 3 mg/ml
261	DRENOXOL	Shurup 3 mg/ml
262	DULCOLAX	Tableta të veshura 5 mg
263	DULCOLAX	Suposta 10 mg
264	DUOVIT	Tableta të veshura (5000 IU + 200 IU + 60 mg + 13 mg + 10 mg + 5 mg + 2 mg + 1.2 mg + 1 mg + 0.4 mg + 3µg) + Tableta të veshura me ngjyrë blu (20 mg + 15 mg + 12 mg + 10 mg + 3 mg + 1 mg + 1 mg + 0.1 mg)
[illegible]	DURILAC	Xhel 1%
267	ECHINACIN CAPSETTEN MADAUS	Tableta-karamele 88.5 mg
268	ECHINACIN JUICE MADAUS LIQUID	Tretësirë 2.34g/100g
269	ECHINACIN LIQUIDUM MADAUS	Tretësirë 80g/100g
270	ECHINACIN TABLETS MADAUS	Tableta 100 mg
271	ECONAZOL	Krem 1%
272	ECONAZOLE EG 1%	Krem 1% (w/w)
273	ECONAZOLE EG 1%	Emulsion për lëkurë 1% (w/w)
274	EFISOL	Tableta-karamele 30 mg + 0.25 mg
275	EKONAL	Ovulë vaginale 150 mg
276	ELEVIT PRONATAL	Tableta të veshura me film (3600 IU + 1.5 mg + 1.8 mg + 2.6 mg + 4µg + 100 mg + 500 IU + 15 IU + 10 mg + 0.2 mg + 19 mg + 0.8 mg + 125 mg + 60 mg + 100 mg + 1 mg + 1 mg + 125 mg + 7.5 mg)
277	ELUDRIL	Tretësirë për spraj (0.05g + 0.015g)
278	ELUDRILPRO	Tretësirë për gargare (0.5ml + 0.5g) / 100ml
279	ELLA ONE	Tabletë 30 mg
280	EMESAN K Children's Suposta	Suposta 20 mg
281	ENEMA COOPER	Tretësirë për përdorim rektal (7.5 + 20)g / 125ml
282	ENTEROFURYL	Kapsula 200 mg
283	ENTEROFURYL	Kapsula të forta 100 mg
284	ENTEROFURYL	Pezulli për përdorim nga goja 200 mg/5ml
285	ENTEROGERMINA	Pezulli për përdorim nga goja 2 miliard/5ml
286	ENTEROSEPT	Tableta (250 mg + 25 mg)
287	ENJOMIN	Supost 50 mg
288	ESPUMISAN EMULSION	Emulsion, pika për përdorim nga goja 40 mg/ml
289	ESPUMISAN PERLEN	Kapsula të buta 40 mg
290	EUCARBON	Tableta (105 mg + 25 mg + 180 mg + 50 mg + 0.5 mg + 0.5 mg)
291	EUDORLIN	Pezulli për përdorim nga goja 20 mg/ml
292	EUDORLIN EXTRA	Tableta të veshura me film 400 mg
293	EUGENOL	Tretësirë 100%
294	EXPECTORANS No5	Shurup (6.41 g + 1.92 g + 0.08 g + 0.09 g)/100g
295	FASDOL	Tableta të veshura me film 400 mg
296	FASDOL	Pezulli për përdorim nga goja 100 mg/5ml
297	FASTUM	Xhel 2.5%
298	FAVE DE FUCA	Tableta (126 mg + 222 mg + 170 mg)
299	FEBRICET	Shurup 120 mg/5ml
300	FEVERFLU	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja (500 mg + 200 mg + 25 mg)/qeskë
301	FEXOFENADINE	Tableta të veshura me film 120 mg
302	FINALGON	Pomadë (0.4g + 2.5g)/100g
303	FINATUX	Shurup 50 mg/ml
304	FITOSTIMOLINE	Krem 15%
305	FITOSTIMOLINE	Garzë e imprenjuar 15%
306	FITOSTIMOLINE	Ovulë 600 mg
307	FLAVAMED FORTE	Tableta efervveshente 60 mg
308	FLECOXIN	Tableta 8 mg
309	FLEVENOL	Tableta të veshura me film 500 mg
310	FLEXEN	Xhel 2.5%
311	FLONIDAN	Tableta 10 mg
312	FLONIDAN	Pezulli për përdorim nga goja 5 mg/5ml
313	FLUDITEC	Shurup 20 mg/ml
314	FLUDITEC	Shurup 50 mg/ml
315	FLUIBRON	Tretësirë për nebulizator 15 mg/2ml
316	FLUIFORT	Granula për tretësirë për përdorim nga goja 2.7g
317	FLUIFORT	Shurup 90 mg/ml
318	FLUIFORT	Shurup 2.7g/10ml
319	FLUIMUCIL	Tableta efervveshente 600 mg
320	FLUIMUCIL	Granula për tretësirë për përdorim nga goja 600 mg/qeskë
321	FLUIMUCIL MUCOLITICO	Shurup 100 mg/5ml
322	FLUIMUCIL MUCOLITICO	Granula për tretësirë për përdorim nga goja 200 mg/qeskë
323	FOLIDEX	Tabletë 400mcg
324	FURASOL	Pluhur për tretësirë për përdorim të jashtëm 100 mg
325	FUSCINA FENICA NOVA ARGENTIA	Tretësirë për përdorim në lëkurë (4g + 0.3g + 10g + 1g)/100g
326	GASTREN CHEWABLE TABLET	Tabletë për t'u përtypur (680 mg + 80 mg)
327	GASTREN DUO	Pezulli për përdorim nga goja (12000 mg + 1400 mg + 3000 mg)/100ml
328	GASTROGUARD	Tabletë për t'u përtypur (680 mg+80 mg)
329	GASTROPROTECT	Tabletë për t'u përtypur (10 mg + 165 mg + 800 mg)
330	GAVISCON -L PEPPERMINT FLAVOUR	Pezulli për përdorim nga goja (250 mg + 133.5 mg)/5ml
331	GAVISCON PEPPERMINT TABLETS	Tabletë për t'u përtypur (250 mg + 133.5 mg + 80 mg)
332	GENCIANE VIOLET 1%	Tretësirë për përdorim të jashtëm 1%
333	GENERIT	Tretësirë, pika për përdorim nga goja 10 mg/ml
334	GENERIT	Tretësirë, pika për përdorim nga goja 10 mg/ml
335	GINETANTUM	Pluhur për tretësirë për përdorim të jashtëm 500 mg/qeskë
336	GINETANTUM	Tretësirë për përdorim vaginal 0.1%
337	GINO-DAKTANOL	Ovule vaginale 200 mg
338	GLICEROLO CAMOMILLA E MALVA	Tretësirë për përdorim rektal 2.25g
339	GLICEROLO NOVA ARGENTIA	Tretësirë për përdorim rektal 2.25 g/flakon
340	GLICEROLO NOVA ARGENTIA	Tretësirë për përdorim rektal 6.75 g/flakon
341	GLUCOSAMINA BLUEPHARMA	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja 1500 mg
342	GRAVOL EASY TO SWALLOW TABLETS	Tabletë 50 mg
343	GRAVOL KIDS COMFORT SHAPED SUPPOSITORIES	Supost 25 mg
344	GRAVOL KIDS LIQUID	Shurup 15 mg/5ml
345	GRIPOBLOCK	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja (750 mg + 60 mg + 10 mg)/qeskë
346	GRIPOBLOCK JUNIOR	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja (300 mg + 20 mg + 5 mg)/qeskë
347	GRIPOFLEKS 750	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja (750 mg + 70 mg + 10 mg)/qeskë
348	GRIPOFLEX 500	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja (500 mg + 200 mg + 25 mg)/qeskë
349	GRIPORT	Tabletë e veshur me film (650 mg + 4 mg + 60 mg)
350	GRIPPOSTAD C	Kapsula (200 mg + 150 mg + 25 mg + 2.5 mg)
351	GRIPPOSTAD HOT DRINK	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja 600 mg/5g qeskë
352	GYNO - PEVARYL	Ovulë vaginale 150 mg
353	GYNO - PEVARYL	Ovulë vaginale 50 mg
354	HELMINTOX	Tableta të veshura me film 125 mg
355	HELMINTOX	Tableta të veshura me film 250 mg
356	HELMINTOX	Pezulli për përdorim nga goja 125 mg/5ml
357	HEPALGAN	Xhel 3000IU/g
358	HEPALIP FORTE	Kapsula (300 mg + 30 mg + 6 mg + 6 mg + 6 mg + 6 mg)
359	HEPATHROMBIN	Xhel 300 I.U./g
360	HEPATHROMBIN	Xhel 500 I.U./g
361	HEPATHROMBIN	Krem 300 I.U./g
362	HEPATHROMBIN	Krem 500 I.U./g
363	HERBION Cowslip syrup	Shurup
364	HERBION IVY	Shurup 7 mg/ml
365	HERBION PLANTAIN SYRUP	Shurup (2,5g+65 mg)/5ml
366	HERNOVIR	Krem 5%
368	HISTASIN	Tableta të veshura me film 10 mg
369	HISTERGAN Krem	Krem 2% (w/w)
370	HIVOTEX	Shurup 30 mg/5ml
371	HYDROCUTAN	Pomadë 1%
372	IBALGIN	Tableta të veshura me film 400 mg
373	IBALGIN	Xhel 5%
374	IBALGIN RAPID	Tableta të veshura me film 400 mg
375	IBUACTIVE	Krem 5%
376	IBUDOLOR DUO	Xhel (50 mg + 30 mg)/g
377	IBUFEN	Xhel 50 mg/g
378	IBUHEXAL 2% KINDERSAFT	Pezulli për përdorim nga goja 100 mg/5ml
379	IBUKLIN	Suposta 150 mg
380	IBUKLIN	Suposta 75 mg
381	IBULEK	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja 400 mg/qeskë
382	IBUPROFEN	Krem 10%
383	IBUPROFEN	Shurup 100 mg/5ml
384	IBUPROFEN	Tableta të veshura me film 200 mg
385	IBUPROFEN	Tableta të veshura me film 400 mg
386	IBUPROFEN	Tableta të veshura me film 400 mg
387	IBUPROFENO ARGININA CODRAMOL	Granula për tretësirë për përdorim nga goja 400 mg/qeska
388	IBUTOP CREAM	Krem 5g/100g
389	IBUTOP FAST	Kapsula 400 mg
390	IBUTOP GEL	Xhel 5g/100g
391	ICTAMMOLO NOVA ARGENTIA	Pomadë 10%
392	IDEOS	Tableta për t'u përtypur (500 mg + 400 IU)
393	IKTIOL	Pomadë 10%
394	IMIDIN FUR KINDER	Pika për hundë, tretësirë 0.5 mg/ml
395	IMIDIN N	Spraj për hundë, tretësirë 1 mg/ml
396	IMODIUM	Kapsula 2 mg
397	IMOPER	Shurup 667 mg/ml
398	INDOVASIN	Xhel (30 mg/g + 20 mg/g)
399	INFLAFORTE	Tretësirë, pika për përdorim në lëkurë 1.5%
400	IPSOFLOG	Krem 1%
401	ISTAMEX	Shurup 2 mg/5ml
402	ISTAMEX	Tableta 4 mg
403	ITAMI	Patch i medikuar 140 mg
404	ITIMADOL	Shkumë për përdorim të jashtëm 3%
405	JENAPROFEN 400 MG	Tableta të veshura me film 400 mg
406	JODASEPT KUPRO	Tretësirë për përdorim kutan 0,1
407	JODASEPT KUPRO	Pomadë për përdorim kutan 10%
408	JODEX	Spraj, tretësirë 8.5% (w/v)
409	JODIO 5%	Tretësirë për përdorim të jashtëm 5%
410	JODIO 5%	Tretësirë për përdorim të jashtëm 5%
411	JODOCUR	Tretësirë për përdorim në lëkurë 10g/100ml
412	JUNIOR IBUPROFEN SUSPENSION 100 MG/5ML	Pezulli për përdorim nga goja 100 mg/5ml
413	KALCIUM GLUKONAT	Tableta 500 mg
414	KAMFART	Krem (20 mg + 10 mg + 10 mg + 10 mg)/g
415	KAMILLAN SUPRA	Tretësirë 100g/100g
416	KARDIOSPIR	Tableta të veshura enterike 100 mg
417	KASTELAN	Tretësirë për përdorim të jashtëm (2% + 0.5% + 4% + 1%)
418	KATARIN	Kapsula (250 mg + 100 mg + 2 mg)
419	KATARIN	Shurup (120 mg + 50 mg + 1 mg/5ml)
420	KATARIN FORTE	Tableta të veshura me film 650 mg + 200 mg + 4 mg + 60 mg
421	KENDIX	Krem 5%
422	KETOCONAZOL KORHISPANA	Xhel 2%
423	KETONAL	Xhel 2.5%
424	KETONAL	Krem 5%
425	KETORAL	Shampo 2g/100ml
426	KINDER LUUF BALSAM	Balsam (50 mg + 27.5 mg + 15 mg + 50 mg + 2.5 mg/g
427	KLOREMIN	Tretësirë për gargare (0.3g + 1.2ml)/200ml
428	KLOROBEN	Tretësirë për gargare (0.12% + 0.15%)
429	KLOROBEN	Tretësirë për spray oral (0.15% + 0.12%)
430	KLORUR BANZALKONI	Tretësirë 10% - 1000ml
431	KLORUR BENZALKONI	Tretësirë 5%
432	LACRINORM	Xhel për sy (0.01% + 0.2%)
433	LACRISOL	Pika për sy, tretësirë (0.0045% + 0.5%) w/v
434	LAEVOLAC	Koncentrat për tretësirë për përdorim nga goja 67g/100ml
435	LATOREN	Tableta 10 mg
436	LATTULOSIO ABC	Shurup 66,7 g/100ml
437	LENTRICA	Tabletë e veshur me film 5 mg
438	LEODEX	Tabletë e veshur me film 25 mg
439	LEVIORINIL	Tableta të veshura me film 10 mg
440	LEVIORINIL	Pika për përdorim nga goja, tretësirë 10 mg/ml
441	LEVOCETIRIZIN HEXAL	Tableta të veshura me film 5 mg
442	LEVOTUSS	Shurup 30 mg/5ml
443	LEVOTUSS	Tretësirë për pika për përdorim nga goja 60 mg/ml
444	LEVOTUSS	Shurup 60 mg/10ml
445	LEVOTUSS	Tabletë 60 mg
446	LIDOCAINA CLORIDRATO E IDROCORTISONE ACETATO	Krem (1.5% + 1%) w/w
447	LIDOPROCT	Pomadë rektale (180 mg + 50 mg + 35 mg +2,5 mg)
448	LINEX BABY	Pluhur për pezulli për përdorim nga goja (1 10⁹) CFU
449	LINEX FORTE	Kapsula 2.000,00 MIO CFU
450	LIOTON	Xhel 1000 I.U./1g
451	LISOMUCIN	Tretësirë, pika për përdorim nga goja 2 mg/ml
452	LOCION MALATION	Tretësirë për përdorim të jashtëm 0.5g/100ml
453	LOMEXIN	Krem vaginal 2%
454	LOMEXIN	Kapsula vaginale të buta 600 mg
455	LOMEXIN	Krem 2%
456	LOPEGEN	Kapsula 2 mg
457	LOPERAMID	Tableta 2 mg
458	LOPERAMID	Tableta 2 mg
459	LORADE	Tableta 10 mg
460	LORADERM	Shurup 5 mg/5ml
461	LORADERM	Tableta 10 mg
462	LORATADIN	Tableta 10 mg
463	LORDES	Tableta të veshura me film 5 mg
464	LORDES	Shurup 2.5 mg/5ml
465	LUNA	Tabletë e veshur me film (500 mg + 25 mg)
466	LUNGES	Shurup 30 mg/5ml
467	LUUF	Spraj për hundë, tretësirë (1 mg + 1 mg)/ml
468	LYSOBACT	Krem 20 mg/g
469	LYSOBACT COMPLETE SPRAY	Tretësirë për spray oromukozal (20 + 1.5 + 0.5) mg/ml
470	LYSOBACT DUO	Tabletë që tretet në gojë (20 mg + 1.5 mg)
471	MAALOX MAUX D'ESTOMAC	Pezulli për përdorim nga goja (4g + 3.5g) / 100ml
472	MAALOX MAUX D'ESTOMAC	Tableta për t'u përtypur (400 mg + 400 mg)
473	MAGNE B6	Tableta (470 mg + 5 mg)
474	MAGNESPASMYL [illegible] RELIEF	Tableta 47 [illegible]
476	MAXICLEAR SINUS RELIEF	Tableta 10 mg
477	MAXICLEAR SINUS & PAIN RELIEF	Tableta (5 mg + 500 mg)
478	MEBHIDROLINE	Tableta 50 mg
479	MENTOLOZETA	Pluhur për përdorim në lëkurë 1%
480	METAFENEX	Tableta (200 mg + 325 mg)
481	METSIL DROPS	Tretësirë për përdorim nga goja, pika 2g/30ml
482	METSIL FORT	Tableta-karamele 80 mg
483	MIGRETIL	Tableta të veshura me film (100 mg + 400 mg + 1 mg + 0.1 mg)
484	MINAMOL PLUS	Tabletë (250 mg + 150 mg + 50 mg)
485	MIOTENS CONTRATTURE E DOLORE	Shkumë për përdorim kutan 0.25%
486	MODOLEX	Pomadë rektale (40 mg + 20 mg)/g
487	MOMENDOL	Tabletë e veshur me film 220 mg
488	MOMENT	Tretësirë për pika për përdorim nga goja 20g/100ml
489	MOMENT	Tabletë e veshur 200 mg
490	MOMENTACT	Tableta efervveshente 400 mg
491	MUCOCIS	Shurup 2g/100ml
492	MUCOCIS	Shurup 50 mg/ml
493	MUCOLISIN	Shurup 30 mg/5ml
494	MUCOSOFT	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja 600 mg/qeskë
495	MUCOSOLVAN	Kapsula retarde 75 mg
496	MUCOSOLVAN	Shurup 15 mg/5ml
497	MUCOSOLVAN	Shurup 30 mg/5ml
498	MUCOTREIS	Shurup 50 mg/ml
499	MUCOTREIS	Shurup 20 mg/ml
500	MUKOLITINE A	Shurup 5%
501	MUKOLITINE P	Shurup 2%
502	MUXOL	Tretësirë për përdorim nga goja 0.3%
503	MYCOCUR	Spraj për lëkurë 1%
504	MYCOCUR 1%	Krem 1%
505	MYCONAFINE 1%	Krem 1%
506	MYCORIL	Tretësirë për spraj 1% (w/v)
507	MYCOSTER	Tretësirë për përdorim lokal 8% (w/w)
508	MYCOSTER	Krem 1% (w/v)
509	MYCOSTER	Pluhur për përdorim në lëkurë 1% (w/w)
510	MYCOSTER	Tretësirë për përdorim në lëkurë 1% (w/v)
511	NAFAZOLINE	Spraj për hundë, tretësirë 1 mg/ml
512	NAFAZOLINE 0.1%	Pika për hundë, tretësirë 1 mg/ml
513	NALGESINS	Tableta të veshura me film 275 mg
514	NAPRIUS	Xhel 10%
515	NATECAL D3	Tableta për t'u përtypur (600 mg + 400 I.U.)
516	NAZOPASS	Tretësirë, pika për përdorim në hundë 0.25 mg/ml
517	NAZOPASS	Tretësirë, pika për përdorim në hundë 0.5 mg/ml
518	NEO-MYCODERMOL	Krem 1%
519	NEO-MYCODERMOL	Tretësirë për përdorim lokal 1% (w/v)
520	NERITA	Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja 1500 mg/qeskë
521	NEUROBEX	Tableta të veshura (15 mg + 10 mg + 0.02 mg)
522	NICOTINELL FRUIT	Çamçakëz 2 mg
523	NICOTINELL FRUIT	Çamçakëz 4 mg
524	NIFUROXAZIDE EG	Kapsula 200 mg
525	NIMOKAIN	Xhel (0.5g + 2.5g)/100 g
526	NIZORAL	Krem 20 mg/g
527	NIZORAL	Shampo 20 mg/g

vijon

Ministria e Arsimit: Nëse fitoni, do të keni mundësinë të konkurroni në portal

Mësues për Shqipërinë, afati i fundit i dorëzimit të dokumenteve

Çfarë duhet të paraqisni pranë DRAP për t'u pranuar

Voltiza Duro

Deri në datën 5 qershor të këtij viti, çdo kan didat i interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit, duhet të dorëzojë një listë dokumentesh për të konkurruar për në një vend të lirë pune në portalin "Mësues për Shqipërinë". "Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) nënvizon se dosja e plotë e dokumentacionit duhet të dërgohet me anë të shërbimit postar deri me datë 5 Qershor pranë Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), përkatësisht: DRAP Durrës, DRAP Lezhë, DRAP Fier dhe DRAP Korçë",-bën me dije MASR.

APLIKIMI

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një sërë dokumentesh pranë DRAP-ve ku përfshihen: jetëshkrimi; kërkesa për konkurrimin në portalin "Mësues për Shqipërinë"; raporti mjeko-ligjor; vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore; vërtetim i qendrës së banimit; kopje e librezës së punës e njehsuar me origjinalin (nëse ka); kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës/ave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta; kopje e njehsuar me origjinalin e licencës së provimit të shtetit

për profesionin e rregulluar të mësuesit, për të gjithë kandidatët që kanë detyrim ligjor ta kryejnë këtë provim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, aplikantët që dëshirojnë të fillojnë punë si mësues, duhet të dorëzojnë edhe një kopje të njehsuar me origjinalin e dëshmive të kualifikimit për kategoritë: "Mësues i kualifikuar", "Mësues specialist", "Mësues mjeshtër" (nëse ka); kopje të njehsuar me origjinalin e certifikatave me kreditet e trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit. Certifikatat me kreditet e trajnimeve të kryera brenda vendit të jenë ofruar nga MASR, institucionet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara nga MASR; Kopje e njehsuar me origjinalin e dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaja; Deklaratë nga kandidati për autorizimin e DRAP që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura.

DOKUMENTACIONI

- Jetëshkrimi;
- Kërkesë për konkurrimin në portalin "Mësues për Shqipërinë";
- Raport mjeko-ligjor;
- Vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore;
- Vërtetim i qendrës së banimit;
- Kopje e librezës së punës e njehsuar me origjinalin (nëse ka);
- Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës/ave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë, cikli i dytë dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë) ose të barasvlefshme me këto sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi;
- Kopje e njehsuar me origjinalin e licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, për të gjithë kandidatët që kanë detyrim ligjor ta kryejnë këtë provim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- Kopje e njehsuar me origjinalin e dëshmive të kualifikimit për kategoritë: "Mësues i kualifikuar", "Mësues specialist", "Mësues mjeshtër" (nëse ka);
- Kopje e njehsuar me origjinalin e certifikatave me kreditet e trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit. Certifikatat me kreditet e trajnimeve të kryera brenda vendit të jenë ofruar nga MASR, institucionet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara nga MASR;
- Kopje e njehsuar me origjinalin e dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaja;
- Deklaratë nga kandidati për autorizimin e DRAP që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura.

Rrëfehet modelja: Fama nuk më ka ndryshuar, konkurrenca më ka bërë të punoj më fort

Elda Pema:

Suksesin e kam arritur vetë, ju tregoj raportin e veçantë që kam me Zajminën

"Përpiqem të jem e bukur në çdo aspekt"

Egla Xhemali

Ka kohë që një bukuro she po qarkullon në rrjetet sociale dhe në botën e show bizzit. Tanimë ajo është imazhi që Zajmina Vasjari ka zgjedhur për të reklamuar veshjet e saj. Një jetë mjaft aktive me udhëtime përtej kufijve, photoshooting dhe një sërë aktivitetesh që e kanë bërë tepër të dashur për publikun. Elda Pema vjen në një rrëfim ekskluziv për "Gazeta shqiptare", për mënyrën se si po e përjeton famën, për raportet e ngushta me Zajminën, për modelingun dhe detaje të tjera nga jeta personale. Bukuroshja na tregon se ka punuar shumë për të arritur këtu ku është dhe se përtej shkëlqimit si modele ajo vazhdon të jetë vajza e thjeshtë, që ka parimin të ndihmojë gjithkënd që i ka qëndruar pranë. Një shpirt plotë ngjyra si i Eldës nuk kishte si mos t'i binte në sy Vasjarit që i ka besuar verbërisht asaj. Televizioni? Pema na thotë se e sheh si një sfidë e pse jo në të ardhmen mund të bëhet pjesë e tij.

Një debutim i fuqishëm në botën e modelingut. Si po e përjeton Elda famën?

Të qenit e famshme ka ndikuar mjaft mirë në jetën time. Shumicat e gjërave kanë mbetur të njëjta. Nuk dua të jem ai person, i cili ndryshon pasi merr famë. Jo, përkundrazi të gjithë ata që më njohin e dinë shumë mirë se unë kam mbetur e njëjtë, e thjeshtë dhe po aq e afër sa ç'kam qenë me këdo që më ka qëndruar pranë. Fama normalisht ka të mirat e saj, përpos këtyre dhe disavantazhe, të cilat nuk po i përmend momentalisht. Por, që "i'm dealing with it".

Modelingu si çdo profesion tjetër ka dhe rivalitet. Ka qenë e vështirë përballja me 'bërrylat' e 'të mëdhenjve'?

Rivaliteti besoj se është i pranishëm në çdo moment të jetës sonë. Dua të them se është pak e vështirë veçanërisht në profesionin tonë. Por, që konkurrenca është shpirti i punës. Më tepër se sa bezdisje, më ka bërë të punoj akoma më fort.

Këto kohë të kemi parë mjaft aktive, me udhëtime dhe me foto të shumta në rrjetet sociale. Me çfarë po merresh aktualisht?

Udhëtimet janë gjëja që pëlqej më shumë të bëj. Adhuroj të eksploroj vendet dhe kultura të ndryshme. Më duket mënyra më e mirë për të larguar stresin e përditshëm. Gjithashtu, më pëlqen të jem aktive në rrjete sociale duke publikuar përditshmërinë time, mendoj se është mënyra më e mirë për të qenë "In" . Aktualisht, jam në marrëdhënie edhe me shkollën. Jam studente në vitin e tretë në universitet. Por, krahas kësaj po planifikoj udhëtimin tim të radhës.

Je imazhi kryesor që Zajmina ka zgjedhur për të reklamuar veshjet e saj. Çdo të thotë kjo për ty?

Së pari, për mua do të thotë vlerësim. Përderisa ajo më zgjodhi midis shumë mundësive përkthehet në besimin që ka te unë. Ajo ka menduar se jam vajza më e përshtatshme ndaj ka bërë këtë zgjedhje. Së dyti, do të thotë përgjegjësi nga ana ime. Jo vetëm në rastin e Zajminës, por çdo aktivitet tjetër që lidhet me mua, mundohem ta kryej sa më mirë, në mënyrë që të rezultojë sa më i suksesshëm për mua dhe personin që ma ka besuar punën.

Si janë raportet e tua me Zajminën përtej punës?

Kemi raporte shumë të mira që nuk ndalen vetëm në kuadër të punës. Kam një vlerësim tepër të madh për të, e jo vetëm për faktin që është një "businesswoman" e suksesshme , por edhe si nënë, zonjë e njeri me vlera të mëdha. Madje shtoj se me përkëdheli e thërras my diva duke qenë se e kam dhe shembull frymëzimi.

Nëse do të duhej të zgjidhje mes photoshooting dhe pasarelave, cila do ishte zgjedhja jote?

Mendoj se çdo pasarelë ka nisur me një photoshooting në fillim. Kështu që nuk i shikoj si zgjedhje, por si faza, ndoshta dhe si dy procese të modelingut që gërshetohen bashkë.

Ç'mendim ke për vajzat e ekranit? Elda e synon televizionin?

Pothuajse të gjitha vajzat e ekranit më kanë lënë një përshtypje të mirë. Janë të përgatitura, të paraqitshme dhe tepër të mira në punën e tyre. Pse jo , televizioni është diçka e bukur. Në qoftë se do më jepej mundësia do ta shikoja si një mundësi tepër frytdhënëse.

Oferta më e çuditshme që të është bërë për hir të punës?

Oferta të çuditshme kanë marrë, fundja i ka profesioni jonë këto. Duke nisur nga kërkesa për të lënë shkollën, familjen dhe gjithçka për hir të kësaj pune, deri tek favoret e pahijshme, të cilat me të vërtetë vënë në luhatje dëshirën për të vazhduar. Por, jam përpjekur t'i hedh në kosh të gjitha dhe të vazhdoj me idenë, me të cilën jam nisur që në fillim. Mendoj se shija më e mirë e suksesit arrihet në momentin kur ti e ke përqafuar vetë pa ndihmën e askujt.

Për çfarë nuk kursehesh kurrë?

Nuk kursehem kurrë për veshje. Duke nisur që nga rrobat, këpucët, çantat preferoj t'i kem të gjitha llojet që qarkullojnë në treg. Mendoj se veshja krijon një impakt të veçantë, për më tepër kur vishem bukur ndihem më "confident".

Si reagon kur thonë: Sa e bukur kjo vajza?

Të gjithë ndihen mirë kur marrin komplimente. Natyrisht më bëhet qejfi kur më thonë fjalë të tilla, por gjithmonë përpiqem që Elda të mos jetë vetëm një vajzë e bukur nga pamja, por nga çdo aspekt.

Një kujtim i bukur nga fëmijëria?

Një kujtim i bukur i fëmijërisë sime mbetet dansi. Jam marrë me dans sportiv për shumë vite dhe ishte një shtysë tepër e madhe për të qenë kjo që jam sot. I kujtoj me nostalgji koncertet e shumta, çmimet e fituara dhe sigurisht mbresat, imazhin që ato kanë lënë tek unë.

REVOLTA E QAFË-BARIT
DOSSIER

Ekskluzive / Zbulohet materiali sekret i 27 majit 1984 për analizën e ngjarjes ku u plagos Kostandin Gjordeni

Dokumenti sekret: Revolta e Qafë-Barit, kreu i Degës dha urdhër për përdorimin e armëve

Raport-informacioni: Masa e marrë nga kryetari i Degës i futi në panik të gjithë të dënuarit, të cilët u grumbulluan menjëherë te sheshi i rreshtimit dhe tulatën…

Dashnor Kaloçi

Ngjarja e datës 22 maj 1984 e njohur ndry she si Revolta e Qafë Barit, e ndodhur plot 35 vjet më parë, përmban një dosje voluminoze që ndodhet në Arkivin e Ministrisë së Brendshme nga ku herë pas here janë bërë publike në media një numër dokumentesh që hedhin dritë mbi atë revoltë që duhet thënë që asokohe tronditi jo pak regjimin komunist të Tiranës. Vetëm pesë ditë pas asaj revolte të të dënuarve politikë që vuanin dënime të rënda në atë kamp pune të detyruar me kushte nga më të vështirat, më datën 27 maj 1984, komanda e Repartit 311 të Qafë Barit, bëri analizën për ngjarjen duke renditur kronologjikisht gjithsa kishte ndodhur aty, (me emrat e të dënuarve dhe efektivave të policisë e kuadrove drejtuese të atij kampi), si dhe arsyet që çuan në atë ngjarje dhe masat e marra me detyrat përkatëse që do të zbatoheshin nga efektivat dhe komanda e atij reparti në të ardhmen. Kjo gjë, pra analiza për atë ngjarje ndodhet në dosjen në fjalë të sipërcituar, e cila nuk është bërë asnjëherë publike dhe nisur nga ky fakt ne po e publikojmë të plotë ekskluzivisht për 'Gazeta Shqiptare', duke filluar nga sot në këtë shkrim. Ajo që bie në sy dhe me mjaft interes për publikun e gjerë, kur tema e krimeve të komunizmit në këto dy-tre vitet e fundit është nga më të diskutuarat, është ajo ku në analizën përkatëse të Komandës së Repartit 311, midis të tjerash thuhet: "Mbas kësaj u lexuan emrat ku i pari ishte Kostandin Gjordeni, i cili sapo doli jashtë goditi murin me kokë dhe bërtet me të madhe dhe sikur gjoja e goditën". Gjë e cila ndryshon jo vetëm me dëshmitë publike të vetë Kostandin Gjordenit, (si p.sh. për dokumentarin "Revolta e përgjakur e Qafë Barit", prodhim i Radio-Televizionit Publik Shqiptar në bashkëpunim me zyrën e Prezencës së OSBE-së në Tiranë, i transmetuar vitin e kaluar), por edhe të mjaft nga ish-bashkëvuajtësit e tjerë të atij kampi në kujtimet e tyre me shkrime dhe libra si dhe prononcimet publike, të cilët japin versione krejt të ndryshme nga sa thuhet në dokumentin sekret me analizën e Komandës së Repartit 312 Qafë Barit lidhur me ngjarjen në fjalë. Nisur nga kjo, po publikojmë edhe një pjesë nga dëshmia e Kostandin Gjordenit, (me fotot përkatëse) lidhur me ngjarjen e Revoltës së Qafë Barit si dhe plagosjen e tij, ku ai akuzon një oficer, dhe jo ushtarët e vendrojës Nr. 1, siç thuhet në dokumentin sekret me analizën e komandës së atij reparti.

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË Sekret
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDËSHME
Ekzemplar Nr.
KOMANDA E REP.311 Qafë Bari më 27 V.1984

Analizë
Mbi ngjarjen e ndodhur më 22.5.1984 në regjimin e të dënuarve të Repartit 311 në Qafë Bari

Më datën 22.5.1984, aty nga ora 7 e 30 kur u kthye turni i tretë nga puna, roja e punës njofton se të dënuarit Ndue Martin Pisha, vjeç 19, dënuar me 23 vjet heqje lirije për diversion, në shkurt të vitit 1984 dhe Ndrek Geg Nikolla nga rrethi i Lezhës, vjeç 35 i dënuar me 16 vjet heqje lirie për tradhëti ndaj atdheut në vitin 1976, nuk kanë realizuar normën e punës. Komanda e repartit duke e patur problem kohët e fundit mos realizimin e normës nga disa individë të veçantë, urdhëroi rojen e punës që këta dy të dënuar mbasi të hajnë bukë të shkojnë 2 orë dhe të punojnë me turnin e parë për të bërë normën ditore.

Oficeri i rojes dhe roja e punës kur bënë gati turnin e parë për në punë thirrën dhe dy të dënuarit që do të rishkonin në punë, të cilët fillimisht ishin dakord. Më vonë këta dy të dënuar u kapën nga të dënuarit Sokol Sokoli dhe Sokol Progri, të dy nga Tropoja dhe u thanë që do të refuzonin daljen në punë, ndryshe nuk kini vënd në këtë repart. Nga ky presion, dy të dënuarit dhe sidomos Ndue Martin Pisha, refuzon të zbatojë urdhërin. Në këtë moment, rojet e punës, policët Fiqëri Çakalli dhe Islam Dega e thërrasin në zyrat e këshillit të riedukimit Ndue Pishën dhe i thanë që duhet të shkonte në punë, ose ndryshe do të shkonte në dhomën e izolimit, por Nduja të dyja këto i refuzoi dhe ndërkohë tek dy policët që kishin thirrur Nduen, shkon i dënuari Tom Ndoja dhe ua merr nga duart dy policëve të dënuarin Ndue Pisha duke u thënë se ju s'keni punë me këtë dhe largohen të dy. Policët menjëherë veprojnë për t'i kapur, por kur dalin jashtë shikojnë se bashkë me këta dy të dënuar ishin bashkuar dhe të dënuarit, Sokol Sokoli e Sokol Progri dhe u kundërvihen policëve, duke patur në duar tulla për t'i qëlluar.

Në kushte të tilla të kundërshtimit masiv, policët njoftojnë menjëherë oficerin e rojes dhe ky i fundit pasi merr masa të plota për forcimin e sigurimit të jashtëm të repartit, së bashku me një grup prej 5 vetësh dhe komandantit të togës së policisë të pajisur me shkopinj gome futen në regjimin e të dënuarave dhe u bëjnë thirrje të dënuarëve Ndue Pisha dhe Ndrek Nikollit që të zbatonin urdhërin e tyre por këta refuzuan. Atëhere grupi I policëve ndërhyri forcërisht për t'i kapur e për t'i çuar në dhomën e izolimit, por ndërkohë, 12-12 të dënuar siç ishin: Sokol Sokoli, Sokol Progri, Tom Ndoja, Martin Leka, Ded Nimani, Bajram Vuthaj, Ndue Kola, Haxhi Baxhinovski, Lush Bushgjoka e Kostandin Gjordeni, të paisur me tulla dhe me gurë në duar në pozicion dominimi mbi grupin e policëve ju bëjnë atyre presion që t'i lëshonin. Duke u ndodhur përpara një kundërshtimi masiv dhe të organizuar, oficeri i rojes vendosi anullimin e këtij urdhëri dhe marrjen e masave të tjera për stabilizimin e gjëndjes.

Mbas kësaj komandanti i togës së policisë urdhëroi që të gjithë të dënuarit të grumbullohen dhe të futen në mensë për të bërë apelin, urdhër që u zbatua nga të gjithë dhe menjëherë. Për këtë situatë të krijuar u njoftua menjëherë Kryetari i Degës dhe Komandanti i Repartit që kishte shkuar me shërbim në Fushë-Arrëz. Mbasi i futën të dënuarit në mensë, u mendua që duke bërë apelin një nga një kur të dënuarit të dalin jashtë, ata që kundërshtuan të kapeshin dhe të futeshin në dhomat e izolimit. Gjatë apelit kur i erdhi radha të dënuarit Kostandin Gjordeni të dalë jashtë, ai refuzoi në mënyrë demonstrative, kështu refuzoi të dalë vetë edhe i dënuari Sokol Sokoli, i cili morri me vete të gjithë grupin e tij dhe dolën forcërisht jashtë duke çarë rrethimin e policëve, nga kjo rrëmujë u arrit që të mos mbahej apeli dhe të dilin jashtë të gjithë të dënuarit që ishin në sallë rreth 350 vetë. Kur dolën jashtë midis të dënuarve u bë vetvetiu një diferencim, ata që nuk u përzien me ngjarjen shkuan nëpër lokalet dhe dhomat e tyre, kurse 20-24 të dënuar, u grumbulluan tek sheshi mbi fjetore, u pajisën me gurë e tulla dhe leva hekuri që i morën nga një ndërtesë që po ndërtohet, lopatat dhe barominat të futura dhe të fshehura në regjimin e brendshëm dhe me to po kërcënonin dhe po u bënin presion grupit të policëve që të mos afroheshin se do të derdhet gjak dhe herë mbas here qëllonin me gurë dhe tulla në drejtim të policëve.

Efektivi i policëve ju bëri disa herë thirrje që të

Kostandin Gjordeni: Ja si më plagosi oficeri me pistoletë...

Intervista e Gjordenit për dokumentarin "Revolta e përgjakur e Qafë Barit" në RTSH

Ishte data 22 Maj 1984. Ne ishim turni i tretë. Ndue Pisha nuk kishte bo normën. -O boni normën, o xhanin. Na futën në kamp. Hëngrëm bukë dhe na futën prapë në galeri që të bënim normën. Aty masanej shpertheu duke u zëne me policat.

Vetëm për një vagon që s'kishin bërë këto, policët kriminela i kthyen mbrapsht.

Ato thanë -Jo, nuk e bëjmë, nuk ka material, nuk shkojmë.

-Ne do t'ju bëjmë copa. Ose vagonin, ose shpirtin. Ata duke na shajt "ju jeni armiqtë e popullit" dhe ne thamë" Poshtë komunistët, poshtë diktatura, rroftë liria.

-Nuk futemi në punë.

Na kanë marrë me shkelma, me hunj, me lopata, duke na rraf.

Masanej ne t'u ulurit dhe duke gërthit duke sharë diktaturën, "Rroftë liria, rroftë demokracia". Një nga ata oficerat me qëlloi me pistolete që ne të pushonim. Plumbi më ra mua në shpatull në krahun e majtë. Pastaj me doli gjithë ai gjak. Dush Martini, nga Shkodra kishte një kuti duhani, ma vuri këtu dhe unë thashë: "me qëlluan kriminelët, më qëlluan komunistat"

Masanej na morën dhe na çuan ne biruce dhe prapë duke na rraf policët. Duke bërtit pastaj të burgosurit politike: "Lironi Konstandinin". Masanej na lëshuan dhe ne prapë u ngritëm duke shajt.

Na mbajtën 13 ditë në Pukë, na rrahën aty. Na rrihnin pastaj na jepnin bukë. Më kanë mbajt pastaj tek pulle në biruce dhe masanej më nxorën në gjyq.....

Masanej me çuan ne Zejmen. Na mbajtën një javë dhe pastaj na çuan në Spaç.

U lirova në 27 Mars të 91-shit. Në vitin 2009 me bënë operacion në Durrës dhe ma hoqën plumbin. Plumbi ka nejt nga 1984-a deri në 2009-ën, pasi në kamp nuk ma hoqën dot plumbin.







zbatonin urdhërat e tyre dhe të shkonin në dhomat e izolimit, por këta të dënuar kërkonin lëshime dhe kompromise që të mos merreshin masa disiplinore ndaj tyre, gjë të cilën efektivi i policisë e refuzoi në mënyrë kategorike. Mbasi gjëndja në këto kushte kur ishte bërë diferencimi i të dënuarëve, kuadrot që ishin aty vendosën që përsëri të gjithë të dënuarit të futeshin në mensë për të bërë apelin që nuk u bë më parë, të dënuarit në përgjithësi e zbatuan urdhërin kurse këta që kishin dalë në kundërshtim me urdhërat e policisë në fillim hezituan por më pas lanë për tokë mjetet që mbanin në duar dhe u futën në mensë duke qëndruar të gjithë së bashku në fund të sallës.

Në këtë moment vjen në sallë Kryetari i Degës dhe Komandanti i Repartit të cilët mbasi u konsultuan me kuadrot që ishin aty, u futën brenda rreth 20 kuadro dhe polic me në krye komandantin e repartit dhe mbasi marrin masa jashtë dhe brenda për t'i kapur dhe lidhur pjesëmarrësit e këtij kundërshtimi gjatë bërjes së apelit të dytë me qëllim izolimi, u bëjnë thirrje të gjithë të dënuarëve që do të dëgjonin emrin të dilnin jashtë dhe të tjerët të mos lëviznin nga vëndi, komandanti i repartit u bëri thirrje Këshillit të Riedukimit që të afrohen në krye të sallës dhe të ndihmojnë efektivin e policisë për të vendosur rregull. Mbas kësaj u lexuan emrat ku i pari ishte Kostandin Gjordeni, i cili sapo doli jashtë goditi murin me kokë dhe bërtet me të madhe dhe sikur gjoja e goditën. Ndërkohë grupi i tij që ishte brenda në mensë u çuan dhe filluan të bërtasin dhe të bënin përpjekje për t'i shkuar në ndihmë, kur efektivi nuk i lejoj filluan të shtyjnë dhe të marrin e thyejnë stolat e mensës dhe disa paterica që kishin disa të dënuar dhe filloj një përleshje ndërmjet policisë dhe grupit të dënuarëve, kurse Këshilli i Riedukimit me kryetar Dalip Zhabollin nuk e përkrahën dhe as e ndihmuan fare efektivin, e në këto rrethana komandanti i repartit dhe urdhër që të tërhiqej efektivi i policisë që po përleshej me të dënuarit dhe kështu dalin jashtë gjithë grupi i të dënuarave dhe u ngjitën lart te sheshi mbi fjetore rreth 24 të dënuar, të cilët muarrën përsëri veç tullave dhe gurve, edhe disa hekura që i kishin fshehur në tokë mbas lavanterisë. Po kështu 2-3 prej tyre nxuarrën edhe thikat që u panë se u nxirrin nga muret e godinës që ndërtohet të cilat i kanë pas fshehur dhe përgatitur që më parë. Në këto momente dy pjestarët e efektivit të policisë që po shoqëronin të dënuarin Kostandin Gjordeni për në dhomat e izolimit dhe një pjesë tjetër të pengonin efektivët e policisë i cili shkonte në ndihmë të policëve që po shoqëronin të dënuarin për në dhomat e izolimit pasi po rrezikoheshin nga sulmi i të dënuarave. Duke parë këtë situatë komandanti i repartit urdhëroi që Kostandin Gjordeni të lëshohej nga dhomat e izolimit dhe efektivi të tërhiqej gradualisht duke u mbrojtur nga goditjet e të dënuarëve me gurë dhe tulla në mënyrë që të mos dëmtoheshin. Në këtë kohë instruktori politik që shkoi për të ndihmuar policët e dhomave të izolimit, u kap nga 3-4 të dënuar, njëri prej tyre, Haxhi Baxhinovski, e plagoset lehtë me thikë në bark. Po kështu kur u tërhoq efektivi për të dalë tek porta e infermierisë, simbas urdhërit të komandës pasi në këtë situatë efektivi ishte tepër i revoltuar dhe i papërmbajtur, nëse të dënuarit ishin në pozicion dominues mund të dëmtonin efektivin, tre të dënuar siç ishin Martin Leka, Kostandin Gjordeni dhe Tom Ndoja, ndoqën efektivin me gurë deri tek porta e daljes, atëhere Kryetari i Degës urdhëroi që vënd roja Nr.1 të përdorte armën ndaj këtyre tre të dënuarëve, për të parandaluar sulmin e tyre me gurë dhe tulla, urdhër të cilin vëndroja menjëherë e zbatoi duke plagosur lehtë në krah të dënuarin Kostandin Gjordeni, e po kështu qëlluan me nga një breshëri në ajër të gjitha vëndrojet e sigurimit të jashtëm të repartit. Kjo masë e marrë nga Kryetari i Degës i futi në panik të gjithë të dënuarit të cilët u grumbulluan menjëherë dhe tulatën në sheshin e rreshtimit mbi fjetoret duke kërkuar të dorzoheshin për t'i çuar në Degën e Punëve të Brendëshme.

Kryetari i Degës dhe komanda e repartit morën masa që të dënuarit që ktheheshin nga froni i punës të mos futeshin në regjim pa u stabilizuar gjëndja, duke marrë masa për sigurimin e tyre edhe në galeri.

Në këto situate morëm njoftimin se ishin nisur për në repartin tonë zv/ministri i Punëve të Brendëshme dhe Drejtori i Drejtorisë së Zbatim Vendimeve Penale dhe nga ana jonë nuk u kryen më veprime ndaj të dënuarëve që qëndronin në rregjim dhe nuk kryenin ndonjë veprim konkret.

(vijon nesër)

ARBA KOKALARI ZGJIDHET PËR PARLAMENTIN EUROPIAN

REAGIMET

Berisha uron Arba Kokalarin për fitoren në Parlamentin Europian

Ish-Kryeministri Sali Berisha ka përshëndetur fitoren e shqiptares Arba Kokalari në zgjedhjet e Parlamentit Europian. "Një urim të përzemërt Arba Kokolarit, deputetes së parë shqiptare, përfaqësuese e Suedisë në Parlamentin Europian!", shkruan Berisha në 'Facebook' duke publikuar një fotografi nga disa takime që ka pasur në vite me zonjën Kokalari.

Patozi uron eurodeputeten shqiptare për fitoren

Koordinatori i Bindja Demokratike, Astrit Patozi ka uruar publikisht Arba Kokalarin për fitoren, duke u bërë kështu eurodeputetja e parë shqiptare. Mes rreshtave teksa shpreh krenarinë për Kokalarina, Patozi nuk kursen as ironinë. "Shqipëria mbërriti mbrëmë në Europë me Arba Kokalarin, shumë kohë përpara se të mbërrijë në stacion treni i lodhur dhe me qymyr, i nisur prej vitesh nga Tirana për në Bruksel. Krenarë për eurodeputeten e parë shqiptare! Urimet më të mira asaj dhe familjes së nderuar Kokalari!", shkruan mes të tjerash Patozi.

Mbesa e Musine Kokalarit merr përgëzime nga Meta dhe e djathta në Tiranë

Arba Kokalari, një shqiptare hyn në Parlamentin Europian

Zgjedhjet, moderatorët suedezë marrin 17.6% të votave

Për herë të parë, mbesa e Musine Kokalarit, Arba Kokalari u bë shqiptarja e parë që fitoi mandatin e eurodeputetes në Parlamentin Europian. Pas triumfit në Suedi, shqiptarja ka reaguar menjëherë në rrjetin e saj social "Facebook" ku thotë se partia e saj "Moderatorët" arriti të fitonte katër mandate për në PE. Eurodeputetja Arba Kokalari falënderoi të gjithë votuesit e Moderatorëve, ndërsa mesazh special përçoi kryesisht për mbështetësit e saj. "Moderatorët marrin një mandat të katërt dhe unë kam hyrë në Parlamentin Evropian! FALEMINDERIT për të gjithë ata që kanë luftuar për Moderatorët dhe mua!"- shkruan ajo. Zgjedhja e saj si deputete në PE me votat e qytetarëve suedezë është përshëndetur edhe nga presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta dhe kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, e disa politikanë të tjerë, të cilët triumfin e Kokalarit e cilësuan si një arritje të madhe për të gjithë shqiptarët, pavarësisht vendeve ku jetojnë. Lidhur me fitoren e Kokalarit ka reaguar edhe deputeti socialist Fate Velaj. Ky i fundit ka postuar një foto të Arba Kokalarit dhe një të Ermal Hoxhës, duke u shprehur se "gjaku nuk bëhet ujë". "Il sangue non è acqua" (gjaku, nuk është ujë) thonë italianët. Mbesa shkon në Bruksel, nipi shkon në Xibrakë. Arba Kokalari dhe Ermal Hoxha", shkruan Velaj në llogarinë e tij në "Facebook". Arba Kokalari, e cila jeton në Stokholm të Suedisë, është shqiptarja e parë që siguron një vend në Parlamentin Europian. Politikania e re është pjesë e partisë së moderuar, e cila fitoi 17.6 për qind të votave, duke marrë kështu 4 eurodeputetë, mes të cilëve edhe Kokalarin. E lindur në Tiranë, 27 nëntorin e vitit 1986, ajo ka mbajtur postin e sekretares ndërkombëtare të grupimit rinor të partisë në të cilën kantidon, e ku ka qenë mjaft aktive. Presidenti Ilir Meta e uron ndër të parët. "Arba Kokalari, shqiptarja e parë eurodeputete, i bën të lumtur të gjithë shqiptarët dhe meriton mirënjohjen e tyre, jo vetëm si model suksesi në Suedi, por edhe përfaqësimi dinjitoz në Europën e Bashkuar", ka qenë urimi i kreut të shtetit. Gjithashtu ndër urimet ishte edhe ai i ministrit të jashtëm të Kosovës, Behgjet Pacolli. "Tani kemi lajme të mira nga Suedia. Sapo është konfirmuar se Arba Kokalari me prejardhje shqiptare ka siguruar vendin e saj në Bruksel. Historike, sepse është eurodeputetja e parë shqiptare ndonjëherë. Urime", ka shkruar ai në Facebook. Ndërkaq edhe përfaqësuesi i Partisë Demokratike, Endri Hasa, ka uruar nga afër Arba Kokalarin për zgjedhjen e saj si deputete në Parlamentin Europian. Ai ndoqi nga afër rezultatin e zgjedhjeve në selinë qendrore të Partisë së Moderuar të Suedisë (Moderatna), së bashku me Arba Kokakalarin dhe kandidatët e tjerë të listës së Moderatna. Bashkë me Endri Hasën dhe Sekretari i Organizativ i FRPD-së, Lulzim Omuri, ishin në Suedi për të ndjekur zgjedhjet europiane si përfaqësues të PD-së, e ftuar nga partia simotër, anëtare e Partisë Popullore Europiane. Pati mjaft kandidatë shqiptarë në zgjedhjet europiane këtë vit. Ata përfaqësuan Belgjikën, Greqinë, Italinë dhe Suedinë, e ishte pikërisht kjo e fundit që nxori edhe fitues-en e vetme. Arba Kokalari është e afërme e shkrimtares së parë shqiptare, Musine Kokalari, që u diplomua në "La Sapienza" të Romës në vitin 1941, por u dënua më vonë në Shqipëri prej regjimit komunist e vdiq e internuar në Rrëshen në 1983-shin. Vetë eurodeputetja e re përcolli falënderime për mbështetësit e saj përmes një mesazhi në 'Facebook'.

Kush është Arba Kokalari?

Arba Kokalari lindi në Tiranë më 27 nëntor 1986 dhe është mbesa e Musine Kokalarit së diplomuar në "La Sapienza" të Romës në vitin 1941, intelektuales, disidentes dhe atdhetares se njohur. Musine Kokalari u dënua dhe internua nga regjimi komunist i Enver Hoxhës në Shqipëri dhe vdiq në 1983. Arba Kokalari, ka lindur në Shqipëri dhe më pas u zhvendos drejt Suedisë, pasi i ati, nipi i Musine Kokalarit kishte funksionin e ambasadorit të Shqipërisë. Për shumë vite Kokalari ka qenë e angazhuar me rininë e PPE-së dhe disa herë ka qenë zëvendëspresidente.

Greqi, 1/10 e shqiptarëve votuan në zgjedhjet e PE

Shqiptarët në Greqi janë treguar indiferentë ndaj zgjedhjeve europiane pasi kanë votuar vetëm 1/10 e votuesve. Fundoset SYRIZA dhe e majta greke, bashkë me aspiratat e shqiptarëve në Greqi. Numri i shtetasve shqiptarë me shtetësi greke llogaritet në 235.000. Nga këta, emigrantë të brezit të parë dhe të dytë të emigrantëve janë 90.000 në të gjithë Greqinë, prej të cilëve të drejtë vote kanë rreth 76.000 shqiptarë.

Maqedoni e Veriut, Zaev paralajmëron një qeveri të re

"Demokracia e Re" fiton në rang lokal, Greqia drejt zgjedhjeve të parakohshme në qershor

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, ka paralajmëruar ndërrimin e më shumë se një të tretës së ministrave të kabinetit qeveritar, që do të nënkuptonte nevojën për votimin e gjithë qeverisë në Kuvend. Njoftimi erdhi pas mbledhjes së Këshillit Qendror të partisë së tij Social-Demokrate, në të cilën u shkarkuan nga detyra të gjithë gjashtë nënkryetarët e partisë dhe organet tjera partiake. "Do të ketë ndryshime në postet ministrore. Do të ndërrohen më shumë se një e treta e ministrave, që nënkupton qeveri të re. Do të ketë ndryshime edhe në pozicionet tjera në qeveri. Çdokund ku është regjistruar arrogancë dhe mungesë të rezultateve do të ketë ndryshime", ka deklaruar Zaev pas mbledhjes së organeve partiake që ka zgjatur deri rreth mesnatës.

Nga ana tjetër, zgjedhjet europarlamentare dhe lokale që janë zhvilluar dje në Greqi, nga rezultatet e para zyrtare, tregojnë triumfues të padiskutuar partinë konservatore të djathtë "Demokracia e Re", madje me 8-9 pikë diferencë me partinë qeveritare "SYRIZA". "Demokracia e Re" triumfon në zgjedhjet europarlamentare me 32.8%, vijon Syriza qeveritare me 24%, Kinal me 7,8% -siguron deri tani 2 eurodeputetë po do të duhen ditë akoma të publikohen emrat e tyre, nga lista ku përfshihet dhe kandidatja shqiptare Eda Gemi- partia komuniste renditet e katërta, ndërsa "Agimi i Artë" e ekstremistëve të djathtë-nazistë renditet e pesta me 4.9%. Gjithashtu triumfuese me diferencë të lartë ka rezultuar dhe në zgjedhjet lokale partia e djathtë "Demokracia e Re" me mbi 40% për Athinën përkundrejt thuajse 20% të Syriza, ndërsa mbi 60% është përqindja e guvernatorit të Maqedonisë, me kryeqytet Selanikun dhe 36.80% përqindja e guvernatorit të Atikës me kryeqytet Athinën. Sipas burimeve të fundit nga partia qeveritare "Syriza", por të pakonfirmuara akoma, pritet që kryeministri Aleksis Cipras të përshpejtojë datën e zgjedhjeve parlamentare për qershorin 2019.

Lulzim Basha uron shqiptaren, eurodeputete në PE

Të dashur miq, sapo uro va në telefon eurodeputeten e parë shqiptare, shqiptaro-suedezen Arba Kokalari, që u konfirmua si fituesja e mandatit të eurodeputetes për partinë e moderatëve suedezë, simotrës sonë në Partinë Popullore Europiane! Natë e paharrueshme për Arbën dhe familjen e saj, natë fitore për moderatët që konfirmuan 4 eurodeputetë dhe natë historike për të gjithë ne shqiptarët që inaugurojmë me Arba Kokalarin praninë shqiptare në ulëset e Parlamentit Europian! Krenar dhe i lumtur me fitoren e Arbës, u shpreh mirënjohjen time të gjithë bashkatdhetarëve tanë në Suedi, që me votën e tyre e mundësuan këtë moment historik"!

Arba Kokalari deputete në PE, urimi i veçantë i Presidentit Meta

Presidenti Ilir Meta ka uruar shqiptaren Arba Kokalari, e cila fitoi zgjedhjet duke u bërë kështu shqiptarja e parë deputete në Parlamentin Europian. Kreu i shtetit thotë mes tjerash se Kokalari i bën të lumtur të gjithë shqiptarët, pavarësisht vendeve ku jetojnë. Në mesazhin e Ilir Metës theksohet se shqiptarja Arba Kokalari është një model suksesi në Suedi dhe njëherësh për Europën e Bashkuar. "Arba Kokalari, shqiptarja e parë eurodeputete, i bën të lumtur të gjithë shqiptarët dhe meriton mirënjohjen e tyre jo vetëm si model suksesi në Suedi, por edhe përfaqësimi dinjitoz në Europën e Bashkuar!", - shkruan Meta.

751 eurodeputetë, Partia Popullore Europiane kryeson me 173 vende

Zgjedhjet e PE, të Gjelbrit ishin surpriza e madhe

Triumfojnë Le Pen e Salvini, rekord pjesëmarrjeje në votime

Për herë të parë prej krijimit të zgjedhjeve europiane në vitin 1979, partitë e qendrës humbasin shumicën parlamentare. Dy forcat tradicionale, PPE e qendrës së djathtë dhe Social-demokratët e qendrës së majtë pësuan rënie duke marrë përkatësisht 179 dhe 150 vende në parlamentin me 751 eurodeputetë. Për të siguruar vendimmarrjen u nevojitet koalicioni me Liberal-demokratët, ose me surprizën e vërtetë të këtyre zgjedhjeve, të Gjelbërit, që arritën të marrin 70 vende. Ashtu siç pritej, rritje të konsiderueshme pësuan forcat radikale. Një goditje të rëndë mori Emmanuel Macron. Në Francë, forcë e parë u rendit Bashkimi Kombëtar, me në krye Marin Le Pen. Liderja e ekstremit të djathtë i bëri thirrje presidentit Macron të shpallë zgjedhje të parakohshme. Rezultat plebishitar prodhoi vota në Itali, ku zëvendëskryeministri Mateo Salvini mori 34% të mbështetjes. Fitore në Britani edhe për euroskeptikët e Nigel Farage me 31% qind, ndërsa konservatorët u renditën të pestët. Në Gjermani CDU-CSU ruajti vendin e parë, megjithatë befasia ishin të Gjelbrit që u renditën të dytët, duke lënë pas social-demokratët, pjesë e të cilëve ishte e reporteri për Shqipërinë, Knut Fleckenstein, i cili humbi vendin e tij në Parlamentin Europian. AFD e ekstremit të djathtë siguroi 11 vende. Partitë e ekstremit të djathtë anti-emigrante dhe ato të gjelbra kanë rritur vendet e tyre në Parlamentin Evropian (EP), ndërsa partitë e qendrës ballafaqohen me rënie të konsiderueshme në zgjedhjet e së dielës, treguan rezultatet jozyrtare, transmeton "Anadolu Agency" (AA). Partia Popullore Evropiane (PPE) pro-BE, e cila kishte 216 vende përpara zgjedhjeve, kryesoi zgjedhjet me 173 vende në PE-në, e cila gjithsej numëron 751 ulëse, ndërsa Social-demokratët (S&D) fituan 147 vende, 40 më pak nga zgjedhjet e mëparshme të vitit 2014. Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën (ALDE) ka fituar 102 vende, të Gjelbërit Evropianë/Aleanca e Lirë Evropiane (EFA) ka siguruar 71, Konservatorët dhe Reformistët Evropianë 58, Evropa e Kombeve dhe Lirisë (ENF) 57, Liritë Evropiane dhe Demokracia e Drejtpërdrejtë (EFDD) 56, ndërsa E Majta e Bashkuar Evropiane/E Majta e Gjelbër Nordike (GUE-NGL) ka siguruar 42 vende deri më tani. 45 deputetët e ngelur janë zgjedhur si të pavarur dhe kandidatë të tjerë. Partitë e ekstremit të djathtë përfaqësohen nga tri aleanca politike, Konservatorët dhe Reformistët Evropianë (ECR), Evropa e Kombeve dhe Lirisë (ENF) dhe Liritë Evropiane dhe Demokracia e Drejtpërdrejtë (EFDD), të cilët përpiqen të mblidhen nën një grup të vetëm. Pjesëmarrja në zgjedhjet e Parlamentit Evropian në gjithë Evropën ishte 51 për qind, ndërsa në vitin 2014 ishte 42,6 për qind. Rreth 400 milionë qytetarë kishin të drejtë vote në zgjedhjet e PE-së, duke i bërë ato zgjedhjet e dyta më të mëdha demokratike pas Indisë. Gara e këtij viti ishte në mes të tetë grupeve të ndryshme brenda parlamentit, ku 28 shtete të BE-së dolën për të votuar për zgjedhjet që u mbajtën në periudhën 23-26 maj. Zgjedhjet e PE-së mbahen çdo pesë vjet. PE, i cili vepron si organ legjislativ i bllokut, së bashku me Këshillin e BE-së konfirmojnë dhe miratojnë ligjet dhe buxhetin e unionit.

Tanja Fajon fiton një mandat të ri në PE

Eurodeputetja sllovene, Tanja Fajon, njëherësh raportuesja për Kosovën ka fituar edhe një mandat tjetër në Parlamentin Europian. Lajmin e ka bërë të ditur Fajon në "Twitter", ku ka shprehur gëzimin se do të vazhdojë të jetë anëtare e PE-së për 5 vitet e ardhshme. "Faleminderit të gjithëve për mbështetjen dhe besimin tuaj në zgjedhjet e Parlamentit Europian 2019! Ju më keni bërë një vlerësim të madh, por unë jam e vetëdijshme gjithashtu për përgjegjësitë e jashtëzakonshme dhe premtoj se do të vazhdoj të punoj shumë për Sllovenine dhe për të gjithë ne për një Bashkim Europian më të mirë", shkruan ajo.

BERLUSKONI

RIKTHIMI I BERLUSKONIT, 82-VJEÇAR SËRISH EURODEPUTET

Silvio Berluskoni, pesë vjet pas largimit të e tij nga parlamenti italian, në nëntor 2013, kthehet parlamentar në Bruksel. Ish-kryeministri italian është rikthyer në politikë në moshën 82-vjeçare, duke arritur të hyjë në Parlamentin Europian për herë të tretë. Futja e Berluskonit në PE vjen pas rikthimit të së drejtës në dhjetor të 2018-ës nga gjykata italiane, e cila më herët ia kishte ndaluar. Ai ishte në krye të listës në të gjitha zonat, përveç qendrës, ku ishte Tajani. "Forza Italia" ka marrë 10 për qind. "Ne jemi ende të domosdoshëm, pa 'Forza Italia' qendra e djathtë humbet", ishin fjalitë e para të Silvio Berluskonit.

Haradinaj pret zyrtarë të SHBA-ve, flet për dialogun

Hashim Thaçi: Mungesa e një marrëveshjeje Kosovë-Serbi ka pasoja për rajonin

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, sot ka pritur zëvendëspresidentin e 'Atlantic Council', Damon Wilson, së bashku me një delegacion nga Senati dhe Kongresi Amerikan. Sipas një njoftimi, presidenti Thaçi e ka falënderuar zëvendëspresidentin Wilson për kontributin e vazhdueshëm të 'Atlantic Council' në Kosovë për forcimin e strukturave të sigurisë. "Në 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës, populli dhe shteti i Kosovës janë mirënjohës përjetësisht për rolin përcaktues të SHBA-ve në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës", ka thënë ai. Bëhet e ditur se kreu i shtetit dhe delegacioni amerikan kanë biseduar edhe për procesin e tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe anëtarësimin e Kosovës fillimisht në Partneritetin për Paqe, më pas edhe në NATO. Në këtë takim është biseduar edhe për dialogun Kosovë-Serbi dhe domosdoshmërinë e shfrytëzimit të momentit për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht obliguese. "Mungesa e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mund të ketë pasoja për sigurinë dhe stabilitetin në rajon dhe i hap rrugë elementeve antievropiane", ka thënë presidenti Thaçi. Nga ana tjetër, zëvendëspresidenti Damon Wilson ka rikonfirmuar angazhimin e 'Atlantic Council' për Kosovën. Presidenti Thaçi ka thënë se bashkë me SHBA-të do të vazhdojnë angazhimin maksimal për të ruajtur dhe zhvilluar paqen dhe sigurinë në Kosovë dhe rajon. Gjithashtu, edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka zhvilluar takim me zyrtarët amerikanë në Prishtinë. Haradinaj në fjalën e tij shprehet se Kosova është e gatshme për marrëveshje me Serbinë, duke shtuar se nuk bën kompromise me integritetin territorial të shtetit të Kosovës.

LETRA

ELONA AGOLLI:

Dëshmi persekucionesh, një letër në shtëpinë-muze të Kadaresë

Shtëpia ku shkrimtari i madh Ismail Kadare ka jetuar gjatë periudhës së komunizmit, në një pallat të njohur nga shumëkush në hyrje të Rrugës së Dibrës, çeli së fundmi dyert si muze për qytetarët. Nga vizitorët e parë të shtëpisë-muze është vetë gjeniu i letrave shqipe, që bashkë me bashkëshorten e tij, Helena Kadare, u rikthye në apartamentin e mbushur me kujtime.

Për Ismail Kadarenë, projekti për shndërrimin e shtëpisë në një muze të vizitueshëm për qytetarët dhe turistët e huaj është një ide e mrekullueshme dhe fisnike. "Askush nuk e dinte këtë projekt dhe ideja vetë është e mrekullueshme, është fisnike, shumë humane. Mua s'më mbetet veçse të përsëris mirënjohjen time për të gjithë", tha ai. Por, ndërsa shtëpia është çelur, reagimet kanë qenë të shumta. Ka pasur zëra e shkrime pro shtëpisë-muze, siç ka pasur edhe zëra kundër saj. Në mesin e reagimeve ka qenë edhe ai i Elona Agollit, vajzës së shkrimtarit Dritëro Agolli.

Vajza e shkrimtarit Agolli, për shtëpinë-muze të Kadaresë .

REAGIMI I ELONËS

Meditimet e mia për vlerën e shtëpive muze, vërtetësinë e objekteve, doreshkrimeve, dokumenteve të përzgjedhura për t'u ekspozuar për publikun, frymën dhe mesazhet e përcjella edhe në mënyrë të tërthortë, mesazhe afër të vërtetave jetësore apo paksa të larguara nga to, më lindën pas leximit të një shkrimi, ku titulli manipulativ (jo e pazakonshme kjo gjë) më bëri të përqendrohem në radhët e atij shkrimi pa autor (mesa duket, shkrim i servirur).

Ngazëllimi i autorit pikërisht ishte vëzhgimi i dy letrave: njëra e Dritëroit si kryetar Lidhje, tjetra e Manush Myftiut drejtuar Mehmet Shehut (në fakt të dyja letrat dëshmonin përkujdesje të madhe për shkrimtarin e madh, vëmendje dhe respekt edhe për veprën dhe kontributin e tij). Në morinë e objekteve personale (që përcjellin intimitetin, njerëzoren, të bukurën e jetës së shkrimtarit etj.), në morinë e doreshkrimeve që dëshmojnë kapriçot e jetës krijuese të gjeniut të letrave, në radhën e letërkëmbimit mes miqve, të afërmve, me të cilët edhe mund të flitej e shkruhej hapur e në mënyrë të sinqertë. Autori i paemër i shkrimit gjente më interesante "dëshmi" persekucionesh, dëshmi në modë në kohën e sotme (ka plot afro tri dekada që vijon kjo modë fatkeqësisht). "Të sotmen dhe të djeshmen ne i kemi hedhur në një luftë të tmerrshme kundra njëra-tjetrës. Tymi që ngrihet nga fusha e kësaj lufte nuk na lë të shohim të nesërmen", - shkruan Dritëroi diku. Dhe vijon: "Të djeshmen zakonisht e mohojnë ata që i tremben të sotmes. E kaluara nuk ndryshohet, mbi të kaluarën ndërtohet. Po ashtu siç edhe 'Historia e jetuar është e vërtetë, e shkruara përzien të vërtetën me gënjeshtrën'.

Vlera e këtyre nismave, shtëpimuze, është pikërisht vërtetësia që përcjellin, krijimi i saktë i parafytyrimit të kohës kur është jetuar, plotësia e dokumenteve që dëshmojnë lidhjet e fakteve, raportet shkak-pasojë, itineraret e përshkuara në hapësirë, kohë, itinerare të mendjes dhe shpirtrave. "Historia nuk shkruhet në gjaknxehtësi", - përsëriste vazhdimisht babai im, ashtu siç "edhe ditën e djeshme nuk mund ta kthesh për ta redaktuar si fletën e letrës, që ke shkruar dje". Këto thënie të Dritëroit janë postulatet që duhet të udhëzojnë në rrugëtimin e mbarë të këtyre nismave.

VIZITA E KADARESË

Kadare theksoi se shkrimtari nuk mund të kuptohet pa lexuesin e tij, pa gjuhën, pa kombin e pa miqtë e tij. "Në këto raste, dihet që ka ndjesi, rizgjohen emocione. Unë kam ndjenjën e mirënjohjes. Në radhë të parë, një shkrimtar nuk mund të kuptohet pa lexuesin e vet, pa gjuhën e vet, pa vendin e vet, pa kombin e vet, pa miqtë e tij dhe të kombit të tij. Ne kemi nevojë, sidomos Shqipëria ka nevojë, për një afirmim pozitiv, për besim për të ardhmen e saj, ëndërron dhe bëhet gati për të hyrë në Europë. Mua kjo më prek, që marr pjesë në këtë afirmim njohjeje të kombit shqiptar. Edhe puna juaj, e të gjithëve që kanë punuar këtu, më prek shumë, jashtëzakonisht, madje më habit. Edhe fjalët, ku e keni gjetur gjithë këtë energji për këtë", tha shkrimtari i madh. Mes emocioneve, bashkëshortja e shkrimtarit, Helena Kadare, shprehu mirënjohjen për këtë projekt, që synon të rrëfejë detaje nga jeta personale dhe krijimtaria e Ismail Kadaresë. "Në këtë shtëpi kemi pasur kaq shumë gëzime, por edhe aq hidhërime, aq shumë sekrete, të cilat kujtoja se do të mbeteshin përjetësisht të mbyllura vetëm për ne, për familjen tonë. Befas, më mrekulloi ideja e hapjes dhe unë vij tani si vizitore. Habitem vërtetë me këtë punë jashtëzakonisht të mrekullueshme që ka bërë bashkia, bashkë me ata vajza dhe djem të rinj, me një energji fantastike. Është shumë e papritur për mua personalisht ta shikoj këtë gjë dhe për këtë punë të mrekullueshme që ka bërë arkitektja Elisabeta, me të cilën kam pasur disa takime. Shumë bukur", tha Helena Kadare.

Arkitektja e njohur, Elisabetta Terragni, e cila ka restauruar apartamentin për kthimin në muze të shtëpisë së shkrimtarit të madh në Rrugën e Dibrës, shprehu bindjen se kjo është një mundësi e shkëlqyer për të nxjerrë në pah për vizitorët nga e gjithë bota jo vetëm të vlerave të gjuhës shqipe, por edhe të periudhës në të cilën jetoi e punoi shkrimtari ynë i madh. "Ky apartament është për ne rezultati i celebrimit të letërsisë, nuk është një muze klasik, por është një vend ku mund të mësoni më shumë përsa i përket shkrimit në kanavacë. Kjo është një mundësi e jashtëzakonshme, jo vetëm për të festuar gjuhën, që është gjuha shqipe në të cilin shkroi shkrimtari dhe në të njëjtën kohë për të treguar se si ky shkrimtar ia doli gjatë kësaj periudhe të vështirë për të përkthyer të gjitha punët e tij. Ndaj, kjo është gjithashtu ajo çfarë duam të nxjerrim fillimisht në pah, që bota të shohë se ai gjithmonë shkroi në gjuhën shqipe", u shpreh Terragni.

Ismail Kadare është një ndër shkrimtarët më të mëdhenj bashkëkohorë shqiptarë, i cili ka zënë një vend të rëndësishëm në letërsinë botërore. Ai nisi të shkruajë kur ishte ende i ri, fillimisht poezi, me të cilat u bë i njohur e më pas edhe prozë, duke u bërë prozatori kryesor shqiptar. Deri më sot veprat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të botës, duke qenë kështu përfaqësues kryesor i letërsisë shqipe.

PORTRET

Kujtim nga takimi me Beila Kohen, bashkëshorten e Albert Kohenit

Rrëfimet e gruas së shkrimtarit të "E bukura e të zotit"

Alfred Papuçiu

Nuk ka shumë kohë që shtë pia botuese "Toena" ka botuar librin e Albert Cohen (Kohen) "Libri i nënës sime". Botuesja e "Toena", Irena Toçi më njofton se kanë botuar edhe librin tjetër të tij me titull "E bukura e të zotit".

Të them të drejtën, mu bë qejfi dhe kujtova takimet e paharruara me bashkëshorten e tij fisnike, Beila Cohen. E njoftova dhe shkrimtaren zvicerane dhe miken time të "Karuzelit të ëndrrave" që kam përkthyer në shqip, Marie-Luce Dayer, për këto dy botime në shqip dhe kujtuam përsëri çastet e bukura të takimeve me bashkëshorten e urtë, fisnike dhe erudite të shkrimtarit të madh. Beila Cohen u nda nga kjo jetë, në moshën 82-vjeçare. Beila ishte një grua tepër e thjeshtë dhe mbi të gjitha të bënte për vete me tregimet e saj për jetën e Albert Kohenit, këtij shkrimtari të madh dhe të mrekullueshëm, si dhe punën e tij të gjatë në Byronë Ndërkombëtare të Punës (BIT). Ishte një punonjës i zellshëm, i përkushtuar, me një karakter të veçantë. Gjithçka e donte të përkryer. Ai kishte lindur në Korfuz, shumë afër Shqipërisë dhe bregdetit Jon, por u vendos në Gjenevë në moshën 17-vjeçare. Po në Gjenevë përfundoi Fakultetin e Drejtësisë, si dhe Fakultetin e Letërsisë. Në 1930, Kohen shkruan romanin e tij të shquar "Soral" dhe në 1938 "Mangeclous". Ai vazhdon të shkruajë intensivisht. Në 1943, takon në Londër bashkëshorten e tij të tretë, Bella (Beila) Berkowich, londoneze. Ajo ka vetëm 24 vjeçe. Ai dyfishin e saj. Ata nuk do të ndahen më. Për t'i bërë të njohur Beilës nënën e tij, Albert Kohen shkruan "Libri i nënës sime". Me të ai shkruan "E bukura e të zotit". Vepër që u shkrua gjatë dhjetë viteve pune intensive. Ai shkruan gjatë ditës, ndërsa ajo sapo kthehet nga puna në BIT, e shtyp dorëshkrimin. Beila më thoshte se diskutonin shumë së bashku. Kishte punuar shumë, por ishte e kënaqur se i kishte nxjerrë të gjitha të vërtetat për bashkëshortin e saj. Vite të tëra nuk kishin shkuar as me pushime, vetëm e vetëm që Alberti të botonte veprën e tij madhore. "E bukura e të zotit" merr çmimin e madh të romanit të Akademisë Franceze.

Në 1944, Albert Koheni u emërua këshilltar juridik në Komitetin Ndërqeveritar për refugjatët. Ai ngarkohet me hartimin e marrëveshjes ndërkombëtare të 15 tetorit 1946 që ka lidhje me statusin dhe mbrojtjen e refugjatëve. Kjo marrëveshje do t'u shërbejë më vonë dhe mijëra refugjatëve nga Kosova. Në 1947, Kohen emërohet si drejtor i një prej institucioneve të specializuara të Kombeve të Bashkuara. Ndërkohë karriera e tij letrare merr hov.

Në 1970, Albert Kohen merr titullin Kalorës i Legjionit të Nderit. Në një kohë që ai është në majë të lavdisë së tij, bie viktimë e një depresioni nervor dhe i shpëton për pak vdekjes nga një anoreksi në 1978. Ndërkaq, ai ndryshon rrënjësisht jetën e tij dhe vepron ashtu si kishte bërë gjithë jetën miku i tij , shkrimtari i shquar Marsel Pagnol: promovon veprën e tij. Në këtë drejtim e ndihmon në mënyrë të veçantë Beila. Ajo Beila fisnike që na ka rezatuar vetëm mirësi e dashuri sa ishte gjallë. Folëm gjatë me Beilën atë mbrëmje, ku na kishte ftuar shkrimtarja zvicerane, Marie-Luce Dayer. Beila kishte punuar në Byronë Ndërkombëtare të Punës dhe e njihte shumë mirë punën dhe njerëzit e këtij organizmi të madh ndërkombëtar, ashtu si edhe unë që punova në gjirin e tij, në shërbimin e edukimit punëtor dhe atë të botimeve, për më tepër se katër vjet.



Disa ditë pas takimit tonë, në kutinë time të postës, gjeta një zarf me emrin tim, bashkë me një shënim të vogël të Beila Kohenit, e cila banonte në një apartament pranë rrugës Eugene-Pittard. E hapa. Brenda ishte libri i Albert Kohenit, shkruar me dashuri për të ëmën, një himn për nënat. Me një frymë shfletova faqet e para… Nuk ka dashuri më të madhe se për nënën, shkruan Koheni në veprën e tij të shquar. Dhe vazhdon: "Se kam më nënën për të qëndruar pranë meje deri sa të fle. Në darkë, kur shtrihem, vendos disa herë një karrige pranë shtratit tim, për të më bërë shoqëri. Meqënëse nëna nuk është, duhet të kënaqesh me karrigen". Bashkë me librin ishte dhe shënimi i Bela Kohenit, ku ndër të tjera më vinte në dukje: "Ja botimi i 'Librit të nënës sime' për të cilën ju fola. Dosja pedagogjike e Michel Bigot përbën, për mendimin tim, një hyrje të mirë jo vetëm për këtë libër, por gjithashtu për tërë veprën e Albert Kohenit. Isha e lumtur që ju takova dhe që fola me ju. Me shumë përzemërsi. Beila Kohen" …Dhe unë lexoj herë pas here 'Librin e nënës sime'.

Ishim së bashku në mbrëmjen e organizuar për shkrimtaren Marie-Luce Dayer, diku jashtë Gjenevës, në Konfinjon, në një sallë të madhe, ku ishin ekspozuar pikturat dhe vizatimet e bëra me subjektet e përrallave dhe tregimeve të Marie-Luce Dayer. Beila - e shoqja e Albert Kohenit, një grua tashmë e moshuar, por që kishte tipare shumë të rregullta e duhet të kishte qenë e bukur në rininë e saj, ishte me mua dhe Marie-Luce në "Volvon" e kësaj të fundit. Ishte shumë e thjeshtë. Për një kohë vazhduam bisedën për veprën e të shoqit, për të cilin fliste me pasion të veçantë. Megjithatë ishte shumë e matur në fjalë dhe të jepte përshtypjen e një njeriu erudit. Kuptova edhe nga fjalët e Marie-Luce Dayer se Beila kishte ndikuar në veprat e Albertit dhe kishte marrë pjesë në botimin e tyre. Dhe ruante me pasion çdo relike të tij, çdo botim të tij, megjithëse pa i bërë reklamë vetes, si gruaja e një autori të madh, me famë botërore, që kishte dhënë edhe ajo ndihmesën e saj në ecurinë e shkrimeve të tij. Shkrimtari i ka diktuar versionin përfundimtar të librit "E bukura e Zotit", kryevepra e tij që në 1968 mori çmimin e madh të romanit të Akademisë Franceze. Beila botoi tek Gallimard "Rreth Albert Kohenit", një libër që përmban portrete të hollësishme të grave që kanë jetuar me të. Ajo asnjëherë nuk e quajti veten si frymëzuese të Arianës tek "E bukura e Zotit"…

Kohë pas kohe e shihja Belën të kalojë në rrugën Eugène-Pittard, të qetë dhe ajo më përshëndeste me buzëqeshjen e saj të ëmbël, të një njeriu të mirë, fisnike, të ditur, të edukuar. Beila më fliste ashtu e qetë dhe tepër e thjeshtë, me modesti se kishte lënë edhe ajo një kujtim për bashkëshortin e saj. E kishte fjalën për librin e saj: "Albert Cohen, mithi dhe realiteti". Në fakt, para këtij botimi ajo ka sjellë për lexuesin: "Mbi Albert Cohenin". Beila Cohen mbledh shumë dokumente: letra, dëshmi personale, tekste arshivash të çdo lloji. Ajo i përdor në mënyrë logjike, të qartë, duke i analizuar dhe duke i argumentuar me shumë kujdes. Pas vdekjes të të shoqit, ajo merr pjesë aktivisht në botimin e veprave të tij në Plejadë. Toni i saj është i qartë. Bashkëshortja e Albert Cohen, e caktuar nga shkrimtari si trashëgimtare dhe kujdestare e tij, kështu e cilësonte ai në disa vepra të tij, u largua nga kjo jetë duke lënë kujtimet më të bukura të një gruaje të fortë që i shërbeu gjithë jetën e saj, veprës të të madhit Albert Cohen, pa kërkuar asnjëherë lavdi dhe dafina.

Dhe unë mendoj për "Librin e nënës sime" e cila është një vepër monumentale për çdo qenie njerëzore që ka lindur në këtë botë. Asnjeri nuk ka nënshkruar ndonjë kontratë kur ka lëshuar thirrjen e parë dhe asnjëri nuk do të nënshkruajë kontratë kur të ikë nga kjo botë. Megjithatë, deri në vdekje, atij do t'i kujtohet nëna e vet...Dhe unë në çaste të veçanta, kur jam vetëm, kujtoj me mallëngjim fytyrën e nënës sime të dashur, 87-vjeçare, fjalët e saja të mira për birin e saj. Me kalimin e moshës, ajo ishte bërë edhe më e urtë, më fjalëpakë. Megjithatë, ajo kishte një kujtesë të jashtëzakonshme dhe dinte të tregonte me saktësi histori të familjes sonë, me një dhunti të veçantë prej aktoreje teatri që e ka pasur qysh në moshë të re, kur vazhdonte gjimnazin e Tiranës, si dhe më vonë në ushtrimin e profesionit të saj fisnik, si edukatore kopshti.

Opinioni i Ditës

Kush janë 12 njerëzit, që i shkatërruan zgjedhjet e Parlamentit Europian

Nga Rajan Heth

(vijon nga faqja 1)

... e mëdha. Shumica e liderëve kombëtarë, qëndruan larg procesit. Kontinenti është i ndarë në 9 drejtime, me grupe partiake nga ato tradicionale, tek ato rebele.

BE-ja shpenzoi dhjetëra miliona euro, në përpjekje për t'i bindur qytetarët të shkojnë të votojnë, por s'bëri asgjë për të ndihmuar miliona të tjerë që patën probleme me njohjen e programeve elektorale. Pjesëmarrja ishte sërish në rënie. Por si u katandis këtu eksperimenti më i madh demokratik në botë? Ja cilët janë 12 personat, që duhet të mbahen përgjegjës për këtë.

HELMUT KOL

Kancelari që e bashkoi Gjermaninë pas 40 vjetësh të Luftës së Ftohtë, ishte pjesë e një procesi që i hapi rrugë krijimi të monedhës së përbashkët dhe zgjerimit të BE-së drejt lindjes. Ishte një lëvizje gjeopolitike e mirë, por e dëmshme për pjesëmarrjen në zgjedhjet europiane.

SIMONE VEIL

E mbijetuara e Aushvicit, kampione e lëvizjes feministe, avokate e të drejtave të njeriut, ministre e qeverisë franceze, dhe udhëheqëse e partisë europiane (e bllokut liberal të viteve 1980), ishte gjithashtu kryetarja e parë e Parlamentit Evropian të zgjedhur drejtpërdrejti (në vitet 1979-1982). Problemi: Ajo bëri që të gjithë të tjerët që erdhën në pas, të duken për krahasim të vegjël.

NELI KROS

E ndërtoi reputacionin e saj mbi gjobat e mëdha antitrust. Gjatë viteve 2004-2009, prodhoi titujt kryesorë në media, por në këtë mënyrë, ajo dhe pasuesit e saj Hoakin Almunia dhe Margret Vestager zbuluan një të vërtetë thelbësore për BE-në: Fuqia e vërtetë nuk qëndron tek Parlamenti Evropian, apo tek votuesit që zgjedhin deputetët. Më shumë se kudo tjetër në Bruksel, ajo ndodhet në duart e komisionerit të konkurrencës, që zakonisht nuk konsultohet me PE.

MANFRED VEBER

Veber kandidon për president të Komisionit Europian. Ai shmangu një debat paraprak në gjirin e Partisë Popullore Evropiane, dhe as mori pjesë në debatin e parë ndërpartiak në Mastriht, duke mos u bërë shumë i njohur për opinionin e gjerë publik.

MARK ZUKERBERG

Themeluesi i Facebook, krijoi një platformë të shumëpërdorur që mundëson dezinformimin, dhe u krijon jo pak probleme partive politike dhe institucioneve të BE. Në vitin 2018, ai premtoi të investonte në sisteme të reja, për të ndalur destabilizimin e demokracive. Por asnjëra nga masat, nuk e ndali dot fushatën anti-BE.

VERA JOUROVA

Ajo është komisionerja e BE për të drejtat e njeriut, mbrojtjen e privatësisë, konsumatorit dhe barazisë gjinore. Përveç udhëzimeve për kufizimin e gjuhës së urrejtjes dhe dezinformimit në rrjetet sociale, Jurova ka qenë apatike në fushat e tjera.

ELIO DI RUPO

Ish-kryeministri belg, është përgjegjës për një reformë shtetërore, të njohur si "Marrëveshja F'lutur" (sipas kravatave me flutura, që ai përdor shpesh). Reforma ndryshoi ciklin zgjedhor belg, duke e lidhur zgjedhjet evropiane me ato kombëtare, por që gjithsesi nuk i dha përparësi votimeve evropiane.

MARK RUTE

Për shkak të pjesëmarrjes së ulët, kryeministri holandez, injoroi zgjedhjet europiane të këtij viti. Vetëm 37 për qind e zgjedhësve në Holandë, votuan në vitin 2014. Këtë vit u vërejt një rritje, por partia e tij pësoi një humbje të konsiderueshme.

MORTEN MESERSHMID

Eurodeputeti danez, u zgjodh në vitin 2014 me numrin më të madh të votave të fituara ndonjëherë nga një danez. Por pak para zgjedhjeve të këtij viti, Mesershmid u përfshi në skandalin e shpërdorimit të rreth 400 mijë eurove të taksapaguesve evropianë. Kjo e rrënoi imazhin e tij, dhe të forcës që përfaqësonte.

THERESA MAY

Gjithçka që duhej të bënte, ishte të përmbyllte negociatat mbi Brexit. Ajo arriti me Brukselin një marrëveshje të konstestuar ashpër nga të gjitha palët politike në Britani, duke shkaktuar 3 humbje poshtëruese në parlament. Me dorëheqjen e saj, britanikët ndodhen në një udhëkryq tjetër.

ANGELA MERKEL

Kancelarja gjermane, ka qenë apatike para këtyre zgjedhjeve. Ajo miratoi shpejt e shpejt kandidaturën e Manfred Veber për president të Komisionit Europian, dhe më pas ia la drejtimin e CDU pasardhëses së saj të përzgjedhur, Anegret Kramp-Karrenbauer. Ajo u shfaq në fushë vetëm në një rast: për të mbështetur partinë qeverisëse në Kroaci, HDZ, një parti që e ka origjinën tek nacionalistët ustashë, që dikur ishin aleatë të Hitlerit!

EMANUEL MAKRON

Presidenti francez, donte që zgjedhjet e këtij viti, të ishin një betejë për 'shpirtin e Evropës'. Por ai u detyrua të merrej me shmangien e një humbje poshtëruese në shtëpi, duke mos pasur kohë të aktivizojë forcat eurofile të kontinentit.

Politico.eu. Bota.al

Opinioni i Ditës

Zgjedhjet që na afruan Europën e Bashkuar

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... vend anëtar të Bashkimit Evropian më vete, por ligje për të qeverisur arkën e përbashkët nëpërmjet qeverisë së BE-së, Komisionit Evropian. Zgjedhjet parlamentare të BE-së shihen nga të gjithë në komunitetin e madh evropian si pasqyrë ose sprovë për zgjedhjet e përgjithshme të ardhshme të secilit vend. Ndryshe nga shumë frikëra të atyre që e duan Europën të qëndrojë e bashkuar, siç është, madje edhe të zgjerohet akoma më shumë(dhe janë shumica), koalicioni i partive pro BE-së jo vetëm që nuk u mpak, por është zgjeruar. Pra, nga tkurrja e socialdemokratëve gjermanë(aleatë të Merkel) dhe e vetë kristiandemokratëve të Anxhela Merkel kanë përfituar të gjelbrit. Këta janë akoma dhe më entuziastë të zgjerimit të komunitetit. Mund të jetë fshikullim për Merkelin që po paguan faturën e papërballueshme si ekonomike dhe sociale të pranimit të 2 milionë refugjatëve sirianë. Por ky është lajm i mirë për Shqipërinë. Dhe Merkel ndoshta e ka marrë mesazhin që në koalicionin e madh të saj (në gjermanisht "die Grosse Koalition") të përfshijë edhe të gjelbrit. Ndërkohë votuesit evropianë ditën të frenojnë populistët dhe ekstremistët, si të djathtë dhe të majtë. Një vend si Holanda, politikanët e së cilës në një masë të konsiderueshme u shprehen jo vetëm kundër hapjes së negociatave me vendin tonë(e quanin të parakohshme), por miratuan edhe një rezolutë në parlamentin e tyre për të kthyer regjimin e vizave të hyrjes me Shqipërinë, mendohej të ishte kampioni i tkurrjes së BE-së. Mirëpo kjo nuk ndodhi. Qytetarët e thjeshtë holandezë nuk e miratuan këtë lojë populiste. Partia e ekstremit të djathtë në këtë vend, që aq shumë na ka sulmuar ne shqiptarët, nuk arriti të fitojë. Edhe pse shumë e konsideronin jo vetëm si triumfuesen, por edhe diktuesen e axhendës politike në Holandë. Në Francë, parti e parë është Fronti Kombëtar i ekstremistes së djathtë Marine Le Pen, me një eurodeputet më shumë se Lëvizja "Marcher(në frëngjisht Marsho") e Presidentit Makron. Mirëpo Makron ka rreth vetes të gjelbërit francezë, që kanë avancuar fort dhe janë renditur partia e tretë ne vend. Dhe kampioni i zgjerimit të BE-së Presidenti Francez, i cili deri tani ka frenuar (edhe në rastin e Shqipërisë për t'ia dhënë dritën jeshile çeljes së bisedimeve që më 28 qershor të vitit të kaluar), nga frika se mos humbte vota djathtas, tani duhet të jetë i qetë. Ato vota i ka humbur edhe pa na dhënë në dritën jeshile. Makron duhet të lëvizë shpejt dhe të kërkojë aleancë majtas, pra me të gjelbërit. Një aleancë që është e natyrshme për synimet e tij për forcimin dhe zgjerimin e Bashkimit Evropian. Në Austri, një vend me interesa të gjera dhe shumë ndikues për Shqipërinë, forcat e ekstremit të djathtë, që dolën faktikisht edhe filoruse, janë dërrmuar keqazi. Kristiandemokratët e kancelarit Kurz dhe eurokomisionerit për zgjerimin Hahn janë renditur të parët, ndërkohë që parti e dytë janë socialdemokratët. Ekstremistët janë renditur të tretët. Në Spanjë fituan fort socialistët e kryeministrit Sanches. Pavarësisht avancimit të së djathtës në Itali dhe Greqi, në tërësi, Parlamenti Europian nuk ka rënë në duart e grupeve ekstremiste të djathta. Me këto zgjedhje, Europa e Bashkuar është gjithnjë e më shumë realisht pranë nesh.

Zgjedhjet parlamentare të BE-së shihen nga të gjithë në komunitetin e madh evropian si pasqyrë ose sprovë për zgjedhjet e përgjithshme të ardhshme të secilit vend. Ndryshe nga shumë frikëra të atyre që e duan Europën të qëndrojë e bashkuar, siç është, madje edhe të zgjerohet akoma më shumë(dhe janë shumica), koalicioni i partive pro BE-së jo vetëm që nuk u mpak, por është zgjeruar.

HOROSKOPI

DASHI

Duhet ta thoni mendimin tuaj edhe nëse dikush përpiqet t'ju shkaktojë pengesa. Taktika më e mirë është të gjesh një mënyrë për të larguar plotësisht veten nga prania e këtij personi.

DEMI

Njerëzit të cilët veprojnë sikur janë më të mirë se të gjithë të tjerët, shpesh nuk praktikojnë atë që predikojnë. Përpara se të merrni ndonjë vendim në aspektin profesional, këshillohuni me ndonjë person tek i cili keni besim.

BINJAKET

Njerëzit që duan që të gjithë të jenë të lumtur nuk mund të jenë udhëheqës të mirë. Ata janë shumë të zënë duke i kënaqur nevojat e gjithsecilit. Nuk do të keni kohë të mjaftueshme në jetën tuaj për planifikim dhe ambicie, nëse jeni shumë i shqetësuar për komunikimin e qartë me njerëzit e tjerë.

GAFORJA

Problemet tuaja në punë janë gati për t'u larguar. Një projekt i tmerrshëm mund të hiqet nga tavolina juaj. Mbani sytë hapur për njerëzit që mund të ofrojnë ndihmë, edhe nëse ju buzëqeshin.

LUANI

Disa lajme shumë emocionuese do të ndezin një zjarr brenda jush sot dhe kjo do t'ju bëjë të lëvizni në një drejtim të ri. Sigurohuni që të dëgjoni me kujdes, prandaj kuptoni plotësisht se çfarë po ndodh rreth jush.

VIRGJERESHA

Ambiciet tuaja po bëhen edhe më të shëndetshme sot dhe mund ta gjeni veten duke menduar për të bërë gjëra që kurrë nuk do të kishit ëndërruar disa vjet më parë. Por, para se të merrni me këtë objektiv të mrekullueshëm, duhet të përqendroheni në përfundimin e disa gjërave.

PESHORJA

Një figurë pranë jush do të shfaqet sot shumë autoritare dhe mund të ndihet sikur ai ose ajo po jua bën ditën shumë të vështirë. Kjo nuk është koha për t'i marrë gjërat personalisht, është koha për të qëndruar të qetë.

AKREPI

Nisja e disa planeve të reja do të jetë e lehtë sot, për sa kohë që të përfshini njerëzit që doni në to. Bëni një bashkëpunim dhe gjithçka do të jetë shumë më zbavitëse.

SHIGJETARI

Sot duhet të mendoni më shumë për gjërat personale. Mos u jepni rëndësi disa aspekteve që nuk ju përkasin. Në çështjet e dashurisë duhet të tregoni më shumë angazhim dhe kujdes.

BRICJAPI

Të gjitha tranzicionet që po kaloni kohët e fundit nuk po ju ndihmojnë për të krijuar ekuilibrin në jetën tuaj. E vetmja mënyrë për të arritur një rezultat të mirë në këtë situatë është të përballeni me frikën tuaj.

UJORI

Ndihma për të tjerët është fisnike, por ndonjëherë problemet e njerëzve të tjerë nuk duhen vendosur përpara problemeve tuaja. Në fund, ne të gjithë duhet të kujdesemi për veten. Në dashuri parashikohen disa lajme të mira.

PESHQIT

A keni kërkuar për frymëzim kohët e fundit? Ajo vjen në forma të ndryshme dhe nga shumë vende të ndryshme. Tani është koha të presësh më të mirën nga vetja. Në aspektin do të keni sukses.

MBROJTËSI KUQEZI

Demarku refuzon Fenerbahçen: Dua të luaj në Serinë A

Merkato e verës nuk ësh të hapur ende mirë, por që tani ka emra lojtarësh të përfaqësueses shqiptare, të cilët janë kthyer në objektiv të skuadrave të ndryshme dhe po monitorohen në këtë periudhë. E tillë është edhe situata e Kastriot Dermakut, mbrojtësit shtatlartë të përfaqësueses, i cili ka mbyllur kontratën e tij me Kozencën dhe është i lirë të transferohet në çdo klub tjetër. "Do të luaj në Serinë A", pohoi pak ditë më parë mbrojtësi nga grumbullimi i kombëtares dhe prej kohësh përflitet se janë të shumta skuadrat që e kërkojnë nga elita e futbollit italian. Megjithatë, interesim shumë të madh për të ka edhe nga Turqia ku disa klube janë vënë në garë për të siguruar shërbimet e tij. Në javët e kaluara ishin Beshiktash dhe Istanbul Bashakshehir që kishin kërkuar informacione për futbollistin. Ndërkohë, mësohet se tani atë e kërkon edhe Trabzonspor si dhe Jeni Malatijaspor, pasi të gjithë palët kanë hyrë në bisedime me menaxherin e tij. Në këtë situatë bëhet e paqartë e ardhmja e mbrojtësit, ndonëse është e sigurt tashmë se ai do të jetë pjesë e një klubi në elitë dhe jo në kategorinë e dytë apo të tretë ku është aktivizuar në vitet e fundit.

Kërkon suksesin me U-21 dhe debutimin me ekipin A kuqezi, ndërsa ëndërron të luajë në La Liga

Lleshi: Në Kombëtare luhet vetëm për kombin!

Mesfushori i Leganesit i ka idetë e qarta

Jeton Selimi

Shqipëria U21 ka dy ndeshje miqësore ndaj Uellsit, ndërkohë që ka edhe një ndeshje zyrtare në transfertë ndaj Turqisë. Në prag të këtyre takimeve, para mediave ka dalë edhe Kleandro Lleshi, mesfushori që aktivizohet me Leganes B në Spanjë. Lleshi u shpreh se shumë shpejt mund të kalojë me ekipin e parë, ndërkohë që shtoi se për karrierën nuk e ndihmon Kombëtarja pasi në Kombëtare luhet vetëm për kombin.

Çfarë mendimi krijove për Kombëtaren A?

Më lanë përshtypje të mirë pasi ishin të gjithë të lumtur dhe kishin dëshirë për t'u stërvitur. Mikpritja nga lojtarët e ekipit të parë ishte pozitive. Trajneri vendos për gjithçka dhe unë kam detyrë vetëm të punoj dhe të bëj më të mirën. Duke dhënë maksimumin gjithçka arrihet.

Sfida ndaj Turqisë?

Për ne çdo ndeshje është e rëndësishme pasi në dy ndeshje nuk kemi arritur rezultate. Kundërshtarin nuk e mbivlerësojmë, por as nënvlerësojmë. Çdo ndeshje është shumë e rëndësishme dhe shkojmë vetëm për fitore si brenda, ashtu edhe jashtë.

Kombëtarja dhe karriera?

Kombëtarja është diçka ku duhet dhënë maksimumin për kombin dhe jo për individin. Oferta vlen më shumë te klubi ku ke më shumë minuta, kurse në Kombëtare ke pak kohë dhe natyrisht gjithmonë duhet dhënë maksimumi.

Pika e fortë e ekipi U21?

Grupi pasi jemi të gjithë bashkë. Kemi një qëllim dhe kjo është më e rëndësishmja për ne.

Si i parashikon dy ndeshjet e para?

Çdo ndeshje varet si merr. Skuadra ka dhënë maksimumin, por për shumë arsye nuk u mor fitorja. E sigurt është që kanë dhënë maksimumin.

E ardhmja te Leganes?

Luaj te Leganes B, por kam kontratë dhe gjithçka me ekipin e parë. Besoj se shumë shpejt do të kalojë te ekipi i parë pasi kam 7 ndeshje në fazë përgatitore.

JAVA E FUNDIT

FSHF zhvendos oraret, do të luhet në orën 16:00

Federata Shqiptare e Futbollit ka vendosur sërish të ndryshojë oraret e ndeshjeve që do të zhvillohen të enjten dhe që përkojnë me javën e fundit të kampionatit. Me titullin kampion tashmë të arkivuar, mbetet vetëm të zyrtarizohen ekipet që do të luajnë në Kupat e Europës sezonin e ardhshëm dhe ato që do të zbresin në Kategorinë e Parë. Sektori i Garave në FSHF, ka vendosur ta afrojë me 30 minuta kalendarin e javës së 36-të. Takimet nuk do të luhen më në orën 16:30, siç ka qenë praktikë këtë javët e fundit, por në orën 16:00.

SUPERLIGA

JAVA E FUNDIT

TË ENJTEN

Tirana - Flamurtari	16:00
Teuta - Laçi	16:00
Kukësi - Kastrioti	16:00
Luftëtari - Partizani	16:00
Kamza - Skënderbeu	16:00

Trajneri i ka orët e numëruara

Tension te Barcelona, Valverde me valixhe në dorë

Titulli kampion në Spanjë mund të mos mjaftojë. Në fillim dështimi në Champions dhe më pas zhgënjimi në finalen e Kupës së Mbretit e kanë sfumuar trofeun e La Liga dhe kanë pështjelluar atmosferën te Barcelona. Edhe pankina e Ernesto Valverde është tronditur sërish, teksa tekniku është vendosur në shënjestër të kritikave nga mediat dhe tifozët katalunjas. Megjithëse u rikonfirmua nga presidenti Bartomeu, vetë ky duket se është penduar kur pa skuadrën e tij të humbiste 2-1 në finalen e Kupës kundër Valencias. Të përditshmet shumë pranë klubit "blaugrana" bëjnë të ditur se te Barcelona jetohet mes tensionit dhe dyshimeve të shumta për të ardhmen. Shumë prej drejtuesve të klubit i janë bashkuar idesë së tifozëve se Valverde nuk është njeriu i duhur për t'u rinisur në sezonin e ardhshëm. Duke qëndruar në atë që raportojnë dy gazetat katalunjase "Sport" dhe "El Mundo Deportivo", tekniku ka humbur edhe besimin e një pjesë të mirë të senatorëve të skuadrës, përfshirë edhe Lionel Messi, që pas humbjes së fundit nuk e mori në mbrojtje trajnerin, duke ia faturuar hapur një pjesë të fajit. Mediat lokale shkojnë më tej, teksa zbulojnë edhe profilin e teknikut që i duhet Barcelonës, ndërsa në skenë del edhe emri i Massimiliano Allegri.

Ka biseduar me presidentin Perez

Ofertë milionere nga Kina, Ramos kërkon largimin

Pas zërave të ditëve të fundit kanë ardhur edhe konfirmimet. Sipas "El Chiringuito TV", duket se Sergio Ramos dhe Florentino Perez janë krisur njëherë e përgjithmonë, me kapitenin e Real Madridit që jo vetëm ka kërkuar të largohet nga "Los Blancos", por shpreson që diçka të tillë ta bëjë me parametër zero. Largimi do të ishte vërtet i bujshëm, pasi Sergio Ramos luan prej 14 vitesh në Madrid, që kur la Seviljen në vitin 2005. Sipas "Chiringuitos", është zhvilluar një takim mes Sergio Ramos, vëllait të tij procurator, Rene Ramos, avokatit të lojtarit Hulio Sen dhe presidentit Perez, me lojtarin që ka kërkuar largimin pasi ka një ofertë të parefuzueshme nga Kina.

Do firmosë për 12 mln. euro në sezon

Antonio Konte prezantohet tek Interi këtë javë

Si një sekret i Pulçinelës! Prej muajsh emri i Antonio Kontes lakohet si trajner i Interit, duke zëvendësuar në ditët e ardhshme Luçiano Spaletin, me këtë të fundit që pavarësisht se arriti zonën Champions, do t'i duhet t'i hapë rrugën ish-trajnerit të Juventusit. Sipas "Gazzetta Dello Sport", trajneri 49-vjeçar dhe klubi zikaltër kanë arritur "një akord total", ndërsa zyrtarizimi i tij si timonier i Interit "do të bëhet në gjysmën e dytë të javës", menjëherë pas largimit të Spaletit. Ndërkohë, "Sky Sport", raporton se paga e Kontes do të jetë 12 milionë euro neto në vit, ndërsa të shtunën do të jetë bashkë me presidentin Zhang në Madrid për të ndjekur finalen Liverpul-Totenhem.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Eshtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skllavja e Abrahamit.
12. Një dite në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshtë ankimim.
23. Pak elementared
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të paturpit.
37. Janë legjendat.
38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brinjë në skuadër.
42. Shkruhet i shtati.
44. Nget edhe ajo e mirë
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

1. Kanë shpate të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla
5. Eshtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryr të titujve
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrëfimet e të pandehurit.
14. Janë penjtë për gjergjef.
16. Mbarojnë fare.
18. Janë stitët e... provimëeve.
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshtë e akuzuara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa çift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pështjellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në litar.
46. Fillojnë lejen.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Satelit i Uranit.
6. Eshtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë ilustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrat... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.
35. Një shkop, thupër.
37. Eshtë Shqipëria e madhe.
39. U thyen në Salamina.
40. Një raport shumë i ngushtë.
41. Nota e diapzonit.
42. Fund heroi.
43. Një top në rrjetë.
45. Gjysma alarmi.
46. Herët pa zë.
47. Sampras i tenisit.
48. Me to bëjnë triko.
49. Një gjuajtje fluturimthi në tenis.
50. Janë kokrrat e lisit.

VERTIKAL

1. I famshëm ai i Sizifit.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Fillojnë rastësisht.
4. Një pjesë e napolitanëve.
5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
6. Mund të jenë kundërajrore.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtegu.
9. Hidhen të parat.
10. Eshtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllen me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
29. Hapet një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rixhiruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktor.
41. Ullmann aktore.
43. Një brilantinë moderne
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstremë në hall.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

					9		1	
4	3						6	
		6					2	
	8			4				
1			5	2				
		7			8		9	5
							8	4
			3					9
	1	4				3		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	6	5	9	2	8	1	3	4
3	4	9	1	5	7	6	8	2
1	8	2	6	3	4	5	7	9
2	5	4	3	8	1	7	9	6
6	7	8	2	4	9	3	5	1
9	1	3	7	6	5	2	4	8
8	2	1	4	7	3	9	6	5
4	9	7	5	1	6	8	2	3
5	3	6	8	9	2	4	1	7

Argëtim filozofik

- S'është fatkeqësi të jesh i njohur për keq tek njerëzit, fatkeqësi është t'i njohësh keq njerëzit.

- Një njeri me guxim është shumicë.

- Në qoftë se mundeshim të shisnim përvojat tona me çmimin që na kushtuan, do të ishim të gjithë milionerë.

- Njeriu i kuptueshëm i përshtatet botës, i pakuptueshmi vazhdimisht mundohet t'ia përshtasë botën vetvetes.

KRIPTOSKEME



KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

K	A	F	E			T	A	L	E	N	T	
A	D	A	M		P	A	F		T	E	R	
T	E	T		H	E	P	A	T	I	T	I	
E	T		H	E	R	E	T	I	K	E		
G		K	O	M	I	T	E	T	E	T		
O		E	K	I	P	E	T		T		F	
R	I	K		N	E	T		T	A	P	A	
I		O		G	C			S	T	I	L	
K	P		S	W	I	N	G			S	L	
E	O		P	A	T	E	N	T	A	T		
	N	A		Y	E			U	R	A	T	
T	Y	M	I			P	I	R	A	T	I	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR



FJALEKRYQI (1)

FJALEKRYQI (2)

Argëtim filozofik

Thënie të mençura

- Njerëzit që s'i kundërshtojmë kurrë, janë ose ata që më së shumti i duam, ose ata që më së paku i respektojmë.

- Gjykimi i drejtë është produkt i përvojës, dhe përvoja është produkt i gjykimit të gabuar.

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

Gazeta e gjithë shqiptarëve!

MARKETING: 0688087323

Kontakt: +355 68 40 63 842

Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube Youtube: Gazeta Shqiptare

• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al